

PAQJA

REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË



Viti IV. Nr. 27. 19 shkurt-19 mars 2009. Organ i shoqatës kulturore "Zëri Ynë"

Çmimi 0.50€



Kosova dhe kriza financiare

Në pritje të ditëve të bardha...

**Shpresa Rama
eseistja më e mirë në botë**



**Nekrologji për
poetin Agim Deva**

**Frika e prodhuar nga
mosnjohja e të vërtetës**

Historiku i futbollit në Kosovë

Intervistë me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi

**SHQIPTARËT DUHET TË MENDOJNË
PËR INTEGRIMET QË SJELL KOHA**



Zëri Ynë
SHOQATA KULTURORE

PËRMBAJTJA

Lajme	2
Sead Ujkani: Kosova dhe kriza financiare globale	3
Intervistë ekskluzive me Jakup Krasniqin	4-8
Ferid Selimi: Presheva, Bujanoci dhe veriu i Kosovës	9-10
Avni Avdiu: Maqedonia në prag të zgjedhjeve të dyfishta	11-12
Ajni Sinani: Osmanlinjtë e rinj	12-13
Nazmi Maliqi: Roli i shoqërisë civile	14-15
Mevlyde Zejnullahu: Në pritje të ditëve të bardha	16-17
Besim R. Cengu: Moda e zhveshjes së miteve dhe realiteti i sotëm	18-19
Demir Reshiti: Viti i ri nis me njohje të reja ..	20-21
Muhamed J. Kajolli: Drejt konsolidimit të qeverisë së pare islame në botë	22-24
Drin Kryeziu: Emërvëniet e çuditshme	24-25
Milazim Krasniqi: Frika e prodhuar nga mosnjohja e të vërtetës	26-27
Fatlum Sadiku & Rexhep Kera: Shpresa Rama es-eistja më e mirë në botë!	28
Demir Reshiti: Agim Deva mbetet një yll i pashuar	29-30
Mexhid Yveysi: Dita e Shën Valentinit	30-31
Fitim Veliu: Mendimi dhe të pyeturit	32
Flamur Maloku: Kohë e harrimit	33-34
Flamur Maloku: Vitrina e librit	34
Esat Vatovci: Ngjarje kulturore	35
Poezi	35
Kuriozitete	36
Artan N. Bejta: Infarkti i miokardit	37-38
Alban Bilalli: Historiku i futbollit në Kosovë	39
Fjalëkryqi	40



3 Kosova dhe kriza financiare



4 Intervistë me Jakup Krasniqin



18 Moda e zhveshjes së miteve...



28 Shpresa Rama es-eistja më e mirë



32 Infarkti i miokardit



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti IV / Nr. 27
19 shkurt - 19 mars 2009
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Demir RESHITI
demireshiti@hotmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmalku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
Mimoza SINANI

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Prishtinë

21 janar 2008

Aktivizohet Forca e Sigurisë së Republikës së Kosovës

Më 21 janar 2009, në ora 00:01, ministri i FSK-së, Fehmi Mujota, ka urdhëruar Komandantin e FSK-së Gjenerallejtënant Sylejman Selimin, të bëjë aktivizimin e FSK-së. FSK-ja është forcë profesionale, politikisht neutrale, shumetnike, lehtë e armatosur. FSK-ja po ndërtohet sipas standardeve të NATO-së dhe është e mbikëqyrur nga institucionet civile dhe demokratike. Kjo është në përputhje me aspiratat e vazhdueshme të Kosovës drejt integritet euroatlantik.

FSK-ja do t'i ketë 2 mijë e 500 pjesëtarë aktivë dhe 800 rezervë. Këtë vit, nga mbarë Kosova, do të përzgjidhen 315 shtetas që do t'i bashkëngjiten FSK-së.



Strasbourg

5 shkurt 2008

PE: Kosova të njihet nga të gjithë anëtarët e BE-së

Parlamenti Evropian ka ftuar të gjitha vendet e Bashkimit Evropian që ta njohin pavarësinë e Kosovës. Kjo ftesë u bë nëpërmjet një rezolute, e cila u votua me 424 vota për dhe 133 kundër. Në Rezolutën e miratuar në Strasbourg, është theksuar se nuk ekziston asnjë mundësi për ndarjen e territorit të Kosovës, ndërsa është përshëndetur vendosja e suksesshme e misionit EULEX në të gjithë vendin.

Në rezolutë i kërkohet si Kosovës edhe Serbisë që të angazhohen për dialog për çështje me interes të përbashkët dhe të kontribuojnë për bashkëpunimin rajonal.



Prishtinë

5 shkurt 2008

Bashkim Smakaj - drejtor i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë



Bashkim Smakaj është emëruar drejtor i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Emërimin e tij e kanë bërë publik presidenti Sejdiu dhe kryeministri Thaçi, në një konferencë të përbashkët për media.

Në bazë të Kushtetutës, presidenti dhe kryeministri i Republikës së Kosovës kanë marrë vendim për emërimin e Bashkim Smakajt, me vendbanim në Prishtinë, drejtor të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Smakaj është i lindur në vitin 1976 në fshatin Kpuz të Klinës, ndërsa aktualisht jeton në Prishtinë. Ka të kryer Fakultetin e Biologjisë si dhe Fakultetin e Shkencave Politike, Dega Administratë Publike. Deri tani ai ka qenë drejtor i planifikimit strategjik të akteve normative dhe ndërlidhjes me policinë kufitare në Policinë e Kosovës. Smakaj është zgjedhur për një mandat 5 vjeçar, por me mundësi të rizgjedhjes.

Kosova dhe kriza financiare globale

Republika e Kosovës, pa marrë parasysh efektin e krizës financiare globale, është në krizë dhe një ndikim negativ i saj vetëm sa do ta përkeqësonte tej mase gjendjen në vend, e cila natyrisht do të mund të karakterizohej edhe me situata të palakmueshme dhe negative për interesin e përgjithshëm të vendit tonë



Sead UJKANI

Jemi dëshmitar të krizës financiare që përshkoi tërë globin gjatë vitit 2008, duke pasur edhe pasojat e veta negative në ekonominë botërore në tërësi. Ishte pjesa e dytë e vitit 2007, përkatësisht muaji gusht i këtij viti kur u paraqitën shenjat e para të kësaj krize, e cilësuar si "cunami" për ekonominë globale.

Kriza financiare në realitet u shfaq për herë të parë në SHBA, duke goditur kështu rëndë fillimisht ekonominë e superfuqisë botërore, e cila u karakterizua me falimentimin e shumë institucioneve të rëndësishme të sistemit financiar në këtë vend, gjë që rezultoi edhe me rritjen e shkallës së papunësisë, meqë shumë punëtorë u larguan nga vendet e tyre të punës.

Kur flasim për krizën financiare, nën veprimin e së cilës jemi edhe sot, duhet cekur fakti se kjo krizë dallon nga krizat e kaluara, nëpër të cilat ka kaluar ekonomia botërore, duke marrë parasysh pikënisjen prej nga filloi, përkatësisht, shkaqet që çuan në shfaqjen e saj, shtrirjen dhe efektin e saj.

Ajo çka është më shqetësuese është fakti se kjo krizë është duke vazhduar në ditët e sotme. Pothuajse, nuk ka ditë që nuk lexojmë apo dëgjojmë mbi efektet negative të kësaj krize. Shumë shtete të ndryshme shpallën recensionin e ekonomive të tyre, shumë kompani të ndryshme kanë falimentuar si dhe shumë të tjera janë duke shkuar drejt kësaj rruge. Numri i të papunëve sa vjen e rritet, ndërsa edhe më tej nuk ka ndonjë zgjidhje konkrete për mënyrën e daljes nga kjo krizë, si dhe evitimin e pasojave të saj.

Kriza financiare dhe mënyra e mënjanimin të saj vazhdon të jetë preokupim i tërë liderëve botërorë dhe objekt debati në shumicën e takimeve të institucioneve ndërkombëtare, ku marrin pjesë përfaqësuesi e shteteve më të zhvilluara, të prekur nga kriza në fjalë. Është po

kjo krizë e cila nuk e le të pushojë i qetë as Presidentin ShBA-ve Barack Obama, i cili në një intervistë për agjencinë e lajmeve CNN, ka theksuar që nuk e zë gjumi natën si pasojë e gjendjes alarmante që është duke mbretëruar dhe shpejtësisë shqetësuese më të cilën po përkeqësohet ekonomia e këtij vendi e që natyrisht për shkak të ndikimit të këtij shteti në zhvillimet e gjithëmbarshme në botë mund të reflektohet si e tillë në ekonominë e tërë globit.

Mirëpo, me gjithë faktin që ekonomitë e vendeve të zhvilluara ishin dhe vazhdojnë të jenë më të ekspozuara karshi krizës financiare, nuk mund të themi që



kjo krizë nuk mund të prekë edhe vendet me pak të zhvilluara ekonomisht. Në këtë kontekst, efektet e kësaj krize mund të vërehen edhe në vendet e rajonit në përgjithësi dhe Republikën e Kosovës në veçanti, qoftë në një mënyrë ose tjetrën, edhe pse realisht në masë të vogël kjo krizë është ndier edhe në këto vende.

Fatmirësisht, vendi ynë nuk i ka ndier në masë të madhe efektet e shkaktuara nga kjo krizë. Përveç humbjeve të Trustit të Pensioneve, e cila natyrisht është shumë negative dhe shqetësuese për një vend siç jemi ne, në tërësi i kemi shpëtuar "sulmit" direkt nga kjo krizë.

Kriza globale reflektohet edhe në Kosovë

Duke folur rreth krizës financiare dhe implikimet e mundshme të saj mbi Kosovën, ministri i ekonomisë dhe financave, Ahmet Shala ka theksuar: "Ne e kemi përcjellë me shumë vëmendje çdo implikim të mundshëm të kësaj situatë në Kosovë. Sipas informatave që kemi, bankat që veprojnë në Kosovë nuk janë të përfshira shumë, ose janë fare pak të përfshira, në investimet në segmente të caktuara të rrezikshme. Nuk ka shqetësime absolutisht për Kosovën. Unë me besim të plotë mund të them se qytetarët e Kosovës tash për tash janë të mbrojtur nga çdo tundje".

Ndërsa, eksperti për çështje ekonomike, përkatësisht Drejtori i Institutit për Studime të Avancuara, GAP, Shpend Ahmeti ka thënë se vendi ynë për momentin nuk është i prekur nga kriza financiare globale, mirëpo në një të ardhme të afërt efektet e saj mund të vërehen edhe tek ne, sidomos në drejtim të ngadalësimit të rritjes së ekonomisë sonë.

"Sektori bankar në vend nuk është i prekur nga kriza financiare meqë ka eksponim minimal ndaj tregjeve financiare, mirëpo ekonomia e Kosovës mund të ketë ndikim indirekt, meqë nuk mund të ndodhë që e tërë bota të shkojë në recension dhe ne të shpëtojmë, por në një të ardhme tre ose gjatë mujore për shkak të parave që marrim nga diaspora dhe investimeve të jashtme, përkatësisht zvogëlimit të kapitalit, kjo krizë mund të ketë efekt në ngadalësimin e rritjes ekonomike në vendin tonë" - ka thënë Ahmeti.

Edhe pse deri më tash, në mënyrë direkte, nuk i kemi ndier pasojat krizës financiare, shpresojmë që një gjë e tillë të mos ndodhë as në të ardhmen. Ne, pa marrë parasysh efektin e kësaj krize, jemi në krizë dhe një ndikim negativ i saj vetëm sa do ta përkeqësonte tej mase gjendjen në vend, e cila natyrisht do të mund të karakterizohej edhe me situata të palakmueshme dhe negative për interesin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës. ■

Intervistë ekskluzive me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi

Shqiptarët duhet të mendojnë

- Ky vit do të përmbyllë shumëçka sa i përket njohjes ndërkombëtare;
- Realisht qeveria, si kudo në botë, dikton tempin e punës së kuvendit;
- Në parlamentin evropian është vendosur edhe parlamenti i republikës së Kosovës;
- Debati në kuvend lë shumë për të dëshiruar;
- Partitë politike të mos i avancojnë në radhët e veta njerëzit të cilët kanë qenë në shërbim të sistemit të kaluar;
- Janë të pamundura bisedimet me Serbinë.

Intervistoi: Demir RESHITI

“**M**endoj se nuk po shfrytëzohet realiteti i ri për të krijuar raporte të bashkëpunimit mes njërive administrative shtetërore të shqiptarëve për bashkim.

Do të duhej që shqiptarët të mendonin për integrimet që sjell koha. Nuk ka kurrfarë mëkati dhe kurrfarë problemi, as për Bashkimin Evropian dhe as për dikë tjetër që në mes të Kosovës, Shqipërisë, por edhe Maqedonisë, të vendosen marrëdhënie të reja integruese...”, ka deklaruar në intervistën ekskluzive për revistën tonë, kryetari i kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi. Z. Krasniqi flet për të arriturat e institucionit që ai drejton gjatë një viti pavarësie, për (mos) njohjen e shtetit të Kosovës nga vendet e tjera, për marrëdhëniet e kuvendit me qeverinë, presidencën, institucionet ndërkombëtare, shoqërinë civile etj.

PAQJA: A mund ta bëni një përshkrim të shkurtër të punës së Kuvendit gjatë një viti pavarësie?

Krasniqi: Kuvendi, në vitin e parë të pavarësisë, ka vërtet rezultate të dukshme, duke filluar që nga shpallja e pavarësisë, miratimi i kushtetutës dhe miratimi i simboleve të shtetit. Mendoj që këto janë punët më të mëdha dhe janë çështje që kanë hapur shumë dritare për Kosovën, sidomos kur kemi të bëjmë me kushtetutën që është ligj bazik i shtetit. Pastaj, kemi miratuar diku 91 ligje. 52 ligje kanë shkuar me procedura të përshpejtuara dhe të tjerat kanë kaluar me procedura të rregullta parlamentare. Kemi pasur tri interpelanca, kemi pas

debatet për buxhetin dhe, në përgjithësi, mendoj se ka qenë periudha më e frytshme prej se ekziston kuvendi i Kosovës. Po të krahashohet edhe me dy legjislaturat e kaluara, veç e veç, ne për një vit kemi miratuar më shumë ligje se sa janë miratuar përpara tri viteve.

Mendoj se ky vit do të përmbyllë shumëçka sa i përket njohjes ndërkombëtare

PAQJA: Në fillim të shpalljes së pavarësisë është thënë se njohjet do të arrijnë menjëherë numrin 100, por deri më tani Kosovën e kanë njohur diçka më tepër se gjysma e kësaj shifre. Si e komentoni këtë dhe a pritni njohje të reja?

Krasniqi: Ndoshta pas shpalljes së pavarësisë ka ekzistuar një eufori duke pasur parasysh se pavarësia u shpall në koordinim me faktorin ndërkombëtar,

d.m.th. edhe me BE-në, edhe me Nju Jorkun, edhe me Uashingtonin dhe sigurisht se u prit se do të kishte njohje të shpejta. Por procesi i njohjes i ka edhe pengesat dhe vështirësitë e veta. Shikuar realisht, nga 54 vendet që e kanë njohur shtetin e pavarur të Kosovës, pjesa më e madhe e tyre janë vendet më të zhvilluara, që kanë një traditë të gjatë demokratike dhe janë vendet më të zhvilluara ekonomikisht dhe janë vende që përbejnë diku mbi 70 për qind të GDP-së botërore, por janë edhe vende që kanë fuqi të madhe politike dhe ushtarake. Shikuar përgjithësisht, konsideroj që Kosova, brenda një viti, është njohur mjaft mirë. Natyrisht dëshirat dhe kërkesat tona do të ishin që Kosova vitin 2008 ta përmbyllte me anëtarësimin në OKB, por siç e dini pengesë kryesore ishte Rusia dhe miqtë e saj që e mbësh-



ë për integrimet që sjell koha

tesin, por mendoj se ky vit do të ketë njohje të reja. Shumë vende, ndoshta për shkak të procedurave të tyre ligjore nga njëra anë dhe nga ana tjetër për shkak të frikës se mos Kosova po bëhet si shembull për të tjerët duke mos e pranuar si sui-generis, hezitojnë ta njohin. Por edhe këto vende që e kanë njohur Kosovën, siç janë shumica e vendeve anëtare të BE-së, Kanadaja, Japonia, Turqia..., mendoj që përbëjnë fuqi botërore. Mendoj që Kosova ka krijuar miq mjaft të fortë dhe, në këtë aspekt, mendoj se ky vit do të përmbyllë shumëçka sa i përket njohjes ndërkombëtare.

PAQJA: *Cili do të jetë roli i Kuvendit gjatë këtij viti në drejtim të rritjes së numrit të njohjeve të pavarësisë së Kosovës?*

Krasniqi: Kuvendi do të përpiqet që të vendosë disa kontakte me vende të ndryshme të Evropës. Ne do të kërkojmë që OSBE-ja të na vejë kontakte me vendet e BE-së që nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës, nëse jo në nivele të larta atëherë në nivele të komisioneve të ndryshme. Ne, në fund të vitit 2007, me ndihmën e OSBE-së kemi bërë një vizitë në Spanjë në parlamentin spanjoll dhe në ministrinë e punëve të jashtme, ku si shefa të grupeve parlamentare i kemi njoftuar për qëllimet dhe zhvillimet në Kosovë. Nga ky takim patëm krijuar një bindje se edhe Spanja do të rreshtohet me vendet që e kanë njohur Kosovën, por kjo nuk po ndodh ende. Qëllimi ynë është që të vejmë kontakte përsëri, jo vetëm me Spanjën por edhe me Greqinë dhe Rumaninë që janë vende të BE-së, në mënyrë që t'u tregojmë për punën që kemi bërë si kuvend, në raport me të drejtat e pakicave dhe të drejtat e njeriut dhe t'ua shpjegojmë cila është politika që ndjek kuvendi i Kosovës në raport me vendet fqinje. Ne, në fillim të vitit, kemi pasur një vizitë në Turqi. Natyrisht, Turqia është ndër të parët që na ka njohur dhe në të gjitha takimet që kemi pasur atje kemi kërkuar që ata të na ndihmojnë (dhe e pamë që kanë punuar në këtë drejtim), që të llobojnë jo vetëm në vendet islamike por në të gjitha vendet ku ndikimi i Ruisë është i dukshëm.



Presim që do të ketë rezultate pozitive në këtë drejtim. Tani mendojmë që brenda një kohe të shkurtër të shkojmë edhe në Britaninë e Madhe, jo vetëm për të marrë përvoja të mira të demokracisë, por, natyrisht, do të kërkojmë nga institucionet e këtij vendi që të llobojnë në vendet e tjera, ku kanë ndikim, që ta njohin shtetin e Kosovës.

PAQJA: *Kur mendoni ju se Kosova do të jetë pjesë e organizmave ndërkombëtarë, OKB-së në radhë të parë, e pastaj edhe organizmave të tjerë, përfshi edhe ata financiarë?*

Krasniqi: Duhet ta them se Kosova e ka shumë më lehtë që këtë vit të bëhet anëtare e mekanizmave financiare, në radhë të parë e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe bankës botërore. Realisht varet shumë nga njohjet që do të ndodhin deri në shtator, pastaj do të duhej një diplomaci e kombinuar e qeverisë dhe parlamentit për ta hulumtuar mundësinë e paraqitjes së kërkesës për t'u bërë anëtare e këtyre organizmave, ose ndoshta do të na duhej të pritnim më gjatë, deri sa të vendosë gjykata e drejtësisë në Hagë, vendimi i së cilës shpresoj se do të jetë në favor tonin.

Realisht qeveria, si kudo në botë, ia dikton tempin e punës kuvendit

PAQJA: *Cili është niveli i bashkëpunimit të Kuvendit me institucionet e tjera të Kosovës, qeverinë, presidencën etj.?*

Krasniqi: Shpeshherë në opinion flitet që kuvendi po drejtohet nga qeveria. Ne realisht duhet ta kuptojmë se shumica parlamentare e Kuvendit nuk mund të jetë opozitë e qeverisë, sepse kjo shumicë praktikisht e ka zgjedhur qeverinë. Nëse e shikojmë punën që bën qeveria në hartimin e ligjeve, realisht qeveria, si kudo në botë, ia dikton tempin e punës kuvendit. D.m.th. sa më shumë ligje nga qeveria, më shumë ligje miratohen në kuvend. Po të shikohet në këtë rrafsh, ndikimi i qeverisë është real, sepse në të shumtën e vendeve ndodh e njëjta gjë, bie fjala diku-diku qeveria ndikon në agjendën e kuvendit, për shembull, qeveria franceze ia bën agjendën parlamentit nacional të Francës. Këto janë çështje që i njeh demokracia. Në fund të fundit qeveria është ajo që e cakton koston e një ligji. Në këtë rrafsh mendoj se kemi bashkëpunim të mirë dhe secili nga institucionet i kryen punët dhe detyrimet

e veta që kanë në përgjegjësi. Edhe me presidentin kemi marrëdhënie të mira. E drejta e presidentit është që t'i nënshkruajë ligjet e miratuara në parlament dhe ai edhe mund t'i kthejë ato ligje që bien në kundërshtim me kushtetutën.

PAQJA: A ka ndodhur gjatë kësaj periudhe që presidenti ta kthejë ndonjë ligj?

Krasniqi: Ka ndodhur me ligjin për shtatzëni dhe një ligj tjetër, por pa vërejtje të shumta, të cilat komisionet e kuvendit i kanë futur në procedurën e rishqyrtimit.

PAQJA: Po me përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare në Kosovë?

Krasniqi: Me institucionet ndërkombëtare kemi raporte të mira bashkëpunimi, sepse edhe me kushtetutë, po të shikohet, fjalën e fundit për të dhënë mendim mbi ligjet e miratuara e ka përfaqësuesi civil ndërkombëtar. Ne kemi kontakte të kohëpaskohshme edhe me përfaqësuesit civil ndërkombëtar, edhe me zyrën e tij dhe në këtë rrafsh mendoj se bashkëpunimi ka qenë korrekt.

Në parlamentin evropian është vendosur edhe parlamenti i republikës së Kosovës

PAQJA: Gjatë këtij viti keni realizuar vizita të rëndësishme në Shqipëri, Belgjikë, Slloveni, SHBA dhe Turqi. Cila është përshtypja juaj nga këto vizita dhe sa i kanë kontribuar ato çështjes së Kosovës?

Krasniqi: Më duhet të bëj një dallim se vizita në SHBA nuk ka qenë vizitë në cilësinë e kryetarit të kuvendit të Kosovës, por atje kam shkuar si sekretar i përgjithshëm i PDK-së, i ftuar në konventën e demokratëve dhe, natyrisht, përveç prezencës sonë në konventë kemi shfrytëzuar rastin që të kemi kontakte me administratorët edhe në stejt-department, edhe në Kongresin amerikan, që kanë ndikim të madh në fushën e financave. Kemi pasur takime edhe në OKB me zv/ambasadoren e SHBA-së zonjën DiCarlo dhe kemi pasur një konferencë shtypi në OKB për zhvillimet në Kosovë. Gjatë konventës kemi pasur takime me politikanë të ndryshëm që ishin pjesëmarrës aty, por edhe me ambasadorë të vendeve të ndryshme që nuk e kanë njohur deri më tani shtetin e Kosovës dhe të gjitha këto takime kanë qenë në funksion të lobimit

për pavarësi. Kurse në këto shtetet e tjera, me parlamentin e Belgjikës kemi pasur edhe më herët marrëdhënie të mira. Ka qenë një konzorcium ku kanë marrë pjesë parlamentet e Francës, Belgjikës, Gjermanisë dhe Sllovenisë, të cilët për dy vjet e kanë ndihmuar kuvendin e Kosovës si donator. Në Belgjikë kemi qenë dhe jam pritur tamam si kryetar i kuvendit të Kosovës. Aty kemi nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi dhe kemi vendosur marrëdhënie bilaterale dhe unë mendoj që kjo vizitë ka pasur rëndësinë e vet. Të njëjtën gjë e kemi bërë edhe me parlamentin nacional të Sllovenisë. Kemi qenë edhe në Bruksel, në parlamentin evropian dhe mendoj se ndoshta kjo vizitë ka pasur rëndësi më të madhe për faktin se jemi pritur nga kryetari i parlamentit dhe, në sfond, e kemi pasur së bashku flamurin e Kosovës dhe flamurin e BE-së dhe ky ka qenë takimi i parë i parlamentit të Kosovës, si parlament i parë i shtetit të pavarur. Kjo ka qenë ajo që e ka daluar nga vizitat e tjera në parlamentin evropian dhe realisht mendoj se në parlamentin evropian është vendosur edhe parlamenti i republikës së Kosovës. Do ta veçoja edhe vizitën në Turqi ku jemi pritur jo vetëm nga kryetari i parlamentit, por edhe nga presidenti dhe kryeministri, dhe natyrisht kanë qenë dy tema bosht, tema e mundësisë që investitorët turq ta ndihmojnë ekonominë e Kosovës dhe tema e dytë kanë qenë bisedimet që



Turqia ta vazhdojë lobimin në konferencën islamike për njohjen e pavarësisë së Kosovës, gjë që Turqia e ka bërë në kontinuitet, por ne njëkohësisht kemi kërkuar nga Turqia që ta përdorë ndikimin e saj të

fuqishëm edhe në vendet e tjera që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, që ta bëjnë këtë. Siç e dimë, Turqia është vend i rëndësishëm dhe i fuqishëm e me traditë, i cili ka ndikim në shumë vende të tjera të botës. Realisht kemi marrë premtime shumë pozitive dhe, në anën tjetër, mund të them se në Turqi jo vetëm Kosova, por në përgjithësi shqiptarët janë të mirëpritur dhe, edhe shqiptarët e shumtë në numër që jetojnë atje, kanë një autoritet të madh në këtë vend dhe mendoj se mund të vendosën ura të reja të bashkëpunimit me republikën e Turqisë.

PAQJA: I çfarë niveli është bashkëpunimi i Kuvendit me përfaqësuesit e shoqërisë civile lidhur me procesin legjislativ?

Krasniqi: Ne po përpiqemi që secili t'i kryejë punët e veta. Janë disa shoqata joqeveritare që marrin pjesë në monitorimin e punëve të kuvendit dhe në debatet publike që zhvillohen për ligje të ndryshme. Ne po përpiqemi që t'i vendosim në faqen e internetit të kuvendit disa projektligje, jo vetëm kur miratohen, por edhe kur janë në fazën e procedurës së përgatitjes përpara miratimit, në mënyrë që shoqëria civile para se të miratohen ligjet t'i shikojë ato dhe aty ku është e interesuar të kërkojë përmirësimin e ligjeve në favor të qytetarëve. Sinqerisht po them, ne presim një bashkëpunim dhe jemi të hapur në këtë drejtim, duke synuar që punën e parlamentit ta bëjmë

sa më transparente. Deri më tani mendoj se punët e secancave janë transparente. Mendoj se një pjesë e mirë e komisioneve janë duke bërë debate dhe duke i afruar



shoqërisë civile mundësinë që t'i japin mendimet e tyre. Nga ana tjetër do të përpiqem që, përveç seancave, të bëhen publike edhe takimet e komisioneve, në mënyrë që të gjithë ata që janë të interesuar për të dhënë kontributin e tyre në përmirësimin e ligjeve, por edhe të punës së kuvendit, mendoj se së shpejti do t'i kenë mundësitë shtesë, në krahasim me këtë gjendje që kemi tani.

Debati në kuvend të shumë për të dëshiruar

PAQJA: Sa jeni të kënaqur me nivelin e debatit në Kuvend?

Krasniqi: Çështja e debatit është një çështje e veçantë. Realisht mund të them se debati ndoshta ka pasur mundësi të jetë më i frytshëm. Debati në kuvend ka mundur të orientohej jo vetëm në çështjen e sigurisë, e cila është shumë e ndjeshme, por edhe në shumë fusha të tjera. Ka mundur të orientohej në temat që kanë të bëjnë me interesin nacional, në temat që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor, mbrojtjen e pasurisë kombëtare, mbrojtjen e tokës bujqësore. Do të duhej të bëhet debat, bie fjala, për anarkinë e ndërtimeve që po bëhen në Kosovë. Mjafton të udhëtosh nga Prishtina në Ferizaj, ose nga Prishtina në Sllatinë, që ta shohësh se çfarë anarke ekziston në sferën e ndërtimeve... Ka edhe probleme të arsimit, të shëndetësisë, të politikave fiskale, të krimit dhe kontrabandës së organizuar për të cilat do të duhej të zhvillohej debat. Më duket se përqendrimi i deputeteve dhe i grupeve parlamentare ka qenë i përqendruar në sferat ku partitë politike ose grupet parlamentare kanë bërë më shumë propagandë. Po ta shikojmë në këtë rrafsh, debati është shumë për të dëshiruar.

PAQJA: Sa jeni transparent në punën tuaj dhe sa bashkëpunoni me mediat. A kanë mediat qasje të mjaftueshme në punën e mekanizmave të Kuvendit?

Krasniqi: Të gjitha punët që i kemi bërë në kuvend, ne ose i kemi shfaqur në

internet, ose gazetarët kanë qenë prezent pothuajse gjithnjë në parlament dhe nuk di ndonjë rast që ata ta kenë bërë ndonjë kërkesë e unë të mos u jem përgjigjur kërkesave të tyre. Mund të them se edhe pasqyrimi i punëve të kuvendit, nëpër mediat e ndryshme, ka qenë në shumicën e rasteve korrekt dhe për këtë i kam falënderuar dhe përsëri i falënderoj. Unë e di se mediat nganjëherë vrapojnë pas ekeseve, pas sensacioneve, që në fund të fundit ky është niveli i zhvillimeve tek ne dhe përpiqem t'i kuptoj se çdo gazetë dëshiron që të ketë tirazh më të madh.



Partitë politike të mos i avancojnë në radhët e veta njerëzit të cilët kanë qenë në shërbim të sistemit të kaluar

PAQJA: Kohët e fundit është ngritur debati mbi dosjet e komunizmit. Ju keni qenë i burgosur politik. Cili është mendimi juaj për dosjet dhe si duhet të trajtohen njerëzit që janë përfshirë në to?

Krasniqi: Realisht unë kam menduar shumë. Në mandatin e kaluar kam qenë unë që e kam kërkuar këtë çështje dhe është zhvilluar një debat në kuvend. Duhet të bëhemi real se debati për krimet e komunizmit në Kosovë dallon shumë nga vendet e tjera. Dallon shumë se dhuna që është drejtuar mbi

shqiptarët nuk ka qenë vetëm dhunë e sistemit komunist, por ka qenë dhunë e një nacionalizmi dhe shovinizmi të egër për njëqind vjet, që ka qenë e orientuar kundër shqiptarëve jo si komunistë por si shqiptarë. Dhe në këtë drejtim mendoj se duhet ta shikojmë se ekziston një dallim në krahasim me vendet e tjera dhe unë, edhe këtyre ditëve, kam menduar shumë për këtë çështje. Ndoshta është më mirë për të gjithë shoqërinë shqiptare (jo vetëm për parlamentin dhe deputetët) që të arrijmë një konsensus (edhe ashtu jemi shumë mbrapa vendeve që kanë kaluar një tranzicion nga sistemi komunist në atë demokratik) dhe ta mb-

yllim këtë debat me një pajtim ta quaj kombëtar dhe çështjen se kush kishte të drejtë në të kaluarën t'ia lëmë historisë. Mendoj se dënimin më të madh, jo vetëm komunizmit që e kemi pas në Kosovë por edhe shovinizmit, ia kemi dhënë me fitoren që kemi korrur dhe, edhe si institucione, edhe si parlament, edhe si intelektual, mendoj se më tepër duhet të përpiqemi që ta ndërtojmë një vizion të ri për të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës. Mendoj se duhet të bëhet një diferencim i lehtë dhe ai diferencim të bëhet në kuadër të partive politike. Partitë politike nuk duhet t'i avancojnë në radhët e veta njerëzit

të cilët kanë qenë në shërbim të sistemit të kaluar. Kanë kaluar disa vite dhe mund të them se tani në Kosovë ekziston një moshë e njerëzve të pjekur, që nuk kanë hipoteka personale nga e kaluara. Mendoj se është një moshë që i kalon 40 vjet, që s'ka hipoteka nga e kaluara dhe nuk është e drejtë që ky numër njerëzish, që ndoshta mund ta përbëjë mbi 70 për qind të popullsisë së Kosovës, të maltretohen për hir të atyre 20 për qind të tjerëve, sepse megjithatë synimi është që t'i krijohet një jetë e mirë shumicës. Ekziston një pakicë që ka bërë të këqija, por ekziston edhe një pakicë që i ka përjetuar të këqijat. Mendoj se obligimi i kësaj shoqërie është që, së paku, moralisht të japë vlerësimin se realiteti i sotëm, ka ardhur

nga njerëzit që kanë bërë sakrificë dhe nga njerëzit të cilët kanë pranuar edhe të flijohen, për t'u arritur ky realitet që është sot në Kosovë. Unë mendoj se kjo na duhet neve sot, si shoqëri.

PAQJA: Projektligji për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së, i miratuar në vitin 2006 ka mbetur i panënshkruar nga përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së dhe është kthyer mbrapsht. Kjo kategori e personave ka ngelur nën mëshirën e fatit të miratimit të këtij ligji. Kur do ta rifutni në procedurën e votimit këtë ligj?

Krasniqi: Unë mendoj se ky ligj së shpejti do të jetë në procedurë dhe mendoj që kuvendi i Kosovës duhet të miratojë ligje edhe për kategoritë e tjera që nuk janë përfshirë në këtë ligj dhe duhet të konsiderohen familje të dëshmorëve të kombit, sepse ky ligj ka të bëjë vetëm me familjet e dëshmorëve të UÇK-së, (ndoshta edhe vetë kam qenë ihtar që kjo të jetë kështu, sepse nuk kishim mundësi të tjera dhe ne kishim obligim që, së pari, për këto familje që kanë vuajtur dhe i kanë humbur të dashurit e tyre të përfitojnë një pension) dhe pastaj të bëjmë një ligj edhe për të gjitha kategoritë e tjera të cilat kanë kontribuar dhe thjesht janë flijuar për këtë realitet që kemi tani.

PAQJA: Jeni i vetmi prej krerëve të institucioneve të Kosovës që ka guxuar ta përmendë hapur kërkesën për bashkim kombëtar. A e shihni këtë si orientim të mundshëm në të ardhmen, apo e lidhni vetëm me mundësinë e ndarjes së Kosovës?

Krasniqi: Realisht unë nuk kam dëshirë të ketë tema tabu. Nëse e kemi pranuar sistemin demokratik, si sistemin më të mirë të mundshëm, sepse ndoshta edhe ky nuk është bash më i miri, unë nuk jam që të ketë tema tabu. Kjo nuk është çështje e tashme e shqiptarëve, por është çështje e shekullit të nëntëmbëdhjetë e këndeje dhe ndoshta shqiptarët do të duhet të mendonin (mendoj se edhe janë krijuar kushtet), për një përpjekje për të bërë integritet të reja në shërbim të aspiratave të qytetarëve të Kosovës dhe mendoj që nuk po shfrytëzohet re-

aliteti i ri për të krijuar raporte të bashkëpunimit mes këtyre njësive administrative shtetërore dhe gjysmë shtetërore të shqiptarëve për bashkim. Do të duhej që shqiptarët (edhe pse janë të ndarë në këta kufij, janë në një pozitë shumë më të mirë se sa që kanë qenë deri më tani), të mendojnë për integritet që i sjell koha. Nuk ka kurrfarë mëkati dhe kurrfarë problemi as për bashkimin evropian dhe as për dikë tjetër që të mes Kosovës, Shqipërisë, por edhe Maqedonisë, të vendosen marrëdhënie të reja integruese në fushën e arsimit, në fushën e kulturës, në fushën e ekonomisë, në fushën e qarkullimit të njerëzve dhe të mallrave, që do të thotë se, në fund të fundit, zgjerimi i tregut mes hapësirës shqiptare do të ishte në interes jo vetëm të shqiptarëve por edhe të tjerëve.



Janë të pamundura bisedimet me Serbinë

PAQJA: Është temë aktuale rifillimi i bisedimeve me Serbinë. Cili është qëndrimi juaj si kryetar i kuvendit lidhur me këtë?

Krasniqi: Unë e kam thënë edhe publikisht se, realisht, bisedimet me Serbinë janë të pamundura. Në radhë të parë, bisedimet politike kanë përfunduar. Serbia ka marrë pjesë dy vjet në bisedimet e Vjenës, ka imponuar shumë në dokumentin e Ahtisarit dhe në fund nuk e ka pranuar. Unë mendoj që Serbia duhet, në radhë të parë, ta pranojë realitetin që është krijuar, ta pranojë dokumentin e Ahtisarit dhe t'i ndërpresë ndërhyrjet politike në dëm të hapësirës territoriale të Kosovës. Kjo do të ishte faza e parë dhe, natyrisht, ne pastaj si dy vende fqinje kemi nevojë të bisedojmë për shumëçka, ashtu qysh kemi nevojë të bisedojmë me Maqedoninë, me Shqipërinë, me Malin e Zi, pse jo edhe me Serbinë. Por me këtë qëndrim që ka Serbia tani për tani, duke mos e njohur realitetin e ri që është krijuar në Kosovë,

duke mos e njohur pavarësinë e Kosovës, unë nuk e di si do të bisedojë Kosova për çështje teknike me Serbinë. Unë këtë e kam thënë dhe po e përsëris prapë se janë të pamundshme dhe do të ishin bisedime pa bukë siç thotë populli. Do të ishin bisedime sa për të biseduar, por pa asnjë rezultat. Këtë e ka dëshmuar Rambujeja, këtë e kanë dëshmuar bisedimet e Vjenës, andaj unë mendoj se Serbia do të duhej të ndërpriste çdo veprimtari diversive ndaj Kosovës dhe qytetarëve të saj.

PAQJA: Cilat janë prioritetet tuaja në planin e punës për vitin 2009?

Krasniqi: Ne jemi duke e bërë planin e punës dhe besoj që do ta kemi në fillim të muajit mars. Plani kryesor është miratimi i ligjeve që është detyrë parësore e kuvendit. Për shkak të vëllimit të punëve jemi vonuar në hartimin e rregullores së re të kuvendit, të cilën do ta kemi së shpejti dhe, natyrisht, para pak kohe kemi miratuar edhe planin e rregullimit për punën e kuvendit, jo vetëm për këtë legjislaturë, por një plan strategjik afatgjatë dhe kemi për detyrë që të vendosim kontakte e marrëdhënie bashkëpunimi me sa më shumë parlamente dhe, natyrisht, të vazhdojnë kontaktet edhe profesionale, edhe të diplomacisë ndërkombëtare, për të vendosur forma të reja bashkëpunimi ndërparlamentar me parlamentet e rajonit, por edhe të Evropës.

PAQJA: Në fund, cili do të ishte mesazhi juaj për lexuesit e revistës "Paqja" me rastin e njëvjetorit të shpalljes së pavarësisë?

Krasniqi: Në radhë të parë do t'iu përgëzoja për punën që po bëni dhe do t'iu uroja sukses revistës suaj në pasqyrimin e realitetit të Kosovës dhe perspektivës së qytetarëve të Kosovës. Shfrytëzoj rastin që të gjithë lexuesve të revistës "Paqja", por edhe të gjithë qytetarëve të Kosovës, t'ua uroj njëvjetorin e shpalljes së pavarësisë. Ne i dimë kërkesat që i kemi pasur, por fitoret që kemi arritur pas qershorit të vitit 1999, por tani edhe njohjet ndërkombëtare që i janë bërë shtetit të Kosovës, janë një fitore e madhe e shqiptarëve dhe e gjithë qytetarëve të Kosovës dhe, natyrisht, tani ne duhet të krijojmë vizione të reja për funksionimin e institucioneve tona dhe për zhvillimin e demokracisë. ■

Presheva, Bujanoci dhe veriu i Kosovës

Dhjetë vjet pas luftës dhe një vit pas pavarësisë së Republikës së Kosovës, Serbia assesi nuk pajtohet me realitetin e krijuar në këtë shtet të ri, të njohur ndërkombëtarisht nga mbi pesëdhjetë shtete



Ferid SELIMI

Presheva e Bujanoci, dy komuna me shumicë shqiptare në Serbi, për disa të njohura me emërtimin: Kosovë Lindore, e për disa të tjerë: Luginë e Preshevës, sërish u aktualizuan në përfundim të vitit që shkoi. Serbia, e pangopur me torturat, abuzimet, maltretimet, vrasjet, plagosjet, deportimet dhe dhunën ndaj shqiptarëve, dhjetë vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe tetë vjet pas përfundimit të konfliktit me shqiptarët e këtyre trevave, tregoi dhëmbët dhe lëkurën e vet të vërtetë, duke bastisur dhjetëra shtëpi e duke arrestuar dhjetë të rinj nga komuna e Preshevës. Arrestimi ishte pompoz. Kamerat kishin filmuar të gjitha veprimet e xhandarmërisë serbe gjatë atij spektakli të montuar politikisht. Ky filmim ia bëri me dije botës edhe një herë se Serbia me në krye koalicionin qeverisës "pro-evropian" është ende larg Evropës, e bile as ka ndërmend t'i bashkohet kësaj familjeje. Jo vetëm kaq. Serbia me të

gjitha instrumentet e saj politike, diplomatike, ekonomike etj, synon që të ndërhyjë në punët e brendshme të Republikës së Kosovës. Në vend që të bëhet një faktor stabiliteti në rajon (kështu kanë premtuar politikanët serb dhe me këtë premtim i kanë fituar zgjedhjet e fundit), ajo vazhdimisht orvatet që ta destabilizojë Kosovën, e me të edhe tërë rajonin. Dhjetë vjet pas luftës dhe një vit pas pavarësisë së Republikës së Kosovës, Serbia assesi nuk pajtohet me realitetin e krijuar në këtë shtet të ri, të njohur ndërkombëtarisht nga mbi pesëdhjetë shtete. Ky mospajtim i saj shprehet në forma të ndryshme e sidomos:

1. Duke maltretuar shtetasit e vet shqiptarë në tri komunat: Preshevë, Bujanoc e Medvegje, sikurse ndodhi skenari i 26 dhjetorit, kur u arrestuan dhjetë të rinj shqiptarë nga Presheva, nën dyshimin që kanë bërë krime lufte në territorin e Gjilanit, gjatë periudhës kohore qershor-tetor 1999;

2. Duke shtrënguar serbët që jetojnë në Kosovë që të mos bëhen pjesë e pushtetit dhe të mos pranojnë asgjë që është kosovare. Kështu, gjysma e qytetit e Mitrovicës dhe e disa fshatrave që gjenden matanë Lumit Ibër, që nga qershori i vitit 1999, janë bërë vende të pashkelura për shqiptarët që jetojnë në Kosovë. Pjesa veri-

ore e Kosovës, (pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës, matanë Lumit Ibër), Zveçan, Leposaviq e Zubin Potok, që nga hyrja e forcave të NATO-s, në qershor të vitit 1999, u ndanë me tela gjemborë nga pjesa tjetër e Kosovës. Ata që jetojnë në pjesën veriore të Kosovës, nuk e kanë lirinë e duhur për të shëtitur lirshëm në pjesën jugore të saj. Ndërsa këta të quajturit "banorë jugorë të Kosovës", e kanë të ndaluar të shkelin në veri të Kosovës; dhe,

3. Duke u bërë trysni vendeve të ndryshme që të mos e pranojnë realitetin e krijuar, do të thotë pavarësinë e Kosovës, me arsyetim që Kosova është territor i Serbisë.

Në Kosovë shumë prioritete dhe të drejta për pakicën serbe

Kosova, në anën tjetër, në bashkëpunim me ndërkombëtarët, bazuar në dokumentin gjithëpërfshirës të z. Ahtisari dhe Ligjit për Qeverisje Lokale të Kosovës, mundohet që të joshë pakicën serbe që jeton në Kosovë, duke bërë një diskriminim pozitiv, ndaj tyre. Kështu, nëpërmjet decentralizimit ka bërë legalizimin e enklavave me shumicë serbe, dhe me të edhe lidhjen e tyre horizontale me Qeverinë e Republikës së Serbisë. Decentralizimi që do të duhej parë si dobësim i Qendrës, e që do të duhej të





bëhej në mënyrë vertikale, ku komunat do të fitonin më tepër kompetenca, e qytetarët do të ishin më të kënaqur me shërbimet që do t'i afrohen në Kosovë, për pakicën serbe nuk e ka këtë kuptim. Edhe pse presidenti Ahtisari, ka paraparë shumë prioritete dhe të drejta për pakicën serbe dhe komunat ku jetojnë këto pakica, serbët e Kosovës, të shtyrë nga Qeveria e Beogradit, nuk pranojnë asgjë që u ofrohet. Ata në asnjë mënyrë nuk pajtohen me pavarësinë e Kosovës.

Demolimi i dy pikave doganore nuk ishte i rastësishëm

Serbia e mësuar me kolonizime dhe me pushtime të tokave të huaja, edhe sot në shekullin e njëzetentjetë, mëton pushtimin e tokave të reja. Krejt kjo ndodh tani, kur Kosovën e kanë njohur më tepër se pesëdhjetë shtete të botës dhe kur Serbia ka kërkuar drejtësi në Gjyqin e OKB-së për legjitimitetin e Pavarësisë së Kosovës. Sulmi ndaj pikave doganore 1 dhe 31, në veri të Kosovës, nuk mund të kuptohet ndryshe pos si tentim i riokupimit të territorit të Kosovës nga ana e Serbisë. Demolimi i këtyre dy pikave doganore nuk ishte i rastësishëm dhe mund të dyshohet të jetë koordinuar nga qendrat e tjera jashtë Kosovës, do të thotë nga Serbia.

Fitohet përshtypja që këto dy skenarë të shkruara nga qeveria e Serbisë, (sulmi ndaj pikave doganore në Veri të Kosovës dhe arrestimi i të rinjve shqiptarë në Luginën e Preshevës) ishin koordinuar mirë vetëm e vetëm për të destabilizuar situatën politike në rajon.

Nëpërmjet skenarit të parë, Serbia mëton t'i tregojë botës që Kosova, ani se e ka shpallur pavarësinë, nuk ka au-

toritet mbi veriun e Kosovës dhe as që e ka pasur ndonjëherë. Por, në anën tjetër, lirisht mund të konstatohet që Serbia, që nga 11 qershori i vitit 1999, nuk ka pushtet në Kosovë, por pushteti i saj shtrihet në pjesën veriore të Kosovës, ku Kosova nuk e ka. E tërë kjo përpjekje politike e diplomatike e Serbisë ka një qëllim të vetëm: ta kthejë çështjen prapa dhe të arrihet një kompromis. Por, qëllimi i tyre mbase është: lëshimi pe i Qeverisë së Kosovës për të dhënë një pjesë të territorit të Kosovës, përkatësisht veriun e saj, në mënyrë që të blejë pavarësinë e vet nga Serbia. Ndërsa në rastin e dytë, shqiptarëve të mbetur në Serbi u bëhet me dije që nuk do të kenë jetë të rehatshme në tokën "serbe".

Në veri të Kosovës, pjesa dërmuese e qytetarëve i takon pakicës etnike serbe dhe Qeveria e Serbisë ka nisur blerjen e pronave të shqiptarëve në veri. Nëse Qeveria e Serbisë arrin të blejë pronat dërmuese të shqiptarëve në veri të Mitrovicës si dhe në komunat: Zvečan, Leposaviq e Zubin Potok, Kosova nuk mund të kërkojë asgjë në atë anë. Sa më herët që Qeveria e Kosovës ta kuptojë këtë, më mirë dhe më lehtë do të ishte për të. Humbja e një pjese të territorit është e dhimbshme, por, mesazhet e ndërkombëtarëve ishin të qarta. Ata shpesh e përsërisnin: "Zgjidhja do të jetë e dhimbshme për të dy palët". Kjo flet mjaft për ata që e kuptojnë sadopak politikën. Për Serbinë ishte e dhimbshme Pavarësia e Kosovës, ngase u dëbua nga një pjesë e territorit të okupuar njëqind vjet më parë, ndërkaq për Kosovën, do të jetë e dhimbshme që një pjesë e territorit (veriu i saj), nuk e pranon pavarësinë e Kosovës, ose më

mirë të thuhet nuk pranon të jetojë nën shtetësinë e Kosovës. Si Kosova, ashtu edhe veriu i saj, thirren në vetëvendosje. Sa kanë të drejtë, mbetet të shihet. Por një gjë është e qartë, serbët e Kosovës, nuk duan të jetojnë në fqinjësi e as në një shtet me shqiptarët. Ata duan të jetojnë në shtetin serb dhe të marrin urdhra nga udhëheqësit serbë, e jo nga shqiptarët.

Fati i Preshevës dhe Bujanocit

Tani shtrohet pyetja: Po Presheva e Bujanoci? Ngjasojnë këto me veriun e Kosovës? Apo ndoshta kjo çështje ende nuk ka ardhur në rend dite?

Nëse pakica serbe që jeton në veri të Kosovës, e që është tejet e privilegjuar, nuk e do pushtetin e Kosovës, me çfarë të drejte do të kërkojnë që territoret e komunave, Preshevë e Bujanoc, të jenë edhe më tutje pjesë të Serbisë?

Presheva e Bujanoci deri në vitet e pesëdhjeta të shekullit të kaluar, ishin pjesë e territorit të Kosovës, por që nga pjesa e parë e viteve të pesëdhjeta, pa vullnetin e shqiptarëve, iu ngjiten Serbisë. Dyzet vjet më vonë (më 1992), shqiptarët e këtyre dy komunave kanë mbajtur referendumin për autonomi politike territoriale me të drejtë bashkimi me Kosovën. Këto dy elemente, mund të merren si pikënisje të negociatave. Zgjidhja që do të dilte nga këto negociata, do të ishte po ashtu e dhembshme, por, më mirë një fund tragjik se një tragjedi e pafund.

Është koha të qetësohen gjakrat. Obligim moral dhe politik i qeverive të të dy shteteve, është që të përgatisin popullatën për ndonjë solucion të ri. Popullata është lodhur tej mase dhe nuk mund të qëndrojë ashtu pa definuar cakun e tyre. Shqiptarët dhe serbët, si duket vetëm në një gjë janë të një mendjeje. Janë ngopur me luftë! Mjaft më me luftëra, viktima të pafajshme e patriotizëm të rrejtshëm. Ose, Serbia do të duhej të bënte më tepër për të sensibilizuar situatën politike në pjesën jugore të saj. Mjaft më me frikësime dhe dhunë ndaj pakicës shqiptare. Ajo duhet t'i joshë ata (ashtu sikurse Kosova që i josh serbët), në mënyrë që karshi Botës të tregohet tamam ashtu si deklarohen politikanët serbë: shtet demokratik, me plot kuptimin e fjalës. ■

Korrespondencë nga Shkupi

Maqedonia në prag të zgjedhjeve të dyfishta



Avni AVDIU

Samë shumë afrohet procesi zgjedhor në Maqedoni, aq më shumë rriten tensionet dhe shqetësimet politike. Më 22 mars, këtu, do të mbahen njëkohësisht zgjedhje presidenciale dhe lokale.

Kalkulimet e para tashmë janë bërë. Në emisionin 'Kontrast' të TV'AlsatiM' lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, u shpreh se është në bisedime me partnerin e koalicionit për të arritur një marrëveshje, që kësaj radhe ta mbështesë kandidatin e VMRO-s, me kusht që më 2014 presidenti i Maqedonisë të zgjidhet shqiptar. Edhe pse të ardhmen nuk e di askush nga ne, nuk përjashtohen mundësitë që të bëhen plane për ardhmërinë, megjithëse asnjëri nuk mund të garantojë se çfarë ndryshime do të ndodhin gjer në vitin 2014. Mirëpo pak a shumë dilemat i zgjidhi menjëherë kryeministri Gruevski, i cili u prononcua se nuk ka shanse as teorike dhe as praktike që kryetari i shtetit të jetë në të ardhmen shqiptar. Për çudi pas kësaj deklarate ksenofobike, sërish shqiptarët heshtën, ama bash heshtën të gjithë.

Ata vazhdojnë të ushqehen me iluzione të ekzaltuar nga proceset politike në SHBA - në. Ëndërrojnë përsëritjen e fenomenit Obama edhe në Maqedoni, duke harruar se në çfarë vendi jetojnë.

Dhe pas asaj de-

klarate pasoi takimi i befasishëm Ahmeti-Thaçi. Ky takim i papritur i liderëve të partive më të mëdha PDSH-së dhe BDI-së ngjalli kërkshërinë e opinionit. Nga takimi u tha se ata ishin zotuar për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, me qëllim që të shmangen incidentet e mundshme, gjë që është një nga kushtet e vëna edhe nga komuniteti ndërkombëtar.

Dhe përderisa pritej që takimi të rezultonte me ndonjë përgjigje ndaj deklaratës së kryeministrit Gruevski (*se maqedonasit nuk do të votojnë kurrë kandidat shqiptar*) dhe në vend se të dilnin me ndonjë zë të përbashkët, ose edhe më mirë me ndonjë hap konkret bashkëpunimi, ata rishtas i drejtuan shigjetat kundrejt njëri-tjetrit.

Ky takim u pa edhe si demonstrim i supremacisë, për të treguar se cilët janë faktorët kryesorë të shqiptarët e Maqedonisë. Po ashtu, te këto parti është ngjallur edhe frika nga konkurrenca pas paraqitjes në skenë të subjektit të ri politik 'Demokracia e Re' e Imer Selmanit dhe të kandidimit të Rufi Osmanit për postin e kryetarit të Gostivarit.

Tre shqiptarë dhe katër maqedonas në garë për kryetar të shtetit

Çfarë mjerimi mentalitetesh: sapa doli një kandidat shqiptar për kryetar shteti, menjëherë pas tij, pothuajse të gjitha partitë e tjera, nxituan të nxjerrin edhe ato nga një kandidat (DR- Imer Selmanin;

BDI- Agron Buxhakun; PDSH- Mirushe Hoxhën; Kryetari i Iliridës Nevzat Halili dështoi në grumbullimin e nënshkrimeve dhe për këtë akuzoi PPD -në; nga ana tjetër blloku maqedonas doli me katër kandidatë: VMRO- Gjorgji Ivanovin; LSDM- Lubomir Fërçkovskin; PLD- Navno Ruzhin dhe kandidati i paruar Lube Boshkovski, ish-i pandehuri për krime ndaj shqiptarëve në Luboten, gjatë luftës së 2001-shit, i liruar si 'i pajshëm' nga Tribunali i Hagës).

Ashtu siç i fitoi bindshëm zgjedhjet parlamentare, Gruevski dëshiron t'i fitojë edhe ato lokale dhe presidenciale. VMRO-ja dhe Gruevski kanë rejting më të lartë - e gjithë kjo jo si rrjedhojë e qeverisjes së mirë (duke pasur parasysh papunësinë e lartë, dështimin në politikën ndërkombëtare (NATO UE), shtrenjtimin e çdo produkti etj.), por si rezultat i nënçmimit të shqiptarëve dhe degradimit më të madh që u bëhet atyre me mosimplementimin e Marrëveshjes së Ohrit.

Kryetari i BDI-së, Ahmeti, e ka bërë të ditur qartë se do ta përkrahë kandidatin e VMRO-s, i cili njihet mirëfilli për qëndrimet e tij antishqiptare edhe kundër marrëveshjes së Ohrit.

BDK mbështet DR në zgjedhjet presidenciale. BDSH - ja ka pezulluar pjesëmarrjen në zgjedhje, sepse sipas kryetarit Bardhyl Mahmuti, kjo parti ka informacione të sigurta për skenarë antishqiptarë gjatë ditës së zgjedhjeve.

Në të gjitha zgjedhjet presidenciale në Maqedoni, prej fillimit të pluralizmit e deri më sot, shqiptarët kanë qenë faktorë

v e n -



dimtarë në zgjedhjen e kryetarit. Gjatë këtyre viteve të pluralizmit, shqiptarët si popull, me durim, kanë dëgjuar vazhdimisht vendimet e partive kryesore shqiptare në Maqedoni, se cilin kandidat maqedonas duhet ta votojnë.

Megjithatë, për fat të keq, koha tregoi se 'pazarllëqet' që bëhen për t'i dhënë votat ndonjë kandidati, më shumë janë interesa partiake sesa interesa të shqiptarëve. Madje Ahmeti, para gazetarëve pas takimit me Thaçin për lapsus ose me vetëdije, e tha hapur se për të dhe partinë e tij mbi të gjitha dhe prioritet janë interesat e shtetit, pastaj vijnë të tjerat.

Mirëpo është momenti që partitë shqiptare të bëjnë strategji për të arritur së paku atë që u takon shqiptarëve. Shqiptarët kanë mundësi historike që në Maqedoni të instalojnë postin e nënkryetarit të shtetit. Kjo është kërkesë legjitime e shqiptarëve në Maqedoni.

Përndryshe nëse kjo nuk arrihet, ndërsa shqiptarët vazhdojnë të votojnë kandidatin (maqedonas) për president, atëherë vota shqiptare kthehet kundrejt vetë votuesve, ashtu siç është dëshmuar gjer më tani. Të kujtojmë se votat e shqiptarëve ishin vendimtare për zgjedhjen e Boris Trajkovskit (të ndjerë) dhe atij aktual Branko Cërvenkovskit.

Rikthehet Rufi Osmani

Të një rëndësie të veçantë janë edhe zgjedhjet lokale. Ato fitojnë peshë për faktin se pas mbi një deçenie pushimi nga skena politike kthehet sërish Rufi Osmani, i cili është kandiduar për kryetar komune në Gostivar. Kandidimin e tij ai e ka arsyetuar për të rikthyer postin që ia mori dhunshëm pushteti i atëhershëm i Cërvenkovskit, pas trazirave të përgjakshme rreth përdorimit të flamurit, pas të cilave pasoi burgosja e tij. Mirëpo siç duket, qëllimi i tij është edhe më i thellë se kaq. Ai do ta kuptojë peshën e tij politike fillimisht në qytetin e tij, për të vazhduar sigurisht pas fitores së mundshme me formimin e partisë së re politike. Madje-madje kthimi i tij në politikë është përfolur shumë në Maqedoni dhe ka pasur përpjekje që ai të bindet për t'u futur në parti të ndryshme politike, oferta të cilat, siç është shprehur ai, i ka refuzuar.

Me paralajmërimin e kthimit të Rufi Osmanit në politikë, mund të bëhet një kthesë në orientimin e shqiptarëve në politikë, për faktin se ai gëzon një rejting të madh të shqiptarët, në përgjithësi. Partitë aktuale përcjellin me ankth lëvizjet e tij, sepse shohin një 'rrezik' nga krijimi i një elite të re të politikëbërësve shqiptarë në Maqedoni.

E rëndësishme është të shihet se sa e fuqishme do të dalë edhe DR e Imer Selmanit. Disa sondazhe kanë treguar se ai gëzon gjithashtu rejting të madh, madje është edhe i privilegjuar në shumë takime me funksionarë ndërkombëtarë.

Së këtejmi, zaten edhe nuk është vetëm e nevojshme, por edhe e domosdoshme, që skena politike shqiptare në Maqedoni të freskohet me figura të reja, por edhe të dëshmuara, të cilat do të punonin ndershmërisht për të mirën e popullit. Përndryshe, gjer më tani, shqiptarët në Maqedoni nuk kanë qenë të përfaqësuar denjësisht nga elitat politike. Vota e tyre më pas është defaktorizuar dhe ky është fakt.

Andaj zgjedhjet e ardhshme presidenciale dhe lokale do ta humbin çdo kuptim nëse vazhdojnë të mbeten vetëm riciklim i figurave të mëparshme, pa sjelljen e një fryme të re, që do të garantonte ndershmëri në premtime. ■

Osmanlinjt

Kthimi i Turqisë nga bota arabe dhe islame, si rezultat i largpamësisë së Tajib Erdoganit, Abdullah Gylit dhe politologut të madh Ahmed Davutogllu, ka ngjallur shpresat tek muslimanët se, më në fund, disa gjëra në të ardhmen do të ndryshojnë pozitivisht

Ajni SINANI


Me ardhjen në pushtet të Partisë së Drejtësisë dhe të Zhvillimit (AKP) të Rexhep Tajib Erdoganit më 2002, zhvillimi i gjithëmbarshtëm ekonomik në Turqi mori hov. Ajo tash ka një zhvillim ndër më të shpejtët në botë. Në Turqi, nga dita në ditë po shtohet kampi i besimtarëve kundrejt shekullaristëve.

Kjo bie në sy me rastin e zgjedhjeve. AKP në votimin e vitit 2007 doli edhe më e fuqishme përballë rivalëve të saj politikë.

Ajo është vlerësuar nga vendet perëndimore si një parti pro-islame e moderuar, që si prioritet ka reformat në ekonomi, zhvillimin e vendit, zhvillimin e turizmit, luftimin e korrupsionit, ruajtjen e traditës kulturore dhe fetare dhe kultivimin e vlerave të moralitetit, madje edhe në politikë. Pretendimet e saj nuk janë të formojë një qeveri 'rigjide' islame, por një qeveri ku do të bëhej një lidhje mes politikës dhe fesë në funksion të zbatimit të një modeli islam turk shekullarist, ku do të bashkëjetonin

islami dhe shekullarizmi. Kjo për shkak të natyrës laike të Turqisë kemaliste dhe kundërshtimit të ushtrisë si pararojë e kushtetutës laiciste kemaliste. Madje, ushtria turke disa herë ka kërcënuar se do të ndërhyjë me puç ushtarak dhe se nuk do të lejojë kurrfarë ndryshimesh në dem të kemalizmit.

Prandaj, AKP nga vendet jomuslimane është parë si një parti, përvoja e së cilës do të mund të aplikohet edhe në vende të tjera të botës arabe dhe islame. SHBA ka preferuar që modeli i qeverisjes së saj të



të e rinj

merret si shembull edhe nga lëvizjet e tjera islame në botë.

Orientimi drejt modelit osmanli

Pas zgjedhjeve të fundit, në funksion të sendërtimit të platformës së saj politike, AKP ka filluar një transformim gradual të politikës së brendshme, ku mund të veçojmë qëndrimin e qeverisë në lidhje me mbulesën islame, si dhe një hapje në politikën e jashtme dhe përqendrimin e saj në Lindjen e Mesme, gjë që ka filluar të qartësohet me qëndrimin ndaj sulmit në Gazë.

Analistë dhe vëzhgues të shumtë vlerësojnë se tendencat e orientimit të Turqisë drejt ushtrimit të një islami praktik turk, që do të ishte një lloj i rikthimit të modelit osman, u shfaqën në mënyrë të qartë kur Tajib Erdogan përmendi termin “osmanlinj” gjatë sulmit të Izraelit mbi Gazën. Ai duke i kujtuar çifutëve se ishte Perandoria Osmane ajo që i mbrojti ata pas rënies së sundimit arab në Spanjë, tha se unë jam lider i shtetit që është pasardhës i saj. Me këtë deklaratë, Tajib Erdogan u bë udhëheqësi i parë turk që nga rënia e Hilafetit Islam (Perandoria Osmane) që krenohet me këtë perandori.

Duke iu referuar Perandorisë Osmane, vlerësohet se Tajib Erdogan dëshiron të shkruajë një orientim të ri politik për vendin e vet, duke e lidhur të sotmen e Turqisë me rrënjët e traditës osmane dhe të kthejë lavdinë e mëhershme të saj. Me qindra mijëra njerëz që dolën dhe e pritën Erdoganin pas braktisjes së Davosit dhe kthimit të tij në Stamboll me



parullat dhe brohoritjet e tyre, lajmëruan për këtë orientim të ri të ngjalljes së trashëgimisë së Perandorisë Osmane.

Prandaj, publicistë të shumtë në Turqi dhe në botën islame Tajib Erdoganin kanë filluar ta quajnë lideri i “osmanlinjve të rinj”, lider i “neo-otomanëve” dhe pasardhës i sulltan Abdul Hamidit.

Veprimi i Erdoganit është mirëpritur anekënd botës islame



Pas një heshtje të gjatë të Qeverisë Turke, ka kohë që njerëzit në Turqi nuk kanë përjetuar një gëzim të tillë, sikurse ndodhi me rastin e braktisjes së forumit të Davosit nga ana e Erdoganit. Masa e flakëruar nga gëzimi, pas mesnate, doli në numër shumë të madh për ta pritë atë, derisa po kthehej në Stamboll. Erdoganin u prit nga populli si një hero i vërtetë, si një sulltan dhe një lider i ri i botës.

Me të arritur në Stamboll ai mbajti një konferencë për shtyp dhe përshëndeti njerëzit që e kishin pritë me orë të tëra duke iu drejtuar me këto fjalë: “Të nderuar vëllezër dhe motra, e njoh mirë atë ndjenjë fisnike që iu ka sjellë këtu në këtë kohë. Unë vepra në emër të gjithë juve, që të ruaja nderin njerëzor”.

Pas namazit të xhumasë në Gazë,

me qindra mijëra njerëz dolën në rrugë që të shprehin mirënjohjen e tyre ndaj veprimit burror të Tajib Erdoganit. Kohëve të fundit, palestinezët kanë filluar t’i emërojnë fëmijët e tyre me emrin Turqi dhe dy fëmijë i kanë emëruar me emrin Tajib Erdogan.

Reagimet e Erdoganit, për krimet e bëra në Gazë nga forcat izraelite, janë mirëpritur anekënd botës islame. Mediat në botën islame vlerësojnë se Tajib Erdoganin është burrështetasi që ka turpëruar krimet e Izraelit dhe ka bërë të dështojnë përpjekjet e bëra nga industria e propagandës sioniste për t’i mbuluar krimet e sulmit mbi Gaza.

Për herë të parë që nga rënia e Perandorisë Osmane, Turqia po pritë me kaq entuziazëm nga bota arabe. Muslimanët kanë filluar ta quajnë Erdoganin kryeministër të botës islame. Për të thuren vjersha dhe këndohen këngë. Vlerësohet si udhëheqësi i vetëm që pati guximin dhe e tha të drejtën në prani të të gjithëve.

Analisti i njohur egjiptian Muhammed Hejkel, duke përshëndetur qasjen e Turqisë në çështjet e Lindjes së Mesme, u shpreh duke thënë “i dëshiroj një mijë herë mirëseardhje Turqisë dhe kthimit të saj nga bota arabe dhe islame”. Një politikan irakian, para ca ditësh, në një emision televiziv tha se arabët duhet t’i kërkojnë falje Turqisë, ngaqë gjatë Luftës së Parë Botërore luftuan përkrah britanikëve kundër Perandorisë Osmane.

Kthimi i Turqisë nga bota arabe dhe islame, si rezultat i largpamësisë së Tajib Erdoganit, Abdullah Gylit dhe politologut të madh Ahmed Davutogllu ka ngjallur shpresat tek muslimanët se, më në fund, disa gjëra në të ardhmen do të ndryshojnë pozitivisht. ■



Roli i shoqërisë civile në kontrollin dhe



Nazmi MALIQI

(Vazhdon nga numri i kaluar)

Mundësia për kontroll demokratik mbi strukturat e sigurisë duhet të përforcohet me normativë ligjore

Për shkak të specifikës të kompetencave që ushtrojnë këto struktura dhe për shkak të pasojave që mund të shkaktohen me tejkalimet eventuale të detyrave gjatë ushtrimit të punëve, me normativë ligjore, duhet të përforcohet mundësia për kontroll demokratik mbi strukturat e sigurisë në: Ministrinë e Mbrojtjes, Shtatmadhorinë, Policinë Ushtarake, Sektorin për Siguri dhe Kundërzbulim, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Drejtorinë për Sigurim dhe Kundërzbulim, në Agjencinë për Zbulim dhe në Drejtorinë për Menaxhim me Kriza.

Unë thjesht do të kisha parashtuar një dilemë: çka do të ndodhë me kontrollin parlamentar të shërbimeve sekrete, si strukturë organizative që është në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes, apo edhe të atyre strukturave që janë në kuadër të Gjeneral shtabit ushtarak, nëse mbeten edhe më tej jashtë kontrollit demokratik?

Njëra nga detyrat e Parlamentit dhe të Komitetit të posaçëm parlamentar, ose Komisionit për kontroll demokratik të strukturave të sigurisë, është ushtrimi i kontrollit të strukturave të sigurisë edhe përmes mbikëqyrjes së buxhetit të aktiviteteve të tyre. Por, kjo nuk do të mjaftonte nëse nuk ekziston një trup i përhershëm parlamentar, që do të ushtronte kontroll të rregullt parlamentar mbi ushtrinë, mbi policinë dhe mbi strukturat e tjera të sigurisë në koordinim me Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe me anëtarët e Qeverisë. Veçmas, Ministria e Mbrojtjes duhet të ushtrojë kontroll të përhershëm mbi ushtrinë (shërbimet në mbrojtjen dhe komandat ushtarake), në qasjen në sektorët e kundërzbulimit, gjegjësisht kyçjen në planifikim strategjik, në zhvillimin e strukturave ushtarake dhe në avancimin ushtarak. Nga kjo shihet se në vende me demokraci të zhvilluar, kontrolli civil i ushtrisë dhe i policisë bëhet në nivel ligjdhënës dhe ekzekutiv, me të drejtë për mbikëqyrje më transparente dhe më të gjithanshme. Do të ishte ironi, të nivelizohet kontrolli demokratik, me ndonjë referim të ndonjë ministri para zëvendësministrit para Komisionit parlamentar të mbrojtjes dhe sigurisë.

Me fjalë të tjera, reformat në sektorin e sigurisë, duhet të mbështeten në nevojën shoqërore për të ndërmarrë masa për tejkalimin dhe për zgjidhjen e problemeve që paraqiten si cenuese të të

drejtave të njeriut dhe të vlerave demokratike. Reformat në strukturat e sigurisë janë sfida, gjegjësisht nevojë shoqërore dhe do të kontribuonin për zgjidhjen e drejtë të problemeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të vlerave demokratike dhe të proceseve integruese drejt NATO-s, e njëkohësisht do të kontribuonin edhe për paqen dhe sigurinë në vend. Më pas, me vendosjen e kontrollit demokratik dhe civil, konstruksionit, gjegjësisht transformimit të forcave të sigurisë sipas standardeve të NATO-s, stërvitet dhe përgatitja profesionale e kuadrit, me reforma që si bazë do ta kishin strategjinë mbrojtëse të orientuar drejt strukturave euroatlantike, NATO-s dhe BE-së, do të kontribuohet për zgjidhjen e problemeve në të gjitha strukturat e sigurisë.

Shoqëria civile mund të ofrojë kontribut të rëndësishëm për hartimin dhe zbatimin e politikës së sigurisë

Përvojat tregojnë se reformat e sektorit të sigurisë, paraqesin një ndër çështjet më të ndërlikuara në vendet në tranzicion, ndaj për këtë qëllim kjo krijon hapësirë për elaborim të vazhdueshëm dhe për ndërmarrjen e hapave për përmirësime dhe përsosje të mëtutjeshme. Përveç gjyqësorit dhe ekzekutivit, shoqëria civile mund të ofrojë një kontribut të rëndësishëm për hartimin dhe zbatimin e politikës së sigurisë, ndërsa mediat kontribuojnë, duke e informuar publikun, për qëllimet dhe veprimtarinë e të gjithë aktorëve shtetërorë. Shoqëria civile dhe fusha e sigurisë, grupet brenda shoqërisë civile, si institucionet akademike, grupet e ekspertëve, OJQ-të për të drejtat e njeriut dhe OJQ-të të cilat merren me çështje që kanë në qendër politikën, mund të përpiqen aktivisht që të ushtrojnë ndikim tek vendimet dhe politikat në lidhje me fushën e sigurisë. Qeveritë mund të inkurajojnë pjesëmarrjen e OJQ-ve në debatin publik për sigurinë kombëtare, forcat e armatosura, rolin e policisë dhe shërbimin e fshehtë. Një debat i tillë, nga ana tjetër, rrit më tej transparencën e qeverisë.

Shoqëria civile është pasqyrë e proceseve demokratike dhe roli i saj është më



e mbikëqyrjen e strukturave të sigurisë

i madh dhe më funksional, nëse shteti ndërtohet në baza të vlerave demokratike. Shoqëria civile për elitat politike të cilat dëshirojnë të kenë shtet stabil dhe t'iu shmangen autoritarizmit, ndihmohet, apo i krijohen kushte për të funksionuar. Në shtetet të cilat kanë një demokraci të brishtë, ku politikat shtetërore i ndërtojnë në partizim të skajshëm, shoqëria civile, mediumet e pavarura, shoqatat joqeveritare të mbështetura me ekspertë të lëmenjve të caktuar mendohen si rrezik, në të shumtën e rasteve, nga qeveria apo nga partia e cila e ka shumicën parlamentare. Të njëjtit marginalizohen, madje ndodhin edhe hapa hakmarrës për bindjet e tyre politike. Sjelljet e tilla të qeverisë sjellin edhe vështirësi më të madhe për prezantimin e mendimit dhe projekteve ndryshe, madje kur bëhet fjalë për sferën e sigurisë, ndodh që aktiviteti i subjekteve joqeveritare, të shpallet dhe si antishtetëror, apo edhe të radhiten në struktura të ndryshme me epitete ashtu siç dëshiron ndonjë përfaqësues i qeverisë, apo ndonjë lider partiak, t'i vlerësojë.

Efikasiteti i shoqërisë civile, në kontrollin demokratik ndaj qëndrimeve qeveritare dhe sidomos në sferat e sigurisë, varet nga shumë faktorë: nga karakteri i strukturave politike të cilët udhëheqin shtetin, si e shikon kjo strukturë rolin e shoqërisë civile, deri në çfarë niveli janë krijuar kushtet për veprimin e shoqërive civile dhe për punën e tyre në ngritjen e iniciativave, lëvizjeve dhe krijimit të dialogut midis qeverisë dhe shoqatave joqeveritare për çështje të caktuara, sa shoqëria civile që është e organizuar në organizata të ndryshme joqeveritare e ka pavarësinë e saj të veprimit, apo është marionetë qeveritare apo klan qeveritar, si shoqëria civile e paraqet interesin e mirëqenies qytetare etj.

Nëse bazohemi në praktikat e demokracisë parlamentare si teori, atëherë nuk do të ishte vështirë të deshifrohet ky fenomen, por duke pasur parasysh përvojat praktike që kanë të bëjnë edhe gati me të gjitha shtetet e Ballkanit, kur parlamenti kontrollohet nga qeveria dhe kur qeveria kontrollohet nga një rreth i ngushtë partiak, ky fakt tregon se kontrolli demokratik është i fashitur, apo është edhe i pamundur.

Roli i mediave

Nga pikëpamja demokratike dhe e mirëqeverisjes, mediat kanë të drejtën e grumbullimit dhe të përhapjes së informacionit për çështjet që lidhen me sigurinë, që është në interes të publikut dhe kanë përgjegjësinë përkatëse që lajmet që japin të përmbushin standardet e së vërtetës, saktësisë dhe paanshmërisë.

Nëse mediumet llogariten pjesë e shoqërisë civile, duke u bazuar në rolin kyç në bartjen e informacioneve, por edhe në mbrojtjen e interesave të qytetarëve në politikë, nga perspektiva demokratike roli i mediumeve është edhe në bartjen e informacioneve edhe në çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë, që është në interes për opinionin. Kuptohet se mediumet do të kishin një rol funksional nëse krijojnë standarde për t'iu besuar, nëse krijojnë një transparencë edhe për punën e strukturave të sigurisë, pa marrë parasysh, se a bëhet fjalë për ushtrinë, forcat e policisë, apo edhe për shërbimet sekrete.

Roli i shoqatave joqeveritare në kontrollin e sektorit të sigurisë

Roli i shoqatave joqeveritare në kontrollin e sektorit të sigurisë duhet të mendohet si bashkëveprim në krijimin e kulturës së komunikimit, krijimit të

kulturës për siguri, në krijimin e besimit reciprok qytetar dhe strukturat e sigurisë. Në këto vite të kaluara, nuk mbahet mend që ndonjë organizatë joqeveritare apo ndonjë institucion hulumtues i pavarur të kenë pasur mundësinë e komunikimit zyrtar, për t'u njoftuar më për së afërmi me punën e strukturave qeveritare të sigurisë.

Bashkëpunimi i organizatave joqeveritare me sektorin e sigurisë, deri më tani, kanë qenë të ndërtuara në nivel paradoksal: për punët e sigurisë duhet të dijë vetëm një grup i ngushtë dhe ato janë çështje sekrete me interes të veçantë. Edhe pse ndryshimet në sistemet politike bazohen në jetën politike shumëpartiake, megjithatë strukturat e sigurisë, partia që është në pushtet i partizon dhe thuajse e shmang tërësisht bashkëpunimin me organizatat joqeveritare që janë jashtë kontrollit të saj. Si duket kreu qeveritar, ose thënë shkurt kreu partiak ka mundësuar një numër minimal të projekteve ose të aktiviteteve të çështje sigurisë, apo edhe të çështjeve të reformave me strukturat e sigurisë, me ndonjë partneritet me ndonjë organizatë joqeveritare. Nëse edhe ka ndonjë aktivitet të tillë, ato më tepër janë projekte të mbikëqyrura dhe të dirigjuara nga partia politike e cila është në pushtet.

Kur bëhet fjalë për format e veçanta të kontrollit të strukturave të sigurisë jashtë parlamentit, apo jashtë komisionit parlamentar, kur bëhet fjalë për avokatin e popullit, roli i tyre mbikëqyrës thuajse nuk ekziston. Kjo mund të shihet vetëm në periudha incidentale, por kjo nuk e kompenson rolin komplet që ka ky institucion për kontrollin dhe mbikëqyrjen e strukturave të sigurisë. ■

(Autori është profesor në Universitetin FON në Shkup)



Njëra ndër shumë familjet e cila nuk ka "mundësi" t'i gëzohet lirisë është edhe familja Qallakaj nga Baballoqi i Deçanit, e cila përveç kushteve të rënda ekonomike, bart në gjirin e vet edhe dhembje të madhe. Gjatë luftës, kjo familje pati një anëtar të vrarë, dy të zhdukur dhe një dëshmor kombi

Mevludë ZEJNULLAHU

Fshati Baballoq, që ndodhet 12 km larg Deçanit, është një nga 42 fshatrat e kësaj komune. Ky fshat ka 120 shtëpi dhe përafërsisht 1000 banorë.

Lufta e fundit në Kosovë i solli këtij fshati shumë dëme, duke lënë shumë njerëz të vrarë, të plagosur dhe të zhdukur. Natyrisht, sikurse në çdo vend të Kosovës, edhe këtu Ushtria Çlirimtare u organizua në mbrojtje të banorëve dhe në luftë kundër armikut. Si rezultat i luftës në këtë fshat ranë heroikisht 11 dëshmorë.

Edhe pse kaluan afro dhjetë vite nga përfundimi i luftës, ata të cilët e paguan shtrenjtë këtë gjysmë lirie, jetojnë në kushte të rënda ekonomike e sociale dhe nuk gëzojnë thuajse asnjë përkujdesje institucionale.

Njëra ndër shumë familjet e cila nuk ka "mundësi" t'i gëzohet lirisë është edhe familja Qallakaj, e cila përveç kushteve të rënda ekonomike, bart në gjirin e vet edhe dhembje të madhe. Gjatë luftës, kjo familje pati një anëtar të vrarë, dy të zhdukur dhe një dëshmor kombi.

Në pritje të ditë

Më duket sikur jetoj në një tunel të errët, errësira e të cilit çdo ditë po më mbyt ngadalë

Kryefamiljari Muhamet Qallakaj, ditën që u vizitua nga revista "Paqja" u shpreh se është hera e parë që dikush ka trokitur në derën e tij për ta vizituar dhe, krahas nderit që ndien, është edhe mjaft krenar.

Ndërkohë që, me bujarinë dhe mikpritjen që e karakterizon popullin tonë, na e hapi derën e shtëpisë, mendohej që sadopak të buzëqeshte, por sytë e tij tanimë tregonin për vuajtjet dhe dhimbjen që mbanin.


Pas një bisede të zakonshme, Muhameti e hapi temën për të cilën kishim shkuar ta vizitonim dhe ngurronim t'ia fillonim, duke ndier dhembje të gjurmë në ato plagë të pambyllura.

Më duket sikur jetoj në një tunel të errët, errësira e të cilit çdo ditë po më mbyt ngadalë, - tha ai. Nuk ka shpëtuar nga djegia asnjë fotografi ku do të mund të shihni nënën dhe dy motrat e mija, - shtoi më tej dhe, duke marrë frymë thellë, filloi të rrëfente për ato ditë të errëta. "Kur më 13 gusht 1998 filloi ofensiva serbe dhe na i dogji shtëpitë, nëna me dy motrat u largua nga fshati. Qëndruan disa ditë në Lug të Baranit, pastaj shkuan në fshatin Lumbar dhë, ku kanë qëndruar rreth dy javë.



Përderisa askund nuk gjendej strehim i sigurt dhe forcat paramilitare serbe hynin në çdo fshat, ato nuk pushuan se lëvizuri. Qëndruan edhe disa ditë në fshatin Skivjan, mirëpo as aty nuk mundën të zënë vend. Pasi që ato ditë në fshatin Osek nuk kishin hyrë forcat serbe, nëna me dy motrat vendosen të shkonin për të qëndruar disa ditë, mirëpo rrugës hasin në një postbllok policësh dhe ushtarësh serbë. Serbët i kanë ndaluar aty dhe prej atij momenti nuk janë parë më dhe, sipas fjalëve që kemi dëgjuar nga fshatarët të cilët i kanë shpëtuar atentatit, supozojmë se aty edhe i kanë vrarë”...

Pesë vite familja Qallakaj jeton në



ëve të bardha...



pritje dhe vetëm në vitin 2005 në mesin e 30 viktimave të sjella nga Serbia në Rahovec arritën që nëpërmjet ADN-së t'i identifikonin eshtrat e nënës së tyre, por jo edhe të dy motrave.

Nëna e Muhametit, Fane Qollakaj, ishte 43 vjeçare, motra e madhe Shqipe Qollakaj 24 vjeçare, kurse motra e vogël Xufe Qollakaj, e cila atë kohë ishte nxënëse, kishte vetëm 17 vjet.

Duke kujtuar atë kohë të tmerrshme, ankthi i së cilës i përcjell çdo çast, fytyra e tij lahej në djersë. Shikimi i tij ka vite që hidhet nga dera e oborrit, duke shpresuar në çdo çast për ndonjë lajm.

Ai shprehet se kur i kanë gjetur eshtrat e nënës së tyre dhe i kanë varrosur janë ndier të qetë. "Po çfarë të them, është ndjenjë tjetër kur e di ku e ka varrin e tjetër kur nuk e di ku prehen eshtrat e tyre. Më ndodh që të zgjohem në mes natës duke menduar për to dhe mendime nga më të ndryshme ma rëndojnë kokën. Do të ndiheshim shumë më të qetë sikur të gjenim edhe eshtrat e tyre, e atëherë do ta mbanim me vete vetëm dhimbjen".

Krenar për vëllain dëshmor

Familja Qollakaj, përveç nënës së vrarë dhe dy motrave të zhdukura, ka të rënë edhe një dëshmor kombi, Kujtimin, i cili në moshë mjaft të re u radhit në radhët e ushtrisë së lavdishme çlirimtare. Duke folur për të vëllain, Muhameti kujton: "Kujtimi ju bashkua UÇK-së me shumë vullnet. Gjithmonë thoshte se edhe jetën do ta jap vetëm që populli ynë të jetë i lirë". Ai më tej shton se ndihet krenar për Kujtimin pasi që ai u vra në shërbim të popullit. Derisa ai na rrëfente se si Kujtimi kishte ëndërruar gjithmonë që do ta largonim nga Kosova edhe ushtarin e fundit të Serbisë, ne që e dëgjonim më vëmendje të madhe, ndiheshim të turpëruar. Ç'kemi

bërë ne si popull për këta njerëz e për shumë familje të tilla? Kemi harruar se dikush dha jetën për ne. Vallë aq shpejt kemi harruar dhe nuk kujtohemi për ta, që nuk gëzojnë as një të drejtë dhe as një ndihmë?

Duke folur për zhvillimet aktuale në Kosovë, Muhameti shprehet i zhgënjyer me atë se çka po ndodh dhe se si po rrjedhin punët. "Askujt nuk i bie ndërmend për ne dhe as që e kanë parasysh që jemi familje dëshmori. Para disa kohe u hap një konkurs për punëtor ndihmës në shkollën e fshatit, por as që më morën parasysh për të më punësuar, edhe pse i dinin kushtet e rënda në të cilat jetojmë".

Muhamet Qollakaj, së bashku me bashkëshorten dhe 8 fëmijët, 7 vajza dhe 1 djalë, jetojnë në kushte të rënda ekonomike. Përderisa jeta në Kosovë për dikë është më luksoze se ajo amerikane, kryefamiljarin Qollakaj çdo mbrëmje e brengos dita që shkoi dhe e cila nuk solli as një lajm se ku i treten eshtrat e motrave të zhdukura gjatë luftës. Po ashtu, atë e mbyti ankthi se ç' të reja do të sjellë edhe një agim i ri: a do të ketë mjaft ushqim sa të ngopen te tetë fëmijët?

U larguam nga fshati Baballoq dhe nga familja Qollakaj me shpresën se një ditë edhe eshtrat e Shqipes dhe Xufës do të prehen pranë atyre të nënës Fanë, e po ashtu me shpresën se gjaku i Kujtimit nuk do të shkelet dhe se institucionet tona do të përkujdesen për të gjallët e kësaj familje. ■



Moda e zhveshjes së mit



Besim R. CENGU

Reth viteve nëntëdhjetë, më pat rënë në dorë një vëllim me tregime i shkrimtarit ultra nacionalist serb, Ivo Andriç, i cili kish fituar edhe çmimin Nobel. Meqë libra të tillë ishin të rrallë në atë kohë, edhe leximi nuk ishte lexim, por përpirje e tekstit ngaqë kërkonim të dinim sa më shumë, të shikonim gjykimet e të tjerëve veçanërisht për ne shqiptarët, të vërenim teknikën artistike, këndshikimet ndryshe, idetë që autorët publikonin përmes veprës, etj.

Ndërmjet të tjerave, lexova një tregim, në qendër të të cilit ishte vendosur një figurë shumë e dashur jona, një mit yni që respektohet, komentohet, mësohet e merret si shembull, shkurt një figurë me të cilën krenohemi: Gjergj Elez Alia.

Të them të drejtën mu plagos mendja! Ku e kishte gjetur ky shkrimtar nacionalist serb të tallej me këtë figurë të

dashur legjendare të shqiptarëve!? Pse, pse pikërisht Gjergj Elez Alinë, mu atë që me nëntë plagë në trup marrë në luftë kundër bajlozit lëngonte nëntë vjet në shtrat?! Nëntë plagët ia lante motra e vet me lotët e syve dhe ujët e krojeve. Dhe kështu, në këtë gjendje kur ishte fjala për ruajtjen e vendit nga pushtimi dhe e nderit që kërcënohej seriozisht mori forca, u ngrit dhe e shtriu përdhe bajlozin. Pas këtij akti, zuri përsëri shtratin, la amanetet e fundit, atdheun, tokën dhe motrën dhe iku nga kjo botë mbuluar me nder e lavdi.

Nëntë plagët e mitit tonë janë nëntë plagë të sotme të shqiptarëve

Studiuesi suedez Ullmar Qvick, një prej njohësve të historisë, kulturës e traditës shqiptare, në një analizë që i bën këngës së Gjergj Elez Alisë, krahas vlerësimit të madh të kësaj kënge monumentale legjendare të popullit tonë, thotë: “Kjo këngë për fisnikërinë e shpirtit shqiptar ka një mesazh për rininë e sotme shqiptare: Krenohuni! Ju keni pasuri që as koha nuk do ta prekë! Dhe në të njëjtën kohë kjo këngë është një kushttrim. Jo për luftë, por për rilindjen e

shumëvonuar shqiptare me mjete paqësore. Nëntë plagët mbi trupin e Gjergjit janë trashëguar brez pas brezi. Sot këto plagë mund të quhen: varfëria, papunësia, korrupsioni, hakmarrja, shfrytëzimi i femrave, mosbesimi, demoralizimi, mërgimi dhe prapambetja shoqërore. Nëntë plagë mbi trupin shqiptar sot”. Përnjëmend, duke qenë përfaqësuesit tipikë të mentalitetit dhe të historisë tonë, mitet dhe epokat e tyre mbartin me vete, por edhe transmetojnë shqetësimet e brengat që përjeton populli të cilit i përkasim. Prandaj mitet janë jo vetëm frymëzuesit e përhershëm, por edhe përcjellësit autentikë të gjithçkaje që jetohej e përjetohej tek një popull edhe qindra apo mijëra vjet më pas.

Duke lexuar me vëmendje ato pak faqe të tregimit të Ivo Andriçit, duke përpirë çdo fjalë, çdo rresht, çdo paragraf... deri në përfundim, ndjeva tronditjen shpirtërore që nuk e kisha përjetuar kurrë në jetën time. Ivo Andriç kishte ditur se ç’të trajtonte, kishte ditur ku të godiste, ku të prekte pikërisht aty ku dhemb më shumë. Me një fjalë kishte ditur me mjeshtërinë e tij të futet në psikologjinë e atyre për të cilët shkruante dhe të ndikonte shumë me fjalën e tij, me idenë e tij, me strategjinë e tij. Andriç, i pajisur me aftësi e talent artistik, kishte studiuar mjaft gjerë e thellë mitin tonë, krenarinë tonë, sintezën e kulturës tonë kombëtare... Ashtu siç kishte ditur të hartojë edhe një elaborat për shfarosjen e shqiptarëve, aty nga filmi i shekullit të njëzetë, njëlloj si Vasa Çubriloviçi, në mos më keq.

Kush ka pasur rastin ta lexojë atë tregim (më duket se titulli i tij që “Gjergj Elez Alia në han”), shikon menjëherë se me çfarë urrejtje të madhe autori denigron figurën tonë legjendare, e shpërfytyron atë, e deformon në atë masë sa që kur përfundon ato pak faqe thua me vete se sa me plan e synim është shkruar.

Denigrimi që i kishte bërë ky autor Gjergj Elez Alisë kishte qëllimin e poshtërimit të figurës legjendare e mitike dhe përmes këtij akti të poshtërojë popullin shqiptar, të forcojë edhe me shumë në psikozën veçmas evropiane, se shqiptarët jo vetëm se janë një popull



Vepe dhe realiteti i sotëm

i pakulturë, pa aftësinë e shtetbërjes, por edhe i padenjë për të pasur vendin që i ka falur Zoti që nga krijimi i kësaj bote. Gjergj Elez Alia paraqitet si një njeri i pagdhundur, i trashë, i paditur, injorant, pa asnjë princip e qëllim, njëlloj siç ka trumbetuar e trumbeton edhe sot makina akademike dhe politike serbe për ne.

Aludimi është i qartë: duke denigruar e shpërfytyruar figurën tonë mitike, Gjergj Elez Alinë, shkrimtari serb synon të denigrojë popullin shqiptar, ta paraqesë atë pa kulturë, pa histori, pa traditë, pa origjinë, pa moral, pa vetëdije, të paorganizuar, të paaftë për të ndërtuar shtëpinë e vet, të padenjë për të bashkëjetuar me fqinjët... Mjafton kjo që të mos thuhet më tej asnjë fjalë!



Pse t'i çmitizojmë heronjtë?!

Sot po hidhet ideja e çmitizimit të figurave tona. Pse!? Kujt po i prishin punë të jenë në këtë pozicion që janë?!

Së pari, te disa mendje studiuesish shëtit një koncept pa asnjë përmbajtje se një popull që jeton ende me mite është popull i paqytetëruar. Në fakt është e kundërta. Popuj të qytetëruar, shumë më shumë se ne, mbajnë gjallë mitet e tyre, i kthejnë ato në legjendë, edhe sikur të mos e meritojnë, frymëzohen prej tyre, ndikohen prej bëmave të tyre të kryera në kohën kur jetuan e vepruan, u thurin atyre lavde dhe krijojnë vepra për to, për t'i kthyer në legjenda.

Së dyti, orvatje të kësaj natyre tentohen të bëhen nga politikanë me mendje diabolike, pikërisht për shkak se kërkohet që të krijohen mite të tjera duke vënë në të shumtën e rasteve veten e tyre në qendër dhe njëkohësisht duke punuar për të sfumuar mitet e ngritura me të drejtë. Ne shqiptarët e kemi përvojën më mirë se çdokund tjetër. Madje edhe sot kemi përpjekje të kësaj natyre. Ka disa përpjekje që ndonjë politikan yni të lejojë që ta quajnë Skënderbe. Merreni me mend! Sa herë janë krahasuar me Skënderbeun

kemi pasur një heshtje që flet, që përkethehet qartë se ky krahasim i pëlqen. Kësaj i thonë të matësh veten me hijen e mëngjesit. Realisht, kjo dukuri e matjes apo konkurrencës me mitin e vërtetë, sot, është rrezik serioz i kohës tonë.

Po le të mbetemi në temën e shkrimit. Konkretisht, sot, është në rend të

ruajtur identitetin, për të formuar edhe psikologjinë kombëtare, të cilat i vlejten përparimit e formimit të vetëdijes tonë kolektive kombëtare. Naimi, De Rada, Gavril Dara e ngritën në qiell, jo vetëm se epoka e lavdishme e heroit tonë kombëtar e meritonte, por edhe se kështu e kërkonte koha kur ata jetuan e vepruan.

Rilindësit ishin mësuesit moralë të popullit tonë dhe nuk kishin se si të mos i ngrinin në pedestalin e merituar figurat tona, që përbënin e përbëjnë krenarinë tonë.

Shekulli i 18-19-të ishte shekulli i formimit të kombeve dhe çdo popull në formësim kombëtar thirri në skenën e historisë mitin e vet. Ne si popull i lashtë kishim tonët, Pirron, Aleksandrin e Madh, Gentin, Teutën..., Skënder-

parë tentativa e çmitizimit të Skënderbeut. Pse!? Një pyetje e thjeshtë del para të gjithëve dhe vetëm një: pse të çmitizohet figura jonë qendrore kombëtare?! Kujt i shërben çmitizimi, apo kujt i prish punë të mbetet në poltronin e mitit ku është!? Ç'i ka bërë, kujt i ka prishur punë e kujt i ka zënë rrugën Skënderbeu, që të veprohet kështu? Shumë pyetje dalin e shumë probleme mbijnë.

Mitet janë pasuri e madhe e një kombi

Mitet kombëtare, duke qenë pronë e të gjithëve, nëpër historinë tonë të ashpër e të përgjaktë kanë shërbyer për të përballuar situatat e vështira në rrugën tonë të mbijetesës. Për shkak të nevojës së domosdoshme mitet janë thirrur në skenë për të ndikuar në formësimin e psikologjisë kolektive kombëtare, për të frymëzuar brezin të cilit historia i ka vënë detyrën e ruajtjes së identitetit e përparimit. Skënderbeu kur e ka lypur nevoja jonë historike është ngritur në qiell me plot të drejtë e është bërë mburojë e padiskutueshme.

Kohën kur jetoi e luftoi miti e krenaria jonë, rilindësit tanë e quajtën "moti i madh". Në përputhje edhe me konceptet e kohës, Skënderbeu frymëzoi dhe ndikoi në mënyrë vendimtare për të

beun, më të afërtin në kohë dhe më të madhin në bëma. Më shumë se katërqind vjet pas epokës së tij, na u desh më shumë se kurrë.

Më vonë, në shekullin e njëzetë, Fan Noli, Sabri Godo, Ismail Kadare e bënë njerëzor, të prekshëm, njeri të zakonshëm... ashtu siç ishte realisht, por edhe siç e kërkoi koha në të cilën jetuan këta autorë. Por në asnjë rast, as dje dhe as sot, Skënderbeu nuk ka zbritur prej mitit me të vetmen arsye, se një vendi i duhen mitet, i duhen si mjet, i duhen për të dëshmuar më shumë dinjitet, për të treguar lashtësinë, qenien, autoktoninë, kulturën, originalitetin. I duhen se edhe të vdekur ata janë shëmbëlltë të së mirës, e të drejtës, e cilësive morale, trashëgimisë gjenetike. Ata janë përfaqësuesit sintetikë të përvojës më të mirë, të intelektualitetit, dijes dhe përvojës për të kapërcyer vështirësitë që historia nxjerr përpara.

Mesazh i studiuesit Ullmar Qvick ka një domethënie të madhe për sot. Ai vjen prej një vendi të civilizuar siç është Suedia, por askund nuk shikohet ideja apo përpjekja e çmitizimit. Pse të çmitizohen figurat tona dhe pse duhet bërë ky akt? Ç'dobi kemi ne si popull? Pse të çmitizohen Akili, Çezari, apo Vilhem Teli, Roza Luksemburgu, Garibaldi apo Benjamin Pissi...? ■

Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

Viti i ri nis me njohje

Demir RESHITI

Gjatë muajit të parë të vitit 2009, numrit të vendeve që e kanë njohur shtetin e pavarur të Kosovës iu bashkua edhe Panamaja. Ky vend i Amerikës Qendrore bëhet shteti i 54-të anëtar i OKB-së që e njih Republikën e Kosovës. Lufta në Gaza, ndryshimet në kreun e SHBA-së dhe kriza ekonomike globale duket se e kanë hequr Kosovën nga agjenda e institucioneve ndërkombëtare në muajin e parë të vitit 2009. Gjatë kësaj periudhe vlen të theksohet se Turqia dhe Kosova kanë nënshkruar një dokument strategjik për bashkëpunim dhe një marrëveshje për heqjen e ndërsjellë të vizave mes dy vendeve.

Ndërkohë Raporti më i ri i Freedom House për të drejtat politike dhe për liritë civile nëpër botë, me titull "Freedom in the World 2009", ka konstatuar se në Kosovë liria ka pësuar sprapsje për të tretin vit radhazi në vitin 2008, duke u klasifikuar ndër vendet jo të lira.

Në vazhdim po paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit janar 2009.

(1 janar) Fugger: Mund të reduktohet numri i paqeruajtësve të KFOR-it

Berlin - Komandanti i kontingjentit gjerman, gjenerali Harald Fugger, ka deklaruar se "reduktimi i numrit të paqeruajtësve të KFOR-it është çështje që mund të konceptohet, sepse gjendja në Kosovë tash sa muaj është e qetë". "Serbët në veri të Kosovës po i testojnë kosovarët se sa janë të zotuar ata për pavarësinë dhe si do të reagonin trupat tona. Por, këto janë provokime të vogla që nuk rrezikojnë seriozisht paqen", ka thënë gjenerali Fugger për agjencinë DPA.

(4 janar) Zogaj: Zhvillimet e fundit në Mitrovicë kërkojnë hetim ndërkombëtar



Preç Zogaj

Tiranë - Kryetari i Komisionit për politikë të jashtme në Kuvendin e Shqipërisë, Preç Zogaj, ka deklaruar se pas zhvillimeve të fundit në Mitrovicë është i domosdoshëm një hetim ndërkombëtar. Zogaj ka thënë se "është e domosdoshme që pas zhvillimeve të fundit në Mitrovicë të organizohet hetim ndërkombëtar sepse këto zhvillime kanë për qëllim të vënë në pyetje pavarësinë e Kosovës".

(8 janar) Pack: Ndarjen e Kosovës e dëshiron vetëm Beogradi



Doris Pack

Berlin - "Çdo incident në Kosovë, shihet me sy të mirë në Beograd, pasi kryeqendra serbe dëshiron t'i përdorë këto incidente si një dëshmi se pavarësia e deklaruar nuk po funksionon", ka thënë për mediat gjermane eurodeputetja Doris Pack.

(10 janar) Rei: Zvicra do të jetë përkrah zhvillimit të Kosovës

Bernë - Ministria e Jashtme e Zvicrës, Michelin Calmy Rei, ka përsëritur qëndrimin tashmë të njohur të shtetit

zvicran se, edhe në të ardhmen, Zvicra do të jetë përkrah zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe konsolidimit të institucioneve shtetërore të saj. Këto komente, Calmy Rei i ka bërë gjatë takimit me të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bernë, Naim Malaj.

(12 janar) Knaus: Pa zgjidhjen e çështjes së Kosovës, Serbia vështirë mund të hyjë në BE



Gerald Knaus

Bruksel - Presidenti i Iniciativës Evropiane për Stabilitet, Gerald Knaus ka deklaruar se, pa e zgjidhur çështjen e Kosovës, Serbia vështirë se mund të hyjë në BE. "Ne të gjithë e dimë pozicionin e Beogradit për Kosovën, mirëpo njëkohësisht Serbia duhet të ndihmojë Bashkimin Evropian në zhvillimin e Kosovës dhe të dërgojë sinjal të qartë se dëshiron që BE-ja të korrë sukses në Kosovë, pa marrë parasysh çështjen e statusit", ka thënë Knaus.

(13 janar) Freedom House: Kosova vend jo i lirë

Uashington - Në Raportin e ri vjetor të Freedom House për të drejtat politike dhe liritë civile nëpër botë, Kosova klasifikohet si vend jo i lirë. Raporti i ri i Freedom House për të drejtat politike dhe për liritë civile nëpër botë me titull "Freedom in the World 2009", analizon gjendjen e 193 vendeve dhe 16 territoreve strategjike. Në raportin, për të drejtat politike dhe liritë civile nëpër botë, thuhet se në Kosovë liria ka pë-


e të reja

suar sprapsje për të tretin vit radhazi në vitin 2008, duke u klasifikuar ndër vendet jo të lira.

(14 janar) Kosova dhe Turqia nënshkruan marrëveshjen për heqjen e vizave

Prishtinë - Ministri i Jashtëm i Kosovës, Skënder Hyseni dhe homologu i tij turk, Ali Babaxhan kanë nënshkruar një dokument strategjik për bashkëpunim dhe një marrëveshje për heqjen e ndërsjellë të vizave mes dy vendeve, duke e ngritur nivelin e marrëdhënieve dypalëshe Kosovë -Turqi.

(16 janar) Panamaja njeh pavarësinë e Kosovës



Panamaja

Panama City - Republika e Panamasë e ka njohur Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Ky vend i Amerikës Qendrore, bëhet shteti i 54-të anëtar i OKB-së që e njeh Republikën e Kosovës.

Uashington - Nënpresident i Institutit Amerikan të Paqes, Daniel Serwer, ka thënë se Brukseli duhet të shprehë më qartë që Serbia nuk mund të hyjë në BE nëse, në një farë forme, nuk e pranon sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës. "Serbia patjetër duhet ta njohë pavarësinë e Kosovës, sepse në të kundërtën, vendet anëtare të Bashkimit Evropian do ta bllokojnë anëtarësimin e saj në BE", ka thënë Serwer.

(19 janar) Scheffer: NATO e gatshme për shqyrtimin e zonës ajrore të sigurisë rreth Kosovës

Bruksel - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jap de Hop Scheffer, ka deklaruar se NATO është e gatshme të shqyrtojë çështjen e heqjes së zonës së sigurisë përreth territorit të Kosovës, nëse ky do të jetë një propozim i Serbisë - njoftojnë mediat serbe. "Sa i përket zonës ajrore të sigurisë rreth Kosovës, jam i gatshëm të shqyrtoj propozimin eventual nga ana e Serbisë", ka deklaruar Scheffer.


(22 janar) Bosnja njeh vetëm pasaportat e UNMIK-ut

Sarajevë - Në Bosnjë e Hercegovinë mund të hyjnë vetëm banorët e Kosovës, që kanë pasaportat të UNMIK-ut, ka thënë ministri i Jashtëm i këtij vendi, Sven Alkalaj. Ai ka thënë se Ministria nuk ka informata sa qytetarë të Kosovës nuk kanë mundur të hyjnë në BeH "vetëm sepse kanë pasur pasaportën e re kosovare, të cilën autoritetet nuk e pranojnë".

(23 janar) Tadiq shkruan kundër FSK-së

Beograd - Kryetari serb Boris Tadiq i është drejtuar përmes një letre Sekretarit të Përgjithshëm të OKB Ban Ki Moon dhe atij të NATO-s, Jap de Hop Scheffer, në të cilën thuhet se Serbia e konsideron si "ilegale" Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke e quajtur edhe "kërcënim për siguri".

(27 janar) Steinmeier: Do të punojmë me të gjitha forcat që EULEX të arrijë sukses



Valter Steinmeier

Berlin - Shefi i diplomacisë gjermane, Frank Valter Steinmeier

ka deklaruar se Gjermania do të mbështesë edhe më tej vendet e Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt së ardhmes dhe Evropës. "Bashkimi Evropian po dërgon në Kosovë gjykatës, prokurorë, ekspertë të administratës dhe policë, të cilët janë të nevojshëm për institucionet e reja të Kosovës", ka thënë Steinmeier.

(28 janar) Arabia Saudite shumë shpejt do ta njohë Kosovën e pavarur

Riad - Gjatë vizitës së tij në Mbretërinë e Arabisë Saudite, Myftiu i Kosovë Mr. Naim Tërnavë, është prituri nga kryetari i Parlamentit të Arabisë Saudite dr. Salih Al-Humejd, të cilin e ka njohur me të arriturat e Kosovës dhe ka kërkuar nga ai që Mbretëria Saudite të marrë sa më parë vendimin për njohjen e Pavarësisë së Kosovës. Ndërsa, kryeparlamentari saudit i ka premtuar Myftiut Tërnavë se njohja e pavarësisë së Kosovës, nga Mbretëria e Arabisë Saudite, do të vijë shumë shpejt.

(29 janar) Turk: BE sivjet t'i kushtojë kujdes Kosovës



Danilo Turk

Lubjanë - Presidenti i Sllovenisë, Danilo Turk, ka deklaruar se Bashkimi Evropian sivjet duhet t'i kushtojë kujdes të veçantë Kosovës. "Shteteve të rajonit duhet t'u sigurohet perspektivë e qartë evropiane", ka thënë presidenti Turk, për të shtuar se zgjerimi i mëtejshëm i BE-së është i nevojshëm, sepse është faktor kyç për stabilitetin, paqen dhe progresin në Evropë. Turk këto komente i ka bërë në një takim me diplomatët e akredituar në Slloveni. ■

Histori Islame (26)

Drejt konsolidimit të qeve

Ky këshill përzgjedhi emrat e përfaqësuesve të vendit dhe prej tyre caktuan dhjetë prefektë. Prefektët, fillimisht, u zgjedhën në këtë formë derisa të stabilizohej vendi (ky sistem u përdor në Kosovë, në vitin 1999 dhe në Irak në vitin 2003). Më pas u zhvilluan zgjedhjet lokale e pastaj parlamentare. Përfaqësuesit ishin të njohur brenda elitës së muslimanëve dhe ishin më të mirët për t'u dërguar në këto prefektura



Muhamed J. KAJOLLI

Deri tani shpjeguar momentet dhe sprovat me cilat u ballafaquan muslimanët pas vdekjes së Muhammedit s.a.v.s. Ai ju kishte lënë pas vetes disa mënyra zgjedhjesh për konstituimin e qeverisë së re. Këto forma ose mundësi të zgjedhjeve nuk ishin parë e as nuk ishin dëgjuar ndonjë herë në historinë e njerëzimit. Për këtë arsye, ato nuk do të kalonin pa pasoja dhe viktima të reja. Gjithashtu shpjeguar se si Ebu Bekri erdhi në krye të shtetit, dhe le të mos harrojmë se këtu kishim të bënim me një gjeneratë e cila sapo kishte dalë nga injoranca e thellë. Për t'i drejtuar dhe administruar fiset beduine nuk ishte e lehtë. Ne nuk arrijmë ta imagjinojmë saktë atë kohë, por për t'i kuptuar rrjedhat e asaj kohe, fatkeqësisht, nëpër mendje më sillen imazhet që po na japin fiset afgane në ditët e sotme. Nuk dyshoj se në mesin e elitës afganëve ka burra shumë të përparuar dhe me kulturë të lartë, por, njëkohësisht, vërejmë se shoqëria afgane në përgjithësi është shumë mbrapa realitetit të zhvillimeve globale.

Rebelimi i fiseve arabe në Gadishullin Arabik

Në shkrimet e kaluara treguan për mënyrën e jetës dhe veprën e Muhammedit s.a.v.s. Në to treguam rezultatet e njëpasnjëshme të tij, duke filluar nga më të vështirat, në periudhën e Mekkës dhe rezultatet e periudhës së Medinës, e deri tek plotësimi i misionit të tij i cili u kurorëzua me përfundimin e Kur'anit të madhëruar. Në momentin kur u përmbyll Kur'ani, Muhammedi s.a.v.s. paralizoi vdekjen e tij, gjë për të cilën shumë prej atyre që e njihnin u pajtuan. Por në

mesin e tyre kishte edhe me qindra mijëra të tjerë, të cilët vetëm kishin dëgjuar për të, por nuk kishin arritur ta shihnin dhe të mësonin prej tij në mënyrë të drejt-përdrejtë. Ata kishin besuar se ai ishte i dërguar i All-llahu i Lartëmadhëruar, por, në fakt, Islami tyre ishte i brishtë.

Islami në botë ishte, është dhe do të mbetet si model i veçantë (sui generis). Mesazhet për unitetin e popujve të planetit Tokë, në atë kohë, ishin shumë pak të dukshme. Shoqëria beduine nuk kishte bazamentin kulturor e arsimor për absorbimin e këtyre mesazheve, sepse ajo sapo kishte pranuar Islamit dhe nuk ishte në gjendje ta konceptonte tërësinë e saj. Prandaj, me të dëgjuar se Muhammedi s.a.v.s., vdiq ndodhën trazira dhe rebelime. Shumë prej fiseve, si ato të afërtat, ashtu edhe ato të largëtat, u ngritën në kryengritje. Duke shfrytëzuar këtë rast, disa prej tyre u shkëputën nga Medina.

Paraqitja e 'profetëve'

Meqenëse fiset arabe i kishin besuar pejgamberit të Zotit, disa përfitues të situatave nuhatën pasuri të majme dhe përhapën propagandat e tyre se edhe atyre iu ishte shpallur shpallje nga Zoti. Këta për argument kishin mosvdekjen e të zgjedhurve të Zotit, ndërsa Muhammedi, sipas tyre, kishte qenë "gënjeshtar".

Kështu në juglindje të Gadishullit, gjegjësisht në Omanin e sotëm, u paraqit si profet Lekij bin Malik el Ezed. Kështu ndodhi edhe në krahun tjetër të Gadishullit, pra në jugperëndim, ose në Jemenin e sotëm, ku u paraqitet si profet Esved el A'nesi. Ky i përkiste fisit Kahtani. Ndërsa në Arabinë qendrore, fisi Beni Temim ishte një tjetër qendër që njohu si profet njëri nga përfaqësuesit e fisit Temim, të quajtur Sexhah bint el Harith, e cila ishte e krishtere. Nga po kjo zonë ishte bërë shumë i njohur ndër arabë edhe Tulejha el Esedij-i, i njohur me nofkën Musejlem el Kedhab (Musejlem gënjeshitari). Ky së bashku

me Sexhah-en kishin bërë një aleancë dhe në mesin e tyre kishin rreth dyzet mijë luftëtarë. Ky numër i të rebeluarve ishte shumë i madh për kohën.

Të pakënaqurit

Në mesin e shoqërisë arabe kishte besimtarëve që akoma nuk i kishin mësuar mirë rregullat dhe ligjet e fesë, prandaj edhe u paraqitën shtresa të ndryshme njerëzish të pakënaqur me sistemin. Në tërë Gadishullin ishin paraqitur edhe shumë grupe të tjera, të cilat nuk janë identifikuar në histori, por ato u njohën në saje të fetfave që ishin dhënë për këto grupe. Ebu Bekri me shokët e tij të elitës muslimane arritën t'i nxjerrin disa fetfa të cilat mbetën të qëndrueshme edhe në ditët tona të sotme. Besimtarët kishin menduar se zekati duhej të jepej vetëm sa ishte gjallë Muhammedi s.a.v.s., por Ebu Bekri tha se obligimi i zekatit nuk ndahet nga namazi. Muhammedi vdiq, por ai ishte zëvendësi tij... Shumë besimtarë nuk e kuptonin konceptin e lutjeve, prandaj paraqitja e tyre indiferente dhe neglizhenca ndaj namazeve dhe obligimeve të tjera ishte e vështirë të argumentohej pa ligje ndëshkuese. Disa të tjerë nuk pranonin ta jepnin zekatin, të tjerët nuk dal-



risë së parë islame në botë

Kalifi i ri do të ballafaqohet me të gjithë këto sprova dhe atij i duhej medoemos ta stabilizonte shtetin.

Stabilizimi i situatës

Jemi dëshmitarë të faktit se situata e vështirë në Afganistan, tash e shtatë vjet, nuk është stabilizuar ende, me gjithë mundësitë dhe potencialet e mëdha që ka superfuqia e botës. Nëse këtë potencial e krahasojmë me atë të Kalifit të parë, vërejmë se ato nuk mund të krahasohen. Por Ebu Bekri arriti që tërë Gadishullin ta stabilizojë brenda gjashtë-shtatë muajsh.

Më herët kishim theksuar se Muhammedi s.a.v.s., pak para se të ndërronte jetë, kishte urdhëruar të mobilizohet një ushtri në krye të së cilës do të ishte djaloshi gjashtëmbëdhjetë vjeçar, Usame bin Zejd, i cili do të drejtohej drejt veriut të Gadishullit, në shenjë hakmarrje ndaj vrasjes së tre shokëve të ngushtë të Muhammedit s.a.v.s. në ballafaqim me ushtrinë bizantine. Në këtë ushtri ishte paraparë të Omerit, Bekri, por Muhammedi

s.a.v.s. u sëmur, ai kërkoi nga Ebu Bekri të ndalej për ta zëvendësuar atë në namaz. Sapo ushtria kishte dalë nga Medina, Muhammedi s.a.v.s. kishte ndërruar jetë dhe, kështu, për pak ditë ushtria e ndaloi marshimin e saj. Kur Ebu Bekri u zgjodh për kalif, Omeri r.a. e këshilloi atë të urdhëronte që ushtria e Usames të ndalonte dhe të qëndronte në Medinë, sepse do të shërbente për të stabilizuar situatën e krijuar pas vdekjes së Muhammedit s.a.v.s. Të këtij mendimi ishin edhe shumica e elitës së besimtarëve.

Ebu Bekri e kishte vështirë të vendoste përballë argumenteve që i paraqitën, por atij i doli nga goja thënia: "Nuk mund të urdhëroj për ndalimin e ushtrisë të cilën e ka urdhëruar Pejgamberi All-llahu të Lartëmadhëruar. Bile, tani edhe unë do të jem ushtar i Usames. Shokët e tij e kuptuan ndjenjën e tij dhe seriozitetin e vendimit dhe i thanë: Do të bëhet ashtu siç thua!

Por ata ju lutën atij që të qëndronte në Medinë, sepse popullit do t'i duhej më shumë në Medinë, se sa në ushtrinë e Usames.

Historia dëshmoi se vendimi tij ishte i saktë dhe shumë i qëndrueshëm. Ushtria perse dhe ajo bizantine do të kishin mundur t'i sulmonin tokat e muslimanëve, në këtë turbulencë të brendshme. Por kur ushtria e Usames u paraqit në veri të Gadishullit, qeveria bizantine u informua për lëvizjet e ushtrisë muslimane në veri dhe për përleshjet sporadike të cilat kishin ndodhur midis tyre.

Historianët nuk janë të një mendimi rreth qëndrimit të ekspeditës së kësaj ushtrie në veri të Gadishullit. Disa mendojnë se ajo u kthye pas dyzet ditëve, të tjerët mendojnë se u kthye pas shtatëdhjetë ditëve. Sido që të jetë, me të kthyer kjo ushtri në Medinë, luftëtarët e kësaj ushtrie u shpërndanë në brigadat të cilat kishin nevojë të madhe për luftëtarë shtesë në shuarjen e kryengritjeve të fiseve rebele.

Shuarja e kryengritjeve

Koha nuk priste. Edhe pse Ebu Bekri e kishte urdhëruar për marshim ushtrinë e Usames, ai do të caktonte njëmbëdhjetë komandantë të tjerë, të cilët do të shpërndaheshin në të gjithë territorin e Gadishullit për t'i shuar trazirat e rebelëve. Ndërsa për vete ndaloi një ushtri, e cila do të ndihmonte për shuarjen e fiseve rebele që ishin afër kryeqytetit – Medinës. Komandantët e zgjedhur ishin si vijon:

1. "Ebu Bekr u drejtua drejt fisit Ijs dhe Shubjab, në verilindje të Medinës.
2. Në këtë drejtim shkoi edhe Halid ibn Velidi. Rruga e tij ishte e gjatë. Ai do të shuante trazirat e fiseve rebele, si ata të fisit Tij, Esed dhe Temim, për të shkuar më vonë në ndihmë të ushtrisë së Ikrime ibn Xhehlit.
3. Ushtria e Ikrime ibn Xhehlit u drejtua drejt fiseve të krahinës në Hanife.
4. Ushtria e Sherhebil ibn Hasane shkoi drejt fisit Ethir, për t'iu bashkëngjitur fisit të Ikrimes, sepse ky e kishte më të vështirë përballjen me 'profetin' Musejleme Gënjeshtarin.
5. Ushtria e Tarife ibn Haxhiz u dërgua tek fisi Selim dhe Havazim.
6. Amër bin As, u dërgua drejt veriut të Gadishullit për në tokat e Sirisë (Shamit), tek fiset Kudaah, Uedia dhe Harith.



7. Halid bin Seid, gjithashtu drejt veriut tek fiset arabe të krishtera.

8. Ala' bina el Hadarij, ishte caktuar në lindje të Gadishullit, në Bahrejin e sotëm.

9. Hudhejfe bin Muhsin, kishte gjithashtu një rrugë shumë të gjatë në juglindje të Gadishullit, për në Duba të Omanit të sotëm.

10. Urfexhe bin Hirthime në jug të Gadishullit, në Mehre-Hadrameut.

11. Ushtria e al Muhaxhir bin Ebi Umeje në Sana (kryeqytetin e Jemenit) dhe në Hadrameut dhe,

12. Ushtria e Suvejd bin Makram, gjithashtu në jug të vendit, në Tehame të Jemenit të sotëm.

Konsolidimi i qeverisë

Para se të theksoj emrat e përfaqësuesve të shtetit nëpër krahinat ose prefekturat e Gadishullit Arabik dua të sqaroj fjalën 'emir'. Në kohën e katër kalifëve të drejtë, fjala 'emir' nuk nënkuptonte princ-in, djalin e mbretit, vëllanë ose kushëririn e tij. Të zgjedhurit – emirët (ishin prefektët), asnjë prej tyre nuk ishte nga familja e Ebu Bekrit, e as nga familja e Muhammedit s.a.v.s., por që të gjithë ishin të zgjedhur dhe më të mirët.

Në kohën kur Ebu Bekri nisi komandantët e brigadave të ushtrisë muslimane, ai me t'u kthyer vetë nga Dhubjan-i, mbloodhi shokët e tij dhe këshilltarët, sepse në këtë kohë akoma nuk kishte përcaktuar ministrat e qeverisë së tij. Ky këshill përzgjedhi emrat e përfaqësuesve të vendit dhe prej tyre caktuan dhjetë prefektë. Prefektët, fillimisht, u zgjodhën në këtë formë derisa të stabilizohej vendi (ky sistem u përdor në Kosovë, në vitin 1999 dhe në Irak në vitin 2003). Më pas u zhvilluan zgjedhjet lokale e pastaj parlamentare. Përfaqësuesit ishin të njohur brenda elitës së muslimanëve dhe ishin më të mirët për t'u dërguar në këto prefektura. Emrat e prefektëve ishin si vijon:

1. I'tab ibn Usejdin, prefektura e Mekës. Ky ishte caktuar që në kohën e Muhammedit s.a.v.s.
2. Uthman ibn Ebi Uekas, prefektura e Taifit. Po ashtu, edhe ky ishte caktuar që në kohën e Muhammedit s.a.v.s.
3. Muhaxhir ibn Ebi Umejje, prefekt i Jemenit. Ky, jo pse çliroi këtë vend, por sepse ishte më meritori për këtë post.
4. Zijad ibn Lebijdin, prefekt i Hadrameutit.
5. Ja'la ibn Umejje, prefekt i Haulanit.
6. Ebu Musa el Esharij, prefekt i prefekturës të quajtur Zebjed dhe Refah.
7. Muadh ibn Xhebel, prefekt i el-Xhundit.
8. Xherir ibn Abdullah el-Bexheliin, prefekt i Nexhranit.
9. Abdullah ibn Theurin, prefekt i Xhers-it.
10. El-A'la ibn Hadremin, prefekt i Bahrejn (Hassan Ejub, 76).

Ebu Bekri nuk arriti t'i përcaktonte ministrat e qeverisë së tij, por ai kishte të zgjedhurit e tij: përgjegjës për gjyqësinë ishte Omeri r.a., përgjegjës i thesarit të shtetit ishte Ubejde in Xherrah, përgjegjës i ekonomisë Abdurrahman bin A'uf, për arsimin Abdullah ibn Mesudi. Ndër përgjegjësit theksohen edhe Uthmani r.a. dhe Seid bin Ebi Uekasi.

I përzgjedhuri i Ebu Bekrit ishte edhe Amër bin As, por ky i fundit në një rast i thotë: "Ne jemi bijtë e Ebu Uhejha-s. Nuk i shërbejmë askujt pas vdekjes së Muhammedit s.a.v.s. Fatkeqësisht, koha do ta vërtetonte, më pas, këtë thënie të tij" (Tarih el Rikka:12). ■

Emërvënie

Një prirje çoroditëse, çorientuese dhe paradoksale në emërvënie, për çudi, po gjen mbështetje te gjen-eratat e reja duke u bërë njëfarësoj trendi...

Drin KRYEZIU

Ndonëse në dy dekadat e fundit në Kosovë ndihet një vetëdijësim i dukshëm te çiftet e reja në zgjedhjen e emrave për fëmijët e tyre, megjithatë një logjikë e çuditshme dhe çorientuese në emërvënie vazhdon edhe më tutje. Shfaqja e kulturave dhe zakoneve të ndryshme nga mbarë globi, nëpërmjet medimeve elektronike si televizionet, radiot, interneti etj., apo edhe më drejtpërdrejtë me praninë e pjesëtarëve të popujve të ndryshëm dhe të kulturave të tyre në Kosovë, patjetër se ka lënë gjurmë në kulturën tonë aq të brishtë e të plagosur nga trysnia okupuese e tendencat shekullore asimiluese. Përveç gjuhës, veshjes, muzikës dhe stileve të ndryshme, të panjohura deri më tani, në këto gjurmë është vërejtur edhe një fenomen tjetër shqetësues, degradues dhe i çuditshëm, si ai i emërvënies të të porsalindurve me emra krejt të huaj, të panjohur, asgjëdomethënës, të pazbërthueshëm, të pakapshëm për gjuhën, kulturën dhe mendësinë shqiptare.

Emërvënie sipas modeleve sllave

Shqiptarët kanë qenë shumë të kujdesshëm që, edhe pse nën okupimin serb, t'i ruanin emrat e tyre kombëtarë apo ata me traditë më të gjatë, prandaj as nuk mund të gresh emra sllavë tek shqiptarët e Kosovës. Mirëpo, pa dashje apo pa vetëdije të plotë, edhe disa emra shqip (të burimit shqip) kanë marrë disa nuanca të modelit sllav.

Psh. tek emrat si: Merit(a), Lendit(a), Afërdit(a), Han(a), Mirëdit(a), etj. ku (a)-ja fundore në këtë rast është e tepërt,



et e çuditshme

ngase në gjuhën shqipe emri shkruhet dhe lexohet në trajtën e pashquar, pra: Merit(ë), Lendit(ë), Afërdit(ë), Han(ë), Mirëdit(ë) etj. Ky shtrembërim i pancevojshëm me (a) në fund të emrit bëhet për dy arsye:

1. Për shqiptim më të lehtë, ngase (a)-ja fundore gjatë shqiptimit e bën më të lehtë nxjerrjen e ajrit nga aparati i gojës dhe shqiptimi i emrit është më i lehtë dhe më melodik, e ndërsa gjuha shqipe nuk ka theks melodik, përkundrazi ka theks dinamik (të palëvizshëm).

2. Shkaku i dytë, e që është paradoksal, i takon modelit sllav si p.sh. Dragan(a), Vesn(a), Liljan(a), Dragic(a), Milic(a), Cec(a) etj., ku (a)-ja fundore e bën emrin me theks melodik.

Vërshim emrash latino-amerikanë

Për arsye të bazave komerciale programore, shumë nga televizionet tona kanë dhënë e japin seri filmike me cilësi të dobëta artistike, por atraktive në dramatikat e tyre dashurore, të cilat, në kushte varfërie dhe mungesë të shfaqjes së vlerave kombëtare, kanë një publik të gjerë, i cili identifikohet dhe dashurohet me "heronjtë e heroinat" e atyre serialeve, prandaj edhe janë shpeshuar emra nga filma të tillë. Natyrisht se filma të tillë janë të dëmshëm në shumë aspekte. Kështu shqiptarët e Kosovës, nga ai mall i dobët filmik e kulturor, marrin emra edhe të këtitillë për fëmijët e tyre: Maria, Floresita, Anduela, Grasiela etj. Këtyre emrave askush nuk ua di kuptimin e as domethënien. Në këtë mënyrë, në trojet tona dalëngadalë po krijohen "komunitete" të reja ende johomogjene braziliane, meksikane, spanjolle, portugeze...

Emra për hatër...

Një numër jo i madh emërtime sh janë edhe ato hatëruese. Çka do të thotë

kjo? Për hatër të këtij ose atij, i është vënë emri fëmijës. P.sh. për hatër të ish-presidentit të SHBA-ve, që ndali gjenocidin serb mbi shqiptarët, Bill Klinton, disa fëmijëve në Kosovë u është vënë emri Klinton. Disa prindër të tjerë kanë zgjedhur emrin e ish-kryeministrit britanik për t'u vënë fëmijëve emrin Tonibler. Disa të tjerë, Klark etj. Dikur, ngjashëm ndodhte në Shqipëri. Atje, për hatër të miqësisë dhe respektit ndaj Stalinit, edhe vetë qyteti i Kuçovës qe mbiemërtuar Qyteti Stalin.

Emërtime kote ose boshe

Ndodh edhe kjo. Kur njëri prind ose tjetri nuk është i ndikuar nga asnjë prej



këtyre që cekëm më lart, vendosin që fëmijës së tyre t'i vënë një emër krejt kot. Bosh. Me kombinim të pak zanoreve e një a dy bashkëtingëlloreve dalin emra si: Jeni, Ina, Oli, Gisi, Risi, Gesa, etj. Këta janë emra kot së koti, emra sa për të mos e lënë fëmijën pa emër. Apo emra krejt bosh.

Më të kujdesshëm me emrat për kafshët...

Lexuesit sigurisht se do jenë kureshtarë dhe të pyesin se çka hyn këtu emërvënien e kafshëve? Këtu edhe është morali i këtij trajtimi të shkurtër. Siç e dinë të gjithë, në familjet shqiptare, posaçërisht atyre që jetojnë në zonat blegtorale, ku për nevoja ekzistenciale familjet



mbajnë bagëti e kafshë shtëpiake: lopë, dele, dhi, kuaj, qenë etj., qysh moti ka ekzistuar dhe ende vazhdon të ekzistojë prirja që emërvëniet për të vegjlit e këtyre kafshëve të jenë më të drejta e më burimore se ato për njerëzit. Si?!..

P.sh. një dele mund të ketë emrin Bardhoshe, Bardhanë, Bardhokë, për shkak se delja është e bardhë. Një lopë mund të ketë emrin Murrinë për nga ngjyra e lëkurës së murrme, ose Kuqeshë për nga ngjyra e kuqe, ose Larukë, Larikë, Laroshe, Larë sepse ajo e ka trupin me lara. Një kalë mund të quhet Balosh për shkak të balës që e ka në ballë ose diku tjetër në trup. Një dhi mund të ketë emrin Rrushe, për sytë që e ka në formën e kokrrave të rrushit... etj..

Këto dhe emërvënien të ngjashme me to janë tipike tonat dhe të burimit të mirëfilltë shqiptar. Ngase kanë kuptimin shqip, janë domethënëse dhe të kapshme edhe për fëmijët e vegjël që ende nuk dinë shkrim e lexim.

Pse atëherë kjo logjikë e mbrapshtë e emërvënieve për fëmijët me emra kaq çoroditës?! Paradoksi është këtu: Si është bërë e mundur që shqiptari për kafshën e tij të përdorë emër shqip, ndërsa në kohët tona, të marrë rreth e rrotull emra pa asnjë kriter dhe asnjë logjikë për fëmijët e tij?!

Gjuha shqipe ka një larmi të pafund emrash të burimit e brumit të saj, kështu që nuk ekziston as edhe arsyeja më e vogël për ta shmangur atë dhe për të marrë, pa asnjë nevojë, emra nga vende e popuj të tjerë të njohur a të panjohur.

Nëse je shqiptar, duhet të kesh të gjitha tiparet e të qenit shqiptar. Nuk mjafton vetëm të flasësh shqip. ■

Leximi i poezisë

Frika e prodhuar nga



Milazim KRASNIQI

Poezia "Takim" e Çeslav Milloshit, fikson një detaj krejt të vogël nga jeta, (një shëtitje me makinë me mikun, një shenjë me dorë prej tij dhe përfitim e rrugës nga një lepur!) Por, ajo ngjarje e vogël, është pasuar nga një ngjarje e madhe, vdekja e subjekteve të saj. Tash ngjarja rigjallërohet nga kujtimi i subjektit të mbetur ende gjallë, por i cili vazhdon të mbetet i çuditur me dukurinë e vdekjes. Ai nuk është i hutuar nga dhembja e mungesës së atyre të tjerëve, por nga çudia se si ndodh ajo mungesë, si ndodh vdekja.

Mesazhi i poezisë e imponon një pyetje direkte: pse njeriu i çuditur është nga vdekja? Më saktë, cili soj njeriu është i çuditur nga vdekja? Poezia e Çesllav Milloshit jo vetëm që nuk jep përgjigje ndaj këtyre pyetjeve, por, për më tepër, ajo e komplikon punën akoma më shumë. Ai pyet për të vdekurit: "ku po shkojnë?" dhe pastaj bie në letargjinë e çudisë.

Në të vërtetë, njeri i çuditur nga vdekja është vetëm ai njeri që nuk arrin të komunikojë me të vërtetën e ekzistencës së gjithësisë e të njeriut në të.

Sipas idesë së poezisë së Milloshit, koha ka ikur e bashkë me të edhe bashkudhëtari dhe lepurit janë tretur. Por, sipas shpalljes hyjnore, koha e ikur nuk e prodhon humbjen. Humbjen e njeriut e prodhojnë gjendje dhe veprime të tjera, ndërsa koha është argument i veprimit të tyre. Zoti ka shpallur qartë:

Pasha kohën!

Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt.

Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetritin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetritin të jenë të durueshëm. (Suretul Asr:1-3)

Pra, njeriu do të jetë në humbje, nëse nuk u përmbahet udhëzimeve hyjnore

dhe është i shpëtuar nëse u përmbahet atyre plotësisht. Rrjedhimisht, ai që është besimtar, që bën vepra të mira, që angazhohet për të vërtetën dhe që është i durueshëm, nuk do të jetë as i zhgënjyer e as i çuditur me asgjë. As me vdekjen.

Çeslav Milloshi, në poezinë e tij bën edhe një pyetje retorike "O, pashë Zotin, ku janë ata vallë, ku po shkojnë?", duke lënë të kuptohet se ai nuk e di trajektorën e udhëtimit të shpirtave. Por, ai pyetjen nuk ia drejton Atij që e di saktë të vërtetën. Në fakt, njeriu që e beson Zotin dhe i drejtohet Atij për përgjigje, se ku po shkojnë shpirtat e vdekur, përgjigjen mund ta marrë lehtësisht nga shpalljet hyjnore. Nëse ai e beson Zotin plotësisht, pra, ai e njeh edhe trajektorën e udhëtimit të shpirtave, sepse Zoti ka dhënë njoftime të mjaftueshme për të në librin e shenjtë, në përvojën fantastike të profetit Ibrahim:

Zoti që më krijoi, Ai më udhëzoi mua. Dhe Ai që më ushqen dhe më jep të pijë. Dhe kur të sëmurem Ai më shëron, Ai më bën të vdesë e mandej më ngjall, Ai tek i cili kam shpresë se do të m'i falë mëkatet e mia në Ditën e Gjykimit. (Esh Shuaraë: 78-85)

Pra, krahas mirësive të tjera, Zoti ia ka garantuar njeriut ringjalljen pas vdekjes. Këtë gjë e besojnë dhe nuk e vënë kurrë në dilemë besimtarët, gjë që i bën të mos jenë të çuditur, kur u vjen vdekja edhe atyre.

Sipas shpalljes hyjnore, njeriu i vdekur, edhe ai për të cilin pyet poeti në këtë poezi, shkon në botën tjetër, ku atë dhe të gjithë të tjerët i pret gjykimi për veprat që kanë bërë sa kanë qenë gjallë në këtë botë dhe pastaj statusi në botën tjetër u jepet varësisht nga gjykimi i Krijuesit. Për besimdrejtin asgjë për t'u çuditur nuk ka në këtë punë, sepse ringjallja është e paralajmëruar dhe e garantuar nga Zoti, i cili atë proces e krahason me ringjalljen e tokës nga ujitja prej shirave të reve. Ne e shohim me sytë tanë se toka pa ujë është e vdekur dhe e shohim, po ashtu, me sytë tanë se si ajo ringjallet, kur e ujit shiu nga qielli:

All-llahu është Ai që i lëshon erërat, e ato i lëkundin retë dhe Ne i derdhim ato në një vend të thatë dhe me atë ujitje e ngjallim tokën pas vdekjes së saj. Ja, kështu është ringjallja. (El Fatir:8)

Meqë ringjallja e tokës nuk na duket një proces i çuditshëm, (përkundrazi, na duket krejt i natyrshëm), nuk ka pse të na duket e çuditshme as ringjallja e njeriut në Ditën e Gjykimit, meqë edhe ai është vullnet i Krijuesit.

Përkundër gjithë këtyre argumenteve që shihen me sy dhe provohen me operacione shkencore, mbetet disi enigmë se si është e mundshme që njerëz shumë të ditur mbeten me shumë dilema lidhur me të vërtetën, edhe me të vërtetën për vdekjen dhe për ringjalljen. Por, edhe kjo enigmë e ka një shpjegim të qartë: njeriu mund të besojë vetëm me ndihmën e Allahut, por ndihma e Tij u vjen atyre që janë të përkushtuar t'i vështrojnë me vëmendje argumentet e Tij në tokë e në qiej:

"Nuk është e mundur për asnjë njeri të besojë (ndryshe), pos me ndihmën e All-llahut, E dënimin u jep atyre që nuk mendojnë. Thuaj: "Vështroni me vëmendje çka ka (nga argumentet) në qiej e në tokë. Po argumentet dhe qortimet nuk bëjnë dobi ndaj një populli që nuk beson." (Junus: 100-102)

Ata që nuk e kanë këtë përkushtim dhe prije, që u kërkohet për t'u bërë besimtarë të vërtetë, mbeten të katandisur në evidencimin e dukurive, të detajeve, të episodeve të shkëputura, të cilat më shumë u shkaktojnë ankthe se sa që u ofrojnë shpjegime të sakta. Ata mundohen të shpjegojnë atë që shohin dhe atë që përjetojnë, por përvojat e tyre gjithmonë janë shumë të varfra, për të përthekuar të fshehtat e ekzistencës.

Kjo gjë ndihet edhe në poezinë "Takim" të Çeslav Milloshit, ku ai e sfordon edhe më shumë nihilizmin e vet për vdekjen. Duke evidencuar detaje të vetmisë, që sipas tij është shoqëruese dhe emërtuese e jetës së njeriut, ai pandeh që ka megjithatë një ngushëllim: ngushëllim është fakti se askush nuk shpëton nga vdekja! Kaq e thellë është vuajtja nga ideja

mosnjohja e të vërtetës

e vdekjes në këtë poezi. Meditimi lidhur me raportin e njeriut me botën e jashtme, është po aq dramatik: poeti pyet nëse është gjithë ai shkëlqim i jetës në natyrë, dhuratë për njeriun, individin. Por, zhgënjimi vjen nga njohuria se ajo botë vazhdon të jetojë edhe pas vdekjes së tij:

Për kë gjithë ky shkëlqim, mendoj, vetëm për mua?

Prapë, kjo do të mbetet gjatë pasi të tretem. Ç'ka aty, në atë sy shtaze? Po zogjtë shtegtarë çfarë panë?

Nëse unë jam gjithë njerëzimi, a janë ata krejt pa mua?

Egoizmi i individit, i motivuar nga dëshira për ta pasur jetën dhe gjithësinë në shërbim të vetin, funksionon si i strukturuar brenda njeriut. Por, kur njeriu arrin të njohë të vërtetën e shpallur nga Zoti, ai egoizëm zbutet dhe pothuajse tretet, duke u zëvendësuar nga modestia dhe devotshmëria. Pyetja e fundit në vargjet e sipërcituara të Milloshit është tronditëse: paralelizmi i individit me tërë njerëzimin! Kaq larg shkon aventura e egoizmit të njeriut, sa ta barazojë individin me tërë njerëzimin! Pse? Sepse atij i mungon njohuria për fatet e njerëzimit në të kaluarën dhe në të ardhmen:

Nëse do Ai, juve ju zhdok dhe sjell kë të dojë pas jush, ashtu sikurse ju solli juve nga pasardhësit e atyre që ishin para jush. (En En Amë: 133)

Ose:

A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të shohin se si qe përfundimi i atyre që ishin para tyre!? Ata ishin edhe më të fortë se këta, ata e lëruan tokën dhe e rindërtuan atë më shumë se sa këta, e rindërtuan, atyre u patën ardhur të dërguarit e vet me fakte të qarta. (Rum: 9)

Është e sigurt se ai që e njeh dhe e beson këtë ligj të Krijuesit, nuk ka pse ta subjektivizojë të vërtetën dhe ta zmadhojë veten. Jeta brenda ligjeve të panegociueshme, bëhet më e lehtë kur ato besohen dhe respektohen si të tilla, e nuk vajtohet pse janë të atilla. Vajtimi pse ndodh vdekja, nuk prodhon ndryshimin e ligjeve të Zotit. Përkundrazi, ai vetëm sa e shumëzoi mërzinë dhe rrezikun e

humbjes së ekuilibrit mendor e besimor të njeriut. Poeti, në dy vargjet e fundit, shfryn një ngushëllim paradoksal:

Dhe ai e dinte që s'ia vlente të vajtoje, Pasi askush prej tyre nuk kish shpëtim.

Pra, njëfarë qetësie që fitohet, nuk është rezultat i ndërjegjësimit për ligjet e panegociueshme të Krijuesit, ku edhe vdekja është pjesë përbërëse e harmonisë së ekzistencës. Në këtë rast, ngushëllimi vjen nga konkludimi se askush nuk është përjashtim, gjë që është njëfarë keqdashjeje cinike.

Përfundimisht, mendoj se edhe nga këto dy poezi të Çesllav Milloshit, bëhet e kuptueshme që arti i mbështetur në mosnjohjen e së vërtetës hyjnore, ka një vlerë të pashmangshme jashtestetike: cinizmin. Ky cinizëm prodhon më shumë frikë se sa

njohje, më shumë stres se sa paqe te njeriu. Kjo ndodh ngase në esencë, gjërat që nuk i njohim, na shkaktojnë frikë. Nëse e njohim të vërtetën e jetës dhe të vdekjes, nëse e besojmë të vërtetën e Vullnetit Suprem, atëherë kemi më pak stres nga jeta dhe më pak frikë nga vdekja.

Në Kur'an Zoti ka njoftuar:

Atij që All-llahu ia ka zgjeruar kraharorin për besimin islam, ai është në një dritë të sigurt prej Zotit të vet. Të mjerë janë ata që nga zemërfortësia e tyre nuk përmendin All-llahun, të tillët janë në humbje të qartë. (Ez Zumer: 22)

Ata që janë në humbje të qartë, prodhojnë humbje edhe për të tjerët. Natyrisht, për ata që verbërisht i pasojnë idetë dhe veprimet e tyre. ■

Çeslav Millosh

Takim

Po shëtisnim me makinë përmes fushave me akull në agim. Një krah i kuq u ngrit në terr.

Dhe papritmas një lepur u hodh në rrugë. Njëri prej nesh tregoi me gisht.

Kjo ka shumë kohë. Sot askush prej tyre s'është gjallë. As lepuri, as njeriu që dha shenjën.

O, pash Zotin, ku janë ata vallë, ku po shkojnë Mishi i një dore, haphthi i lëvizjes, fëshfërima e zallishtes? Nuk pyes prej dhimbjes, por prej çudisë.

Studim i vetmisë

Rojtar i karvaneve të largëta në shkretëtirë?

Rob i vetëm te një fortesë në rërë?

Kushdo të kish qenë. Në agim ai pa male me qime

Ngjyrën e hirit, përmbi terrin që shkrihej,

Ujiti me ngjyra vjollce duke u përthyer nëpër lëng të kuq, Gjersa ata mbetën, thellësisht, nën dritë të portokalltë.

Ditë pas dite. E, para se t'i shkonte ndër mend, vit pas viti.

Për kë gjithë ky shkëlqim, mendoj, vetëm për mua?

Prapë, kjo do të mbetet gjatë pasi të tretem.

Ç'ka aty, në atë sy shtaze? Po zogjtë shtegtarë çfarë panë?

Nëse unë jam gjithë njerëzimi, a janë ata krejt pa mua?

Dhe ai e dinte që s'ia vlente të vajtoje,

Pasi askush prej tyre nuk kish shpëtim.

Përktheu: Ildir Azizi

Një vushtrriase, talente e botës

Shpresa Rama eseistja më e mirë në botë!

Fatlum SADIKU & Rexhep KERA**Letër babait**

Shpresa Rama është një vajzë e re nga Vushtrria, e cila ariti që në mesin e mbi 5 milion (nuk lexuat gabim: 5 milion) konkurruesve nga tërë bota ta zërë vendin e parë në shkrimin e eseve. Shpresa esenë e kishte shkruar për babanë e saj, i cili kishte vdekur kur ajo ishte vetëm trevjeçare. Gara ndërkombëtare "Eseja më e mirë" u mbajt vitin e kaluar në Emiratet e Bashkuara Arabe, ndërsa shkrimet konkurruesit i dërguan nëpërmjet postës elektronike. Titulli "Eseistja më e mirë" i takoi kosovares nga Vushtrria, Shpresa Rama.

Para fitimit të këtij çmimi në nivelin botëror, Shpresa ishte mësuar të ishte e para gati në të gjitha aktivitetet e saj, e në veçanti në mësimet si nxënëse e shkollës fillore dhe të mesme.

Talenti i saj nuk kufizohet vetëm në mësim dhe në shkrim. Ajo shquhet edhe me aftësitë për këndim, për pikturë, si moderatore e programeve dhe për pjesëmarrjen në aktivitetet humanitare. Gjatë shkollimit fillor, ajo me iniciativën e vet themeloi shoqatën bamirëse "5-shja bamirëse" dhe me ndihmat e mbledhura ndihmuan nxënësit e shkollës fillore "Mustafë Venhari", shkollë në të cilën vijoi mësimet edhe Shpresa.

Motivimi për të marrë pjesë në këtë garë asaj nuk i kishte ardhur nga ambicia për të qenë e para ose për të fituar mjete materiale, por ishte bindja e plotë se All-llahu ndihmon në çdo hap të jetës. Malli për babanë, të cilit as fytyra e as ndonjë fjalë e thënë nuk i kishin mbetur në kujtesë, ishin elemente shtytëse për të shkruar një ese me titullin "Letër babait".

Më poshtë kemi sjellë për ju tekstin e eses fituese në garën ndërkombëtare të mbajtur vitin e kaluar në Emiratet e Bashkuara Arabe.

Dita po merrte kah të kundërt. Gjersa shikoja perëndimin e diellit, tinguj të trishtuar vetmie bashkë me flladin pranveror më përkëdhelnin flokët...Ah, ajo përkëdhelje do të doja të ishte nga dora e tim eti sepse nuk i mbaj dot në mend ledhatimet atërore!...Po ti o lot më shkarravite fjalët që po shkruaja në letrën, të cilën dua ta adresoj në dyert e parajsës, te Ai që më la me lot në sy, te Ai që la një vend të zbrazët në tryezë, te Ai që më dha dhe një emër tjetër-emrin jetim.



I dashuri Baba,

E bëra zemrën gur dhe me mallin më të madh dua të të shkruaj, të të tregoj sa të dua, sa jam rritur. Dita kur më le ishte ditë me shi... Atëkohë s'dija të derdhja lot, andaj qielli qau për mua. Acar, dëborë në mua mbretëroi, ndonëse ishte kohë vere.

Tri vjet isha kur më le, këtë e di dhe Ti, e unë se di sa vjeç isha, por nëna më tregoi. Ajo më flet shumë për Ty. E di baba, shpesh më merr malli të dëgjoj

ndonjë fjalë nga Ty, ta di ç'zë kishe, ta shikoj buzëqeshjen Tënde, por kot. Jeta qenka i vetmi libër që s'mund t'ia kthesh fletët prapa! Më le vetëm, por s'dua të jem robëreshë e vetmisë, prandaj shpesh qesh... Qesh të të sjell ty pranë sepse më thonë që buzëqeshja ime i ngjan tëndes. Më bëhet qejfi kur më flasin për Ty, kur më tregojnë sa më doje, si më ngrije lart dhe më përqafoje! Sa keq!... Mua s'më kujtohet as edhe një çik, andaj qaj për ditët e lumtura që u venitën në harresë dhe qesh kur më rrahin krahët dhe të lavdërojnë Ty. Vërtet, të falem që

më le pas veprën tënde të mirë! Me të krenohem, ndjehem e fortë, ndaj askush s'më nget, s'më ul poshtë. Por, lotin e kam shok në çdo ditë të rëndësishme për mua...

Është mirë të vijmë në këtë jetë duke qarë dhe të tjerët të qeshin, e pastaj ne të vdesim duke qeshur dhe t'i lëmë të tjerët të qajnë për ne. Kjo është filozofia dhe realiteti bashkë. Qajmë për njeriun e pastër, për engjëllin që fluturoi në amshim...Ngadalë e kuptova se në këtë jetë jemi të ftuar për një kohë të shkurtër dhe ikim me trenin e pakthyeshmërisë. Këtij treni i takove Ti, i dashuri baba, por dhe unë do të jem udhëtare e këtij rrugëtimi, si edhe të gjithë njerëzit e tjerë. E ke parasysh? Jetoj me një shpresë të ndryrë në gjë që kur të vij tek Ti, të më presësh me buzëqeshjen që i jep babai bijës së tij. Ndoshta s'do të të njoh, por mbaje këtë letër në dorë dhe do të takohemi, atje në përjetësi, në parajsë ku ke zënë vend që sa kohë.

TË DON ME GJITHË ZEMËR!

Bija jote

P.S.: Të lutem, m'i bëj të fala pejgamberit tim Muhamedit a.s. dhe lutju Zotit në emrin tim që të m'i falin gabimet e mia, të familjes time dhe gjithë njerëzve që e lexuan këtë ese.

Shpresa Rama

Agim Deva mbetet një yll i pashuar i letërsisë për fëmijë

Me punën e tij të gjithanshme drejtuese e krijuese, ai ishte shembulli i një njeriu virtuoz, me një kapacitet të jashtëzakonshëm intelektual. Agimi nuk ishte vetëm letrar, shkencëtar dhe profesor. Ai, njëherësh, ka qenë qytetar me vlera dhe i spikatur. Ishte njeri me dinjitet, i fortë përballë dallgëve, burrëror dhe konstant në vlerat si qytetar.

Demir RESHITI

Më një shkurt pushoi së rrabri zemra e shkrimtarit, profesorit dhe studiuesit të letërsisë, Agim Deva. Të gjithë fëmijët që ishin mësuar ta shohin në krye të Karvanit të Shkrimtarëve poetin me mjekër e me zemër të bardhë, atë të diel janë ndierë nga pak jetimë. Jetimë janë ndier edhe kolegët e Agimit, poetët për fëmijë për të cilët Agimi ishte si një çadër e madhe ku ata gjenin strehim. Ideatori dhe udhëheqësi i manifestimit më të madh letrar në botë (Karvanit të Shkrimtarëve për Fëmijë), Agim Deva është ndarë nga jeta, të dielën e parë të shkurtit në orët e mbrëmjes, pas një sëmundje të rëndë, në moshën 61-vjeçare.

Ai ka kryer Fakultetin Filozofik, Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Prishtinës, ku edhe ka magjistruar dhe doktoruar në fushën e letërsisë për fëmijë. Pas diplomimit në fakultet, ka punuar një kohë si gazetar në "Zërin e rinisë", e me vonë si kryeredaktor i parë i "Gazetës së pionierëve".

Në vitin 1973, nisi punën në Fakultetin e Filologjisë, së pari - asistent në "Teorinë e letërsisë", e pastaj, ligjërues në lëndën "Letërsia për fëmijë", të cilën e ka mbajtur deri në maj të vitit 2008 kur iu dorëzua sëmundjes. Në këtë fakultet, Agim Deva, si profesor ordinar ka ligjëruar edhe: Fillet e gazetarisë, Kritikën letrare, ndërsa në Departamentin e Gazetarisë ka ligjëruar lëndën Zhanret e gazetarisë.

Gjysmë shekulli krijimtari letrare

Me krijime letrare ka filluar të mer-

ret shumë herët, qysh në moshën dhjetëvjeçare, pra që nga viti 1958. Librin e parë "Trumbeta e artë" e botoi më 1968, libër i cili zgjoi interesim të konsideruar si te lexuesit, po ashtu edhe te kritika letrare dhe ishte një sinjal se në letrat shqipe po vjen një shkrimtar i madh, i cili do të jetë i pranishëm përherë në skenën letrare duke mbajtur kontakt të vazhdueshëm me lexuesin, sidomos me lexuesit e vegjël.

Ishte njëri ndër shkrimtarët më produktivë të letërsisë sonë, veçmas asaj për fëmijë. Për gjysmëshekulli të

ky vit shkollor, i mësojnë shkronjat e bukura shqipe mijëra vogëlushë anekënd Kosovës.

Opusi krijues i Agim Devës shtrihet në mbi 70 vëllime, të cilat janë botuar nga shumë shtëpi botuese e institucione të tjera prestigjioze si: "Rilindja", "Flaka e vëllazërimit" në Shkup, "Pionieri", "Libri shkollor", "Rozafa", "Zef Serembe", "Kinderberg", "UNICEF"-i, "SOROS"-i, "Sida", "USAID"-i, "KCF"-ja, "REC"-i, "Save the childrens", "Hendicap International", "Oxfam"- etj.

Disa nga veprat e veta, ky krijues i nxori nga shtypi si botime të autorit, ndërkohë që ka lënë në dorëshkrim edhe disa libra të tjerë.

Agim Deva, për punën e tij letrare dhe arsimore, qe nderuar me shumë çmime prestigjioze si dhe me dhjetëra mirënjohje, pena të arta, falënderime e çmime të ndryshme për tekstet me të mira të interpretuara nëpër festivale e manifestime të tjera në Kosovë dhe jashtë saj.

Ishte pjesëmarrës në Simpoziumin Ballkanik të Letërsisë për Fëmijë të mbajtur në Tiranë (në vitin 2000), si edhe në shumë takime letrare në Shqipëri, Austri, Belgjikë, Gjermani, Zvicër, Itali, Francë, Maqedoni, Mal të Zi etj.

Poezitë e tij janë përkthyer në disa gjuhë të huaja, si në: anglisht, gjermanisht, arabisht, italisht, rusisht, sllovakisht, rumanisht, kroatisht, turqisht, sllovenisht, maqedonisht, serbisht etj.

Cilësia dhe sasia e këtyre veprave flasin, gjithsesi, për një botë jashtëzakonisht të pasur krijuese dhe një qasje jashtëzakonisht të ndjeshme, të larmishme e interesante ndaj botës së fëmijës. Ai kurdoherë ka pasur se çka t' u thotë fëmijëve. Ai kurdoherë, me secilin libër, doli i ri, i freskët, me përmbajtje të reja.



krijimtarisë letrare, Agimi i la letërsisë shqiptare një opus të madh veprash.

Ka botuar një numër të konsideruar veprash letrare (prozë e poezi), antologji të ndryshme, panorama të poezisë botërore, vepra të ndryshme shkencore, monografi, kritika, recensione, ese, parathënie e pasthënie, një libër leximi për klasën e katërt fillore, një roman, dy pjesë teatrore, dy libra për fëmijët e hendikepuar, libra ilustrativë për fëmijët e moshave parashkollore, libra me karakter ambientale, së fundi, botoi edhe Abetaren me të cilën, që nga

Agim Deva mbetet edhe studiuesi, kritiku dhe teoricieni i parë i letërsisë shqiptare për fëmijë në Kosovë i cili hodhi bazat e i dha shtysë zhvillimit të mendimit kritik letrar dhe historisë së kësaj letërsie.

Ishte krijues shumë i lexuar e shumë i dashur dhe, njëkohësisht, krijues shumë i frytshëm. Me përvojën e tij të krijuesit dhe profesorit të letërsisë ndihmoi edhe një numër të konsideruar të shkrimtarëve tanë, duke ua redaktuar e recensionuar deri më tani mbi 300 libra.

Mik i madh i fëmijëve dhe humanist shumëdimensional

Agim Deva ishte mik i madh i fëmijëve, humanist shumëdimensional, i cili deri në ditët e fundit nuk reshti së dhëni kontributin e çmuar për të sotmen e për të ardhmen e tyre. Vepra e tij letrare e mbështetur në një spektër të pafund krijues e kënde të panumërta të interpretimit të dukurive e të botës së fëmijëve, do të jetojë për brezat e ardhshëm si një vlerë e madhe e kulturës sonë kombëtare.

Si cilësia ashtu edhe numri i veprave të tij letrare e dëshmojnë të vërtetën se përkushtimi ndaj krijimtarisë artistike është përbërës i domosdoshëm i dhuntisë së madhe krijuese.

Si themelues e drejtues i “Karvanit të Shkrimtarëve për Fëmijë” që nga viti 2000 e këtej, Agimi ka udhëhequr mbi 730 manifestime letrare në qindra mjedise anembanë Kosovës, por edhe me gjerë - në Maqedoni, Shqipëri, Mal të Zi, në Kosovën Lindore, etj. Ka organizuar disa simpoziume e sesione shkencore mbi çështjet e letërsisë për fëmijë e të rinj.

Me kthjelltësi të rrallë mendimi, me një të folur të qartë e të shtruar, të rrjedhshëm e të këndshëm, shquhej në komunikimin me të gjithë, që nga kolegët e deri tek lexuesit e vegjël, fëmijët.

Ai, tërë jetën, si mësues e si shkrimtar, me fjalën e tij ushqeu rritjen dhe lulëzimin e njeriut. Duke ia përkushtuar tërë jetën diturisë e artit, ai arriti që të krijonte mbretërinë e fjalës së vet, prej nga buronte humanizmi e çiltërsia. Me inteligjencën e veçantë në sytë e ëmbël e me fisnikëri të bukur në shpirt, ai ruante përfytyrimin e figurës që u takon të gjithëve.

Me punën e tij të gjithanshme drejtuese e krijuese, ai ishte shembulli i një njeriu virtuoz, me një kapacitet të jashtëzakonshëm intelektual.

Agimi nuk ishte vetëm letrar, shkencëtar dhe profesor. Ai njëherësh ka qenë qytetar me vlera dhe i spikatur. Ishte njeri me dinjitet, i fortë përballë dallgëve, burrëror dhe konstant në vlerat si qytetar.

Ai do të rrojë mes nesh si model i Njeriut të Mirë, studiuesit e shkrimtarit, pedagogut, me vështrim përherë tek ardhmja e shoqërisë.

Agim Deva mbetet një yll i pashuar i letërsisë për fëmijë. Ai vazhdon të përhapë dhe të dërgojë dritë vezulluese, ngrohtësi, mirësi dhe dashuri njerëzore, mesazhe paqeje dhe humanizmi, veçanërisht te lexuesit e vegjël, që ai i donte aq shumë dhe që u kushtoi pjesën më të madhe të jetës dhe të energjisë së tij krijuese. Të tillë, do ta kujtojmë për jetë të jetëve.

E ndiej vetën me fat që isha student, koleg, bashkëpunëtor dhe mik shumë i mirë i profesor Agimit. ■

Dita e Shën dashuruarve

“E vërteta nuk drejtohet nga ne, por ne duhet të drejtohem nga e vërteta” M. Klaudius



Mexhid YVEJSI

Ja, na erdhi sërish, edhe sivjet, 14 shkurti - Dita e Shën Valentinit - Dita e të dashuruarve...! Shtypi, radiot e ndryshme, televizionet lokale, kombëtare, ndërkombëtare, miliona faqe nëpër internet po e përhapin këtë të “vërtetë”...E vërteta, siç thoshte Klaudiusi, nuk drejtohet nga ne, por ne duhet të drejtohem nga e vërteta.

E vërteta rreth Ditës së Shën Valentinit

Festa, Dita e Shën Valentinit - Dita e të dashuruarve, edhe pse ka emër e ngjyra kristiane, është një festë më e vjetër, me prejardhje, me rrënjë pagane... Ka filluar të kremtohet në Romën e lashtë, në Perandorinë Romake... Në atë kohë nuk ishte festë kristiane, por kremtohej si një festë pagane... Kremtohej si një festë pagane më 14-15 shkurt, me përkushtim, në përkujtim, me shumë nderim, ndaj hyjneshës Juno... Juno ishte hyjneshë - mbretëreshë...Mbretëreshë hyjnore, mbretëreshë qiellore, ishte hyjneshë e mirësisë dhe kjo ditë quhej: “Dita e pjellshmërisë”... “Dita e pjellshmërisë” në Perandorinë Romake me shekuj është kremtuar si një festë pagane, por kur Perandoria Romake e pranoi Krishterimin, atëherë kjo festë pagane u shndërrua në festë kristiane, Dita e Shën Valentinit, pra tashmë me një emër të ri, por që s’ka lidhje me dashuri...

Kush ishte Shën Valentini?

Shën Valentini ishte gjithkushi, por në të vërtetë ai ishte askushi...!

Shën Valentini nuk është një person i dëshmuar historik, por është një personazh i krijuar mitik... Sipas librit monumental:

Shën Valentinit - Dita e të dashurve apo dita e të mashtruarve?

“Hollmark Historical Collection” së paku janë tetë Shën Valentina... Kurse, sipas Enciklopedisë Katolike (Catholic Encyclopedia) së paku janë tre Shën Valentina, të tre të ndryshëm, të tre martirë, të cilët përmenden në disa shënime, ku shkruhet se janë ekzekutuar në të njëjtën ditë: me 14 shkurt 269...! Prej tre Shën Valentinëve, sipas Enciklopedisë Katolike, i pari përshkruhet si një prift me shërbim në Romë, tjetri si një ipeshkëv i qytetit Interamna, sot ky qytet njihet me emrin Terni, Itali, kurse i treti është Shën Valentini në Afrikë, i cili u ekzekutua, sikur dy të parët, në të njëjtën ditë, por në vende të ndryshme...

Këto shënime, sipas Enciklopedisë Katolike, nuk kanë asnjë vlerë historike... Meqë këto personazhe janë të

imagjinuara, të sajuara, janë mitike, pra, nuk kanë vlera të dëshmuara historike, për këtë arsye, Kisha Katolike e ka larguar Ditën e Shën Valentinit nga Kalendari Zyrtar Kishtar ...

Kush e krijoi mitin për Ditën e Shën Valentinit, si Dita e të dashurve?

Deri në shekullin e XIV-të, Dita e Shën Valentinit kremtohej në Evropë si një festë kristiane, me rrënjë pagane, që nuk kishte asnjë lidhje, siç ka sot, në shekullin e ri, me dashuri... Por, nga shekulli i XIV-të kësaj feste iu shtua edhe një risi, për t'i dhënë pakëz gjallëri, atë e lidhën me dashuri...!

Ndërtuesi i këtij miti të ri, i cili e lidhi këtë festë me dashuri ishte Geoffrey Chaucer.

Kush ishte Geoffrey Chaucer?

Geoffrey Chaucer (1343-1400) ishte shkrimtari, diplomati, filozofi, poeti anglez, ai i cili njihet e pranohet në Angli si Babai i Letërsisë Angleze...

Në kohët e lashta, popujt evropianë, kur ishin paganë, besonin në shumë mite, përralla... Evropianët besonin se në fund të javës së dytë, të muajit të dytë, që është mesi i muajit shkurt, zogjtë, shpezët, fillojnë të çiftohen...

Filozofi, diplomati, shkrimtari, poeti anglez Geoffrey Chaucer, Babai i Letërsisë Angleze, i cili i njihje shumë mirë mitet e lashta, është i pari që këto mite i shfrytëzoi

si brumë letrar në veprat e tij, në veçanti në poezi... “Kur zogjtë, shpezët, çiftohen – pse të mos çiftohen edhe njerëzit, gjithë kjo rini, me dashuri...”

Dita e të dashurve apo Dita e të mashtruarve?

Mendoni mirë për këtë ditë. A është kjo ditë: Ditë e të dashurve apo ditë e të mashtruarve? Ajo çka mendojmë ne ndikon te vetë pikëpamjet tona dhe të trajtimit që u bëjmë ne të tjerëve dhe botës. Bota ka një sundues. Kush e sundon botën? Siç thoshte Aristofani, dashuria për përfitime sundon tërë botën... Pra, edhe kjo festë, Dita e Shën Valentinit, është një ditë e përfitimit, është një ditë e mashtrimit...!

Kjo nuk është një ditë dashurie e dashuruesve, por kjo është një ditë mashtrimi e mashtruesve...!

Besimtarët e tri besimeve monoteiste, të cilët besojnë në një Zot, hebrenjtë, krishterët dhe muslimanët, kanë njohuri të mjaftueshme nga Burimi, për të mos u lëkundur nga mashtrimi... Mashtrimi vjen nga dreqi, shejtani, këtë e dëshmon Bibla, e dëshmon Kur’ani...

Dashuria nuk është krijesë njerëzore... Dashuria është Dhuratë Hyjnore...

Rumi shprehet kështu:

*“Mendja s’ka fuqi
M’u shpreh për dashuri.
Vetëm Dashurisë
I është dhuruar
Të vërtetën e saj
Për ta zbuluar...”*

Në Bibël shkruhet: “Zoti është Dashuri” (Bibla, 1 Gjoni,4:16).

Po këtë të vërtetë, Zoti, na e rikujton në Kur’an “Vërtet, Zoti është shumë i dashur” (Kur’an,11:90).

Dhe më në fund, në mes të këtij pështjellimi kulturor botëror, ndoshta më shumë se kurdoherë më parë, ne, në veçanti, si shqiptarë, kemi nevojë për aftësinë e të menduarit në mënyrë kritike... Pa këtë aftësi, ne besojmë lehtë, mashtrohemi shpejt...!

(Autori është studiues i religjioneve)



Mendimi dhe të pyeturit

Mësimdhënia rreth të menduarit bazohet në sugjerimin se sa më shumë që të dinë nxënësit/studentët rreth përmbajtjes, aq më efektiv bëhet të menduarit e tyre. Ky koncept nxit mësimdhënien e aftësive të të menduarit. Kjo ndihmon në përfitimin e njohurive dhe bazës teorike për të përmirësuar aftësitë dhe proceset mendore.



Fitim VELIU

Në të kaluarën, nxënësit kanë mësuar në shkollë çdo detaj rreth të menduarit, duke ju referuar në këtë mënyrë thënies se qëllimi i shkollës është mësimi rreth të menduarit kritik. Për zhvillimin e aftësive mendore dhe të zgjidhjes së problemeve, duhet t'i njohim modelet të cilat e nxisin mendimin. Këtë duhet ta bëjë institucioni p.sh.: shkolla duhet të sigurojë përvoja në të menduar dhe në zgjidhjen e problemeve.

Që një nxënës të mendojë, ai duhet të mësojë të përfshihet aktivisht në problemet, të dhënat, materialet, temat, konceptet dhe në çështje të ndryshme. Mësimdhënia në të menduar duhet të zhvillohet krahas lëndëve të tjera, sepse kjo paraqet një problem në saktësinë e demonstrimit të të menduarit. Në praktikën shkollore, mësuesit synojnë për pyetje kryesisht mbi dijet dhe nivelin e ulët të njohjes. Dhe në shumicën e shkollave mendimi dhe reflektimi janë elemente që mungojnë dukshëm në mësimdhënie. Dhe kjo praktikë duhet të ndryshohet.

Mësimi mbi të menduarit


Mësimdhënia rreth të menduarit bazohet në sugjerimin se sa më shumë që të dinë nxënësit/studentët rreth përmbajtjes, aq më

efektiv bëhet të menduarit e tyre. Ky koncept nxit mësimdhënien e aftësive të të menduarit. Kjo ndihmon në përfitimin e njohurive dhe bazës teorike për të përmirësuar aftësitë dhe proceset mendore. E gjithë kjo lidhet me dy zona të të mësuarit: truri dhe funksionet e tij. Pra, duhet të njihet baza biologjike e mendimit, teoritë e zhvillimit dhe ato të përpunimit të informacionit. Dhe kjo do ta lehtësonte nxënësin të kërkonte përgjigje dhe të njihej me procesin e të menduarit. Një zonë tjetër është metanjoja. Kjo do të thotë që të jesh i ndërgjegjshëm për proceset e mendimit, ndërkohë që je duke menduar. Mendimi me zë të lartë është një shembull i kësaj. Puna kërkimore tregon se ata që zgjidhin problemet, pëshpëritin, pra, flasin me veten. Kjo përfshin përsëritjen e shpeshtë të situatës, kontrollin dhe vlerësimin, në qoftë se mendimet ecin në rrugë të drejtë. Një tjetër trajtim i mësimi-metanjojes është kërkimi nga nxënësit, identifikimi se çfarë është e njohur në një situatë dhe çfarë hapash duhen ndërmarrë për të fituar. Këtë informacion p.sh.: mund ta mësojmë në një orë mësimi, nëse ne bëjmë një pyetje rreth një problemi, përgjigjet e para të nxënësve shënohen në dërrasë. Këto të dhëna përbëjnë atë që njihet. Në grupe të vogla nxënësish pyetjet mund të përgjithësohen duke siguruar informacion dhe përgjigje të mundshme. Ushtrimi i tillë nxit mendimin në qoftë se kjo ndodh shpesh dhe me vëmendje për t'i identifikuar proceset e ndryshme. Po ashtu, metanjoja mund të zhvillohet, kur mësojmë se si mendojnë të tjerët, veçanërisht ata që shprehin arritjet e tyre, sepse ata mund të eksplorojnë dhe të diskutojnë se si punon një shkencëtar dhe ç'hapa ndjek ai për këto arritje, cili ishte elementi ose shtytësi në arritjen e suksesit të tij. Metanjoja mund të përdoret gjithashtu në sjelljen akademike, p.sh.: kur nxënësit mësojnë

më mirë në mënyrë vizuale, auditive, apo lëvizore. A kanë ata strategji në secilën fushë që i ndihmojnë? Të gjitha këto kanë lidhje me përvojën shkollore të nxënësve dhe studentëve. Zona e fundit e mësimi mbi të menduarit përqendrohet në dijet rreth tij. Kjo lidhet me dy çështje: duhet që nxënësit dhe studentët të dinë për proceset e mendimit njerëzor në përgjithësi dhe të dinë të mësojnë të jenë të vetëdijshëm, të kontrollojnë strategjitë e tyre të të menduarit, me intuitë, ose në mënyrë empirike.

Të pyeturit induktiv

Nuk ka asnjë mënyrë të pastër mësimdhënie mbi të pyeturit induktiv, por ka elemente të metodës induktive që mbizotërojnë në të gjitha strategjitë e të pyeturit. Metodologjia e të mësuarit induktiv mund të jetë ose jo element i saktë i zbulimit të shtigjeve të vërteta. Induksioni ose logjika induktive është një proces mendimi ku individit dalton një numër të zgjedhur ndodhish, procesesh a objekte. Atëherë të pyeturit induktiv është një metodë që përdor arsimitari në rastin e paraqitjes së një situatë ose të dhëne, ku pastaj u kërkojnë nxënësve të nxjerrin një konkluzion, përgjithësim ose një model marrëdhënieje. Ai është një proces që e lejon nxënësin të vëzhgojë specifikën dhe pastaj të arrijë në përgjithësim. Të pyeturit induktiv ndahet në dy grupe: i drejtuar dhe i padrejtuar. Mësimi induktiv i drejtuar është kur mësimi ka gjithë specifikën e trajtimit të materialit, dhe ku nxënësit bëjnë përgjithësim. Ndërsa, nëse rastet dhe materiali lihet në përgjithësim, atëherë kjo është të pyeturit induktiv i padrejtuar. Të pyeturit induktiv është i përshtatshëm për të gjitha nivelet e mësimi, nga parashkollorët deri të niveli i universitarëve. Aspekti tjetër i rëndësishëm i të pyeturit induktiv është se proceset e vëzhgimit, konkluzionit, formulimit dhe hipotezave të parashikimit, të gjitha përforcohen nga përvoja. ■



Vështrim kritik

Kohë e harrimit

Diskursi i figurës e i shkrimit personal, në strukturën shtresore të poezisë së Ibrahim Kadriut, dëshiron të jetojë pa kohën. Ajo tani paraqitet vetëm si hije dhe subjekti as që dëshiron të identifikohet më të. Mosidentifikimi më të, e dërgon diskursin e poezisë të neutralja.



Flamur MALOKU

Veptra poetike “Frymëmarrja në shtjellë” e Ibrahim Kadriut, shënon në tërësinë tekstore, kohën e paemëruar, por të përjetuar nga subjekti. Andaj, kjo kohë në fiksionin e tekstit nuk ka emër, sepse kërkohet harrimi i saj. Kjo, në ide, ngre një teori ku poezia-shkrimi personal, tani në botën e letërsisë, nuk e njeh as emrin e kohës. Kështu, diskursi i figurës e i shkrimit personal, në strukturën shtresore të poezisë së Ibrahim Kadriut, dëshiron të jetojë pa kohën. Ajo tani paraqitet vetëm si hije dhe subjekti as që dëshiron të identifikohet më të. Mosidentifikimi me të, e dërgon diskursin e poezisë të neutralja e shkrimit. Pra, kohët shkelen njëra me tjetrën, për t’u theksuar vazhdimisht në gjakim shpirtëror, si emocion i motivueshëm, për të kaluar më shumë në poezi, në shenja dhe simbole. Shenjat ndërtojnë gjuhën e komunikuar, gjuhë e cila thekson vuajtje. Kohët vështira, edhe ashtu nuk pëlqehen nga poeti, sepse ato bëhen korniza dhe poeti nuk dëshiron të mbyllet në kornizat e kohës momentale. Tani, kërkohet të ndërtohet nga subjekti një shtesë e kohës tjetër, kohë kjo që vetëm poeti e ndërton. Kjo shtesë kohe është e veçantë për poetin, në të cilën vetmia dhe dhembja janë shpirtërore, sepse, tani ajo, po kalon nga subjektiviteti në botën e letërsisë-shkrimit. Ajo shtesë kohe vjen tamam si ushtar i disiplinuar, por me vetmi, e mundime, si ditën, ashtu edhe natën:

Me të krijuar shtesë kohe

Me peshë të veçantë

Ardhur në vetminë e ditës dh natës

Si ushtar i disiplinuar

Pas ushtrimeve të rrezikshme.

Në figurën e ngritur, kjo shtesë kohe, shënon para së gjithash, kohën e frymëzimit, njëkohësisht edhe vetëflimin, përballë vetmisë personale, por që ka një ndjesi kënaqësie përgjatë shkrimit, kur ajo kalon në botën e letërsisë. Vetëm këtu subjekti gjen pak qetësi.

Kohë e harrimit

Ligjërimi shtresor i poezive shtrihet mbi idenë e vazhdueshme të kërkimit-harrimit të kohëve të përjetuara, sepse çdo perceptim mbi kohët e kaluara, vetëm sa bëhet i vështirë në përjetim. Mirëpo, subjekti i rikthehet kohëve, jo pse ka mall për ato kohë, po ende s’është çliruar shpirtërisht, sepse kujtimi është i hidhur. Dhe jo rastësisht, subjekti sjell në mendje në natën e vonë, kohën, e cila në gjuhën figurative-emocionale nënkupton edhe njeriun e lig, që i shkeli dhunshëm ëndrrat e jetës. Andaj, nata e përjetuar në vetmi, sjell në vete heshtjen, e heshtja bëhet edhe më e papërbalueshme në errësirë, duke krijuar kështu në kujtim, një rrëmujë në shpirtin-trupin e tanishëm të subjektit. Nata e shoqëruar me heshtje, bëhet katandisje e përgjithshme shpirtërore, sepse subjekti, tani është i ligështuar, përballë monotonisë së heshtjes- vetmisë:

Në natën e vrarë nga heshtja


Pa mëshirë shkele në ëndrrën time

Të gjitha hyrje-daljet nën dry

Të vetmuar më kishe pre

Ku më gjete të më mbaje në ethe.

Shihet se si kacafytet subjekti, me natën-heshtjen, përkundër vullnetit të tij. Gjërat e kaluara identifikohen më kohën, e cila në poezi del si një klithje e tanishme, që nganjëherë merr trajtën e një proteste, mbi padrejtësinë e ushtruar ndaj subjektit. Ajo, çka e rëndon edhe më shumë emocionalisht, është se ky përjetim vazhdon edhe sot, me një



mosrehati, shpirtërore, sepse ende është në ankth, ethe. Papajtueshmëria ndaj të keqes, në kohën e dikurshme, bëhet edhe sprovë personale në diskursin e shumë poezive, andaj subjekti mundohet të bëjë një paraqitje të tri kohëve: për kohën e dikurshme, që nënkupton pësimin / vuajtjen / dëshpërimin, kohën momentale, që nënkupton moskomunikimin / zhgënjimin / trillimin, dhe asaj, që subjekti, e quan shtesë-kohe, me shtrirje neutrale, në të cilën subjekti identifikohet / frymëzohet / qetësohet, tash. Simbolika-figura e shkrimit të poezive shkon tutje, duke prekur momente të ndryshme, për të mos ikur asnjëherë nga tragjikja personale dhe fatit të mëtutjeshëm të subjektit. Mundësia dhe pamundësia e fortesës subjektive, karshi nuancave kuptimore të jetës vërohen në të veçantën personale, gjatë komentimit-ndërtimit. Kështu, situatat e shumta kaotike të përjetuara, që nganjëherë janë të papërbalueshme, e bëjnë subjektin të ligështuar, sepse koha është ajo që ka krijuar një përplasje, ku edhe të menduarit shënjohej me vështirësi në diskursin e poezive. Kështu, koha bëhet pesimiste në shpirtin e subjektit, kohë kjo, për të krijuar më vonë shumë portretizime gjatë të menduarit, prandaj shumë gjëra në komentim hapen në vazhden e ligjërimin. Mirëpo, gjërat e komentuara bëhen të vështira në botën emocionale të subjektit. Jeta bëhet e padurueshme, andaj subjekti

fillon rrugëtimin jetësor, për të gjatuar një qetësi, sepse marrëzira është kudo, duke u bërë maratonë, të cilën po e sjell koha-njerëzit:

Marrëzira
Kapërcen rrugët sheshet
Pa trokitur në derë
Futet në ballë të oxhakut
Në odë ulet

Marrëzira është e pranishme, por më zhbërje të etikës njerëzore. Ajo ka bërë fole kudo, sepse ajo është mirëpritur nga vetë njeriu, që do të thotë se ajo është e dëshiruar, e kur është e dëshiruar, ajo edhe mirëpritet. Kjo gjë subjektin e tmerron dhe ai fillon të bëjë udhëtimin jetësor, udhëtim ky i dalë figurativisht, por i mbetur, e i rikthyer prapë në vete e vetvete, pa e pranuar asnjëherë kohën e tashme:

Ditë e net në një rrëfim
Më shpien në pikëllim
Udhëtoj e mbetem në vetvete.


Rikthimi në vetvete bëhet edhe frymëzim, për të krijuar më vonë kohë-shtesën, të cilën autori e dëshiron, siç është cekur më lart, sepse e tashmja është tkurrur nga marrëzia, pikëllimi e s'ka strehë për subjektin. Kështu, të gjitha thyerjet e kohëve e bëjnë më të identifikueshëm emocionalitetin gjatë leximit të poezisë së Ibrahim Kadriut, pra thyhen të dy kohët, e krijohet koha tash, si qetësi shpirtërore, për të ikur nga pikëllimi-vetmia, e për të hyrë në kohë-shtesën pa emër. ■




Vitrina e librit

"Ali Hadri- Jeta dhe vepra"

Instituti i Historisë në Prishtinë ka botuar monografi-në "Ali Hadri- Jeta dhe Vepra", në të cilën janë përmbledhur materialet e Akademisë Përkujtimore të organizuar nën Patronazhin e Presidentit të Kosovës, me rastin e 20 vjetorit të vdekjes së Akademik Ali Hadrit dhe të Simpoziumit Shkencor "Ali Hadri-Jeta dhe vepra", organizuar në mars të vitit 2008 nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe Instituti i Historisë. Në këtë vëllim janë përfshirë kumtesat e prezantuara nga studiues të fushave të ndryshme, përmes së cilave është paraqitur kontributi i akademik Ali Hadrit dhënë shkencës, arsimin, kulturës dhe historiografisë shqiptare. Ky botim i Institutit të Historisë paraqet edhe një herë punën e vyeshme të këtij instituti për të ndriçuar dhe hedhur dritë mbi kontributin e figurave të shquara të Kombit. Në libër janë përfshirë kumtesat e 24 studiuesve nga Kosova dhe Shqipëria. Po ashtu, libri është i ilustruar edhe me disa fotografi, dokumentare të rëndësishme për pasqyrimin e kontributit të Ali Hadrit. Libri ka 262 faqe. E botoi IHP, Prishtinë, 2008.




IAP: "Gjurmime albanologjike"



Në shenjë përkujtimi për studiuesin e etnologjisë dhe kompozitorit të shquar Ramadan Sokoli, seria e 37-të e revistës "Gjurmime albanologjike", folklor dhe etnologji, i është kushtuar këtij etnomuzikologu dhe kompozitori, seri në të cilën kjo revistë përmban në vete një numër punimesh dhe studimesh të Sokolit, por edhe të studiuesve të etnologjisë dhe folklorit shqiptar. "Gjëmat, vajtimet e përmotshme dhe elegjitë" është punimi që hap këtë revistë, i etnomuzikologut Ramadan Sokoli, si dhe studimi i Rexhep Munishit, "Karakterit të studimeve dhe shkrimeve për veprimtarinë e Ramadan Sokolit", ku janë dhënë mjaft informata mbi jetën dhe kontributin e studiuesit Sokoli dhënë etnosit shqiptar. Në të njëjtën kohë, në këtë numër kanë zënë vend edhe një numër punimesh shkencore me interes për folklorin dhe etnologjinë shqiptare, duke përfshirë edhe studiuesin japonez Kazuhiko Yamamoto, mbi strukturën etnike të Kanunit. Libri ka 342 faqe. E botoi IAP, Prishtinë 2008.

Viola Isufaj: "Ditët e askujt"

Me librin më të ri në prozë, "Ditët e askujt", shkrimtarja Viola Isufaj ka sjellë risi në letrat shqipe, libër ky që është vlerësuar lart edhe nga kritika dhe nga studiuesit letrarë. Ky është libri i tretë i kësaj shkrimtareje, në të cilin shprehet fuqishëm një teknikë mjaft cilësore e të shkruarit dhe një stil tashmë i konsoliduar. Deri më tani, Viola Isufaj ka botuar edhe librin "Saga e gjarprit". Ajo është mësimdhënëse në Universitetin e Tiranës dhe mban gradën shkencore master në fushën e letërsisë. Libri ka 79 faqe. Botoi "Ora", Tiranë, 2008.




Flamur MALOKU

Ngjarje kulturore

Ndërroi jetë shkrimtari Agim Deva

Në fillim të këtij muaji, pas një sëmundjeje të rëndë, ka ndërruar jetë pedagogu, krijuesi dhe studiuesi i mrekullueshëm i letërsisë për fëmijë prof. dr. Agim Deva. Me vdekjen e tij fëmijët kanë humbur një mik të madh dhe të pazëvendësueshëm, i cili një pjesë të madhe të jetës dhe veprimtarisë së tij ua kushtoi pikërisht fëmijëve. Krerët më të lartë të shtetit, por edhe drejtues institucionesh kulturore e pedagogjike, i kanë dërguar telegrame ngushëllimi familjes Deva dhe kanë vlerësuar lart veprimtarinë krijuese dhe kontributin pedagogjik të prof. Agim Devës. Agim Deva ka lindur më 1948 në Beograd. Ka studiuar letërsinë në Universitetin e Prishtinës. Në fillim ka punuar si gazetar në "Zërin e rinisë" e më vonë të "Gazeta e pionierëve". Ndërsa që nga viti 1973 punoi në Fakultetin e Filologjisë në UP, ku ligjëroi lëndën 'Letërsi për fëmijë' dhe 'Gazetari'. Veprimtaria krijuese e prof.

Agim Devës, përfshin një periudhë kohore mbi dyzet vjeçare, me 68 vepra letrare për fëmijë, dy antologji, tri vepra studimore dhe tekste shkollore. Gjithë veprën e tij krijuese ua kushtoi fëmijëve. Për punën e tij mori 11 çmime kombëtare e ndërkombëtare për letërsi. Agim Deva i përket asaj klase intelektuale, që për dekada të tëra ushtruan me zell e përkushtim profesionin më fisnik, atë të mësimdhënësit, që u daluan për dashuri ndaj profesionit, ndaj studentëve, për profesionalizëm e korrektësi në punë. I përket atij brezi misionarësh të dritës e të diturisë, që jetën e tyre e lidhën me artin, me letërsinë, me shkencën, me kulturën, me arsimin.



Poezi

Nën hije të pasqyrës

Mimoza SALI

Hëna

Sonte hëna
Më përkëdheli flokët
Mendimin tim me ëndje ledhatoi.
Sonte ylli im
Sheh në sy tëndin
E si një fllad i ëmbël pranveror
Më penetron shpirtin
Që vrapon si rëra në shkretëtirë,
dhe sorkadhja para një luani
duke ndjekur ëndrrat e mia.
Unë, vrapoj si ty hënë
Duke puthur yjet një nga një.

Petalet

Sa shumë e prita atë verë
Sa dielli më rreshku ballin
Dhe perëndimi më verboi sytë
Një erë e lehtë më përkëdheli duart
Duke më lënë ndër gishta
Petalet e skeletit tënd.

Simfoni e gruas

Pasqyra ime është pikturuar
në copëza frymësh, si stuhi e papritur
që kërkon një copëz dielli
të fsheh sytë e lëngëzuar...
Nën rrugëtimin e pemëve
të harlisura...
Pasqyra ime vegël muzikore
ku dëgjohej tinguj degëzash pranveror
ku luan me gishtërinjtë e erës
nëpër telat e flautit
Ku dëgjon simfoninë e gruas së dashuruar
"Po digjet nata nga dëshirat..."
Nën hije të pasqyrës,
Unë luaj me hirin e pasionit
kërkoj gacën e ndezur
Pasqyra ime petal trëndafili
që zhvishet hirshëm
prej duarve të dashurisë.

S'është faji yt

Ti e fshehur si hajdute
Me gjysmë dritëze nën re
S'më flet por me sy më thua:
mos u trishto
nuk është faji yt
që bota mbytet në një lugë ujë

Ali Podrimja dhe Nysret Krasniqi fitues të Çmimit Kombëtar "Azem Shkreli"

AKademik Ali Podrimja dhe studiuesi Nysret Krasniqi janë fitues të Çmimit Kombëtar për letërsi "Azem Shkreli", për vitin 2008. Çmimin Kombëtar për letërsi "Azem Shkreli", për Vepër Jetësore i është ndarë akademik Ali Podrimjes, në vlerën prej 5.000 eurove, ndërsa Çmimin Vjetor "Azem Shkreli", për veprën më të mirë të vitit 2008, Ministria ia ka ndarë studiuesit Nysret Krasniqit, për veprën "Udha

kratiliqe", çmim i cili kap vlerën 3.000 euro. Në garë për të marrë çmimin vjetor "Azem Shkreli", për vepër jetësore Ali Podrimja ka qenë i pa konkurrent, ndërsa për çmimin vjetor për veprën më të mirë, në garë ka qenë gjashtë kandidatë, nga të cilët juria e përbërë nga shkrimtarët Jusuf Buxhovi, Arif Demolli dhe Avdi Visoka, ia ka ndarë çmimin Nysret Krasniqit. Çmimi Kombëtar për Letërsi "Azem Shkreli", është themeluar nga MKRS.

Galeria e Arteve të Kosovës bëhet me Bord Drejtues

Studiuesja e artit Penesta Dika është zgjedhur kryetare e Bordit Drejtues të Galerisë së Arteve të Kosovës. Ky bord është formuar në janar të këtij viti dhe



detyrë e tij është që të avancojë jo vetëm veprimtarinë e GAK-së, por të sjellë risi në menaxhimin e artit në Kosovë. Vendimi është marrë nga Ministria e Kulturës, me kërkesë të drejtorit në dorëheqje të kësaj Galerie, Luan Mulliqit. Dr. Penesta Dika ka studiuar dhe doktoruar në Vjenë dhe Lintz të Austrisë për Histori të Artit. Bordi Drejtues i Galerisë së Arteve është themeluar në bazë të vendimit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, më 14 janar.

Përgatiti: Esat VATOVCI

Kuriozitete

- Qoftë edhe në natën më të kthjellët, syri i njeriut mund t'i shohë vetëm rreth 3.000 yje. Ndërsa, vetëm në galaktikën tonë numërohen rreth 100.000.000.000 yje!





- Mali më i lartë në Sistemin Diellor është 'Olympus Mons', në planetin Mars, dhe ka një lartësi prej rreth 24140.16 m, tri herë më të madhe se lartësia e Mount Everest-it. Ka një diametër rreth 500 km dhe një sipërfaqe që do të mbulonte gjysmën e Spanjës!



- Sikur Dielli të paramendohej si një pikë e shkronjës 'i' të madhësisë së zakonshme, atëherë ylli më i afërt i Diellit do të ishte në një distancë prej 16 km largësi!

- Vetëm gjysma e një të miliardës pjesë së energjisë së liruar nga dielli arin në tokë!




- Në planetin Venerë, temperaturat janë aq të larta sa që mjaftojnë për ta shkriur plumbin.

- Sikur njeriu të mund të udhëtonte me shpejtësinë e dritës që është pak më shumë se 300.000 km për sekondë, do t'i ish dashur 100.000 vite për ta përshkuar vetëm 'Rrugën e Qumështit', pra galaktikën tonë.

- Gjithmonë, vetëm njëra anë e Hënës është e kthyer nga Toka. Periudha e rotacionit të Hënës është saktësisht e njëjtë sikurse perioda e saj e orbitës.

- Ylli i ndritshëm i quajtur 'Betelgeuse', që gjendet në anën e sipërme në të majtë të krahut të Orionit, është aq i madh sa që po të ishte vendosur aty ku gjendet Dielli, do të kishte kapërdirë Tokën, Marsin dhe Jupiterin!



- Nëse qëndroni në ekuator, do të silleni me një shpejtësi rreth 1600 km për orë brenda tokës si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj, e po ashtu rrotulloheni rreth Diellit me një shpejtësi prej 107826 km për orë!

- Po ashtu, nëse qëndroni në ekuator, ju peshoni rreth 3 % më lehtë se sa në pole, si pasojë e forcës centrifugale e shkaktuar nga sjellja e Tokës!

- Atmosfera e Tokës në disa pjesë është proporcionalisht më e hollë se lëkura e një molle!

- Sikur një pjesë e Diellit në madhësi sa maja e një gjilpëre do të ishte vendosur në Tokë, atëherë askush nuk do të kishte mundur të qëndrojë me lehtësi në zonën rrethuese prej 145 km!

- Një ditë në planetin Merkur, pra koha që i nevojitet atij për t'u rrotulluar një herë rreth vetvetes, është sa 59 ditë të Tokës. Viti i tij, koha që i duhet për t'u rrotulluar rreth Diellit, është 88 ditë, që do të thotë që në Merkur viti ka më pak se dy ditë!

- Llogaritet që numri i yjeve në Univers është më i madh se sa numri i grimcave të rërës së të gjitha plazheve të botës! Në një natë të kthjellët ne mund të shohim aq yje sa numri i grimcave të rërës së mbajtura në një grusht!

- Çdo vit, Dielli avullon 160934 km kub ujë nga Toka. Kjo sasi e ujit peshon 400 trilion tonë!



- Planeti Saturn nuk është i vetmi planet me unazë. Po ashtu, edhe Neptuni e ka unazën e tij të sistemit!

- Planeti Jupiter vepron si një vakum-pastrues gjigant, duke i tërhequr dhe duke i absorbuar kometat dhe meteorët. Sipas disa llogaritjeve thuhet që pa influencën gravitacionale të Jupiterit, numri i projektilëve që e godasin Tokën do të ishte 10.000 herë më i madh!

- Astronautët besojnë që hapësira universale nuk është vakum i plotë – ekzistojnë tri atome për çdo metër kub të hapësirës universale!

Përgatiti: Bujar SEJDIU



Infarkti i miokardit – sëmundje e organit më jetik të trupit

Sëmundjet e zezrës janë të pakta dhe të rralla, por me një vdekshmëri të lartë. Ndër më të shpeshtat duhet të përmendim: ishemia e zezrës, angina, infarkti i miokardit akut dhe vdekja e papritur koronarike. Këto sëmundje prekin zakonisht moshat mbi 40 vjeç, megjithatë, moshat më të rrezikuara janë ato mes 50 dhe 60 vjeç



Artan N. BEJTA

Dihet fare mirë fakti se sëmundjet e zezrës janë shumë komplekse, kjo arsye tohet sepse këto sëmundje klinikisht janë rezultat i një ndërveprimi ndërmjet faktorëve të jashtëm (ambientalë) dhe faktorëve të brendshëm (gjenetikë). Te faktorët e jashtëm ose ambientalë futen të ashtuquajturit faktorë rrezikues, që mund të jenë: hiperkolesterolemia, diabeti, pirja e duhanit, hipertensioni arterior dhe obeziteti.

Shumë persona që vuajnë nga sëmundjet kardiake thuhet se e kanë të trashëguar. Kështu sëmundjet kardiake janë të trashëguara, por ajo që duhet theksuar është se ato janë të pakta dhe të rralla.

E vërteta qëndron në atë se predispozita është e lidhur me aktivitetin e gjeneve që rregullojnë mekanizmat kryesorë të sëmundjeve.

Sëmundjet e zezrës janë të pakta dhe të rralla, por me një vdekshmëri të lartë. Ndër më të shpeshtat duhet të përmendim: ishemia e zezrës, angina,

infarkti i miokardit akut dhe vdekja e papritur koronarike. Këto sëmundje prekin zakonisht moshat mbi 40 vjeç, megjithatë, moshat më të rrezikuara janë ato mes 50 dhe 60 vjeç.


Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), sëmundjet e zezrës, sëmundjet infektive dhe kanceri vazhdojnë të jenë shkaktarët më të shpeshtë të vdekjes së njerëzve.

Në 29 për qind të të gjitha rasteve të regjistruara të vdekjeve, si shkaktarë kanë qenë sëmundjet e zezrës dhe të enëve të gjakut, ndërsa sëmundjet infektive janë "përgjegjëse" për 16,2 për qind të vdekjeve.

Kanceri është shkaktar i vdekjes në 12,6 për qind të rasteve. Pas tyre pasojnë sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes, pastaj atij tretës, vetëvrastjet, çrregullimet neuropsikiatrike, diabeti etj.

Infarkti i miokardit – "Sulmi në zemër"

Sëmundja më e rrezikshme dhe më e shpeshta që prek




Mos pini duhan!
Nëse bëni ndaljen e pirjes së duhanit, atëherë keni në dorë fuqinë e madhe të parandalimit nga infarktet. Femrat që pinë duhan janë shumë herë më të rrezikuara se të tjerat. Madje kanë një ulje të moshës së infarkteve, mbi 35 vjeç.

zezrën është, pa dyshim, infarkti i miokardit. Sipas studimeve të fundit faktorët më të mëdhenj të rrezikut janë: hiperkolesterolemia, hipertensioni arterial (HTA) pirja e duhanit, diabeti, dhe obeziteti. Mirëpo nuk mënjanohet edhe efekti i stresit tek kjo sëmundje, por jo çdo formë e stresit ndikon në aktivitetin kardiak, por vetëm ai negativ, që lidhet me ndjenjën që nuk i përballon dot problemet. Pastaj efekt tjetër negativ ka edhe një dietë e çekuilibruar.

Hiperkolesterolemia

Kolesteroli është një substancë yndyrore si dyllë dhe shumë i nevojshëm për trupin e njeriut. Nuk mund të paramendohet një individ të jetojë pa kolesterol. Është i nevojshëm për qelizat, nervat dhe prodhimin e hormoneve. Diku afër - 80% e tij prodhohet nga mëlcia, ndërsa 20% merret nga ushqimi. Ai nuk shkrihet në gjak, kështu që transportohet aty ku është i nevojshëm, duke u lidhur me



proteinat e yndyrshme, të cilat janë dy llojesh: të mira dhe të këqija: proteinat Ldl me dendësi të ulët (të këqija) dhe proteinat Hdl me dendësi të lartë (të mira). Proteinat Ldl e dërgojnë kolesterolin në periferi, ndërsa ato Hdl e transportojnë nga periferia në mëlçi.

Ush-trime, ush-trime, ush-trime.....
Kardiologët rekomandojnë 30-60 minuta aktivitet fizik, një mesatare kjo e aktivitetit mendor ditor ose javor në punë. Dhe kujtohuni që këtu përfshihen edhe shëtitjet në lulishte, hipja-zbritja e shkallëve, etj. Pra ju këshillohet të mos rrisni kohën e vrapit, por intensitetin fizik të jetës.

Kolesteroli i tepërt mund të depërtojë në muret e brendshme të arterieve, duke shkaktuar pllakat të cilat pastaj mund të bllokojnë enën e gjakut duke shkaktuar infarkt.

Niveli i rritur i kolesterolit dhe acideve yndyrore të lirë është një faktorë tjetër rreziku për sëmundjet e zemrës. Në përgjithësi, një pakësim në vlerat e kolesterolit total çon në një ulje 2-3% të rrezikut të zhvillimit të sëmundjet e zemrës. Vlerat e HDL janë 10-20% më të larta tek femrat se tek meshkujt, e të gjitha moshave. Ato rriten nga ushtrimi fizik dhe ulen nga duhani, mbipeshja dhe diabeti.

Hipertensioni arterial (HTA)

Është faktor madhor rreziku dhe më i shpeshti për zhvillimin e sëmundjes koronare. Personat me HTA kanë një risk 5 herë më të madh për zhvillimin e SKZ (sëmundjeve koronare të zemrës). Tek njerëzit mbi 45 vjeç, HTA është faktor kryesor rreziku për zhvillimin e infarktut akut të miokardit, megjithatë rreziku për zhvillimin e tij rritet me rritjen e presionit arterial në të gjithë grupmoshat. Përveç trashëgimisë, obeziteti, jeta sendetare, stresi, konsumi i shtuar i alkoolit dhe duhanit, yndyrave dhe i kripës luajnë një rol të rëndësishëm në shkaktimin e HTA. Prandaj profilaksia për SKZ duhet të fillojë që në stadet e hershme.

Mosha

Rreziku për këtë sëmundje rritet për të dy sekset me rritjen e moshës.

rosklero-rotik në aortë mund të bëhet i dukshëm që në moshën 3 vjeç. Kështu, vazat koronare fillojnë të përfshihen në këtë proces nga moshja 20 ose 30 vjeç, prandaj është e domosdoshme të parandalohet sëmundja që në stadet e hershme.

Ush-qime të detshme për shënzemrën
Frutat dhe perimet janë parandaluesit kryesorë jo vetëm të sëmundjeve të zemrës por edhe të kancerit, shprehen kardiologët.

Gjinia

Studimet epidemiologjike kanë treguar që femrat para menopauzës preken më pak se meshkujt nga sëmundjet koronare të zemrës. Kjo shpjegohet me rolin mbrojtës mbi zemrën e hormonit femëror, estrogenit. Ky i fundit shkakton një rritje të HDL-kolesterolit dhe ulje të nivelit të LDL-kolesterolit. Vetëm 1 në

7 femra të moshës 45-64 vjeç kanë shenja të sëmundjeve koronare të zemrës. Pas moshës 64 vjeçare frekuenca rritet 1 në 3.

Duhani

Është një faktor rreziku i fortë për zhvillimin e arteriosklerozës dhe sëmundjeve koronare të zemrës. Ka një lidhje midis numrit të cigareve të pira, numrit të viteve të pirjes së duhanit dhe rrezikut të zhvillimit

të sëmundjes kardiovaskulare. Duhanhinjtë e vjetër kanë një rrezik dy herë më të madh për zhvillimin e sëmundjes kardiovaskulare dhe tri herë më të madh për vdekjen kardiakë të papritur. Efektet negative të duhanit mbi shëndetin janë: dëmtimi i endotelit, ndryshime negative të vlerave të lipideve në gjak, rritja e prirjes për trombozë, rritja e prirjes për çrregullime të ritmit të zemrës dhe ndikimi negativ mbi sëmundjet pulmonare. Por ndërprerja e duhanpirjes,

pas një viti, shkakton pakësimin e rrezikut të sëmundjes, duke u bazuar me atë të një joduhanhpirësi.

Paniku (stresi) po ashtu ndikon në sëmundjet e zemrës

Personat të cilët vuajnë nga sulmet e panikut gjithashtu janë më të prirë që të sëmurën nga sëmundjet e zemrës, shkruan në revistën "European Heart Journal". Në bazë të të dhënave, shkencëtarët kanë publikuar se personat nën moshë 50-vjeçare, të cilët kanë sulme të frikës dhe krijojnë panik, janë të rrezikuar tri herë më shumë për të zhvilluar sëmundje kardiovaskulare.

Ky përfundim është nxjerrë nga të dhënat e grumbulluar prej studimeve të cilat kanë përfshirë më shumë se 400.000 persona të të gjitha moshave, ku janë përfshirë edhe 57.000 participantë të cilët kanë pasur probleme me sulmet e panikut.

Studimi ka treguar se në grupet e personave me sulme të panikut me moshë nën 50 vjet, rreziku për të pasur sulm në zemër ka qenë 38 për qind më i lartë, ndërsa rreziku për t'u shfaqur ndonjë sëmundje tjetër e zemrës ka qenë 44 për qind më i lartë. Edhe te personat mbi 50 vjet, të cilët kanë vuajtur nga paniku, ka ekzistuar rreziku i shfaqjes së sëmundjeve kardiovaskulare, porse në shkallë më të ulët.

Bëni rregullisht ekzaminime

Presioni i lartë i gjakut dhe kolesterolit i lartë dobsojnë sistemin kardiovaskular, duke përfshirë dhe zemrën. Ekzaminimet e rregullta ju tregojnë rrugën se ku të mjekoheni.

Historiku i futbollit në Kosovë

Futbolli në Kosovë i ka fillimet e veta në fillimin e shekullit 20-të. Futbolli në Kosovë është luajtur shumë herët, por klubet e para janë formuar në vitin 1922, në Gjakovë dhe Prishtinë, e më pas janë formuar edhe klube të tjera.



Alban BILALLI

Hapat e parë

Futbolli në Kosovë i ka fillimet e veta në fillimin e shekullit 20-të. Loja e mrekullueshme që anglezët filluan ta "eksportojnë" në të gjithë botën nisi të përhapet si një epidemi kudo. Futbolli në Kosovë është luajtur shumë herët, por klubet e para janë formuar në vitin 1922, në Gjakovë dhe në Prishtinë, e më pas janë formuar edhe klube të tjera. Edhe pse ishin formuar klubet e para dhe interesimi i futbolldashësve ishte shumë i madh, garat nuk qenë zhvilluar me rregull për shkak të situatës jostabile që mbretëronte në atë kohë.

...pas Luftës së Dytë Botërore

Pas vitit 1945, futbolli në Kosovë përparoi në mënyrë të shpejtë, e bashkë me të edhe futbolli në Kosovë. Më 1946 u formua Federata e Futbollit të Kosovës, si degë e Federatës së Futbollit të Jugosllavisë. Federata e Futbollit të Jugosllavisë kishte dy liga federative ku garonin Sllovenia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Vojvodina, Kosova dhe Maqedonia. Në ligën e parë jugosllave, nga klubet e Kosovës, më së shumti, u dalluan KF "Prishtina" dhe KF "Trepça" nga Mitrovica, që ishte

Kampionët në Kosovën e lirë:

1999-2000- Prishtina;
2000-01- Prishtina;
2001-02- Besiana;
2002-03- Drita;
2003-04- Prishtinë;
2004-05- Besa (Pejë);
2005-06- Besa;
2006-07- Besa;
2007-08- Prishtina.

një vit anëtare e ligës së parë. Kurse në ligën e dytë jugosllave, nga Kosova, kishte vazhdimisht 3-4 skuadra që e përfaqësonin denjësisht atë.

... pas shpërbërjes së Jugosllavisë

Shpërbërja e Jugosllavisë në vitin 1991 u reflektua edhe në sport. Për të zhvilluar garat në futboll ishte shumë vështirë, e sidomos në Kosovë. Kjo bëri që në gusht të viti 1991, klubi më mirë i Kosovës, Prishtina që garonte në Ligën e parë të Jugosllavisë, të braktiste Ligën profesionale të Jugosllavisë, sepse nuk kishte më garanci për sigurinë, as të lojtarëve, as të zyrtarëve të klubit, e as të simpatizuesve që ishin të shumtë. Push-teti i Millosheviqit suprimoi të gjitha klubet dhe i largoi nga fushat e veta të gjithë sportistët e Kosovës.

Pas këtyre ngjarjeve, futbolldashësit e Kosovës nuk qëndruan duarkryq, por treguan qartë se nuk mund të jetojnë pa futboll dhe formuan Federatën e Futbollit të Kosovës, të pavarur nga Jugosllavia, me të gjitha organet e saj: kryetarin, bordin prej 12 anëtarëve nga 7 qendrat rajonale, komisionet, shoqatat, etj.

Më 13 shtator 1991 u zhvillua ndeshja e parë në stadiumin e Flamurtarit në Prishtinë, që shënoi fillimin e kampionatit të parë të pavarur të Kosovës. Liga e parë e Kosovës numëronte 20 skuadra, ndërsa ligat e tjera varësisht nga regjionet, por ndeshjet luheshin nëpër fusha të improvizuara "livadhe", kurse në stadiumet e futbollit të Kosovës luanin vetëm serbët.

Përkundër maltretimeve, burgosjeve, e rrahjeve nga pushtuesit serb, futbolli në Kosovë mbijetoi dhe u luajt deri në janar të vitit 1998, kur u intensifikua lufta e armatosur ndërmjet UÇK-së dhe forcave ushtarake e paramilitare serbe.

Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe (1991-1998), futbolli luhej me rregulla të FIFA-s dhe UEFA-s.

...pas çlirimit të Kosovës

Menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë më 1991, u riorganizua FFK-ja. Konstituohet Kuvendi, miratohet sta-

Kampionët e Kosovës në periudhën 1991-98:

1991-92- Prishtina;
1992-93- Trepça;
1993-94- Dukagjini (Klina);
1994-95- Liria (Prizren);
1995-96- Prishtina;
1996-97- Prishtina.
1997-98 kampionati është ndërprerë për shkak të luftës.







tuti, konfirmohen klubet pjesëmarrëse, caktohen komisionet, shoqatat etj. Liga e parë numëronte 18 skuadra. Liga e dytë - dy grupe me nga 14 skuadra. Ishte formuar edhe liga e tretë nëpër regjione. Tani futbolli luhej nëpër stadione, edhe pse infrastruktura nuk ishte në gjendje të mirë. Klubi i futbollit nga Besiana, KF "Besiana", zhvilloi ndeshjen e parë ndërkombëtare. Ishte një ndeshje miqësore me klubin nga Turqia, KF "Genqerbigli".

Prej edicionit 2006-07 Kosova ka superligën me 16 skuadra, Ligën e parë me 14 skuadra, Ligën e dytë - dy grupe me nga 12 skuadra, dhe ligën e tretë dy grupe nga 10 skuadra, pastaj Ligat e juniorëve dhe të gjithave grupmoshave.

...në Kosovën e pavarur

Më 17 shkurt Kosova shpalli pavarësinë. Futbolli nuk pësoi asnjë ndryshim. Garat vazhduan me temp dhe rregulla të njëjta. Tani krerët e FFK-s, kanë intensifikuar edhe më shumë veprimet e tyre për t'u pranuar sa më shpejt në Federatat ndërkombëtare të Futbollit, si në FIFA dhe në UEFA.

Në fund të viti 2008, FFK-ja dërgoi një kërkesë në adresë të FIFA-s për t'i lejuar Kosovës të zhvillojë ndeshje miqësore. Më 19-20 dhjetor 2008, Komiteti Ekzekutiv i FIFA-s në mbledhjen e saj, kërkesën e saj ia transferoi UEFA-s e cila pritet që kërkesën e FFK-s ta shqyrtojë më 30 janar.

										 						
Autor: Endriti	SHTET YNE	MBIEMËR CILËSOR	VEPËR E JOSIP RELES	"L" në mes të dy "E"	"SOMALIA"	GJENDJE E RËNDË E NJERIUT NË ÇASTET E FUNDIT TË JETËS	AKTORI I FAMSHËM FRANCEZ ALEN	CEJLONI	APPALACHIA, AUTONOMQ. ZONE		DËM, PRISHJE; HUMBJE (krah.)	EMRI I KOMANDANT "Sandokani" (UÇK)	HAITI, ALASKA	EMËR MASHKULLI MYSLIMAN (shq.)	KORNIZË	
RILINDJA (fr.)										DËSHMORI PAJAZITI I FSHEHTË, I PAVËNËRE, QË NUK DUKET						
KAPITULLI I FUNDIT OSE PJESA PËRMBYLLËSE NË NJË VEPËR LETRARE								SHTET FEDERAL NË SHBA LLOGORE								
GATËSË E JONA TRADICIONALE							FSHATI I LINDJES I KOMANDANT "Kumanova" (UÇK) PËRIA, AJKA						ROTTERDAM, MYNIH ZANORE			
URANIUM, TANTAL						KOMPOZITORI PRESHEVA QË ËSHTË PËRTEJ MASE			FUTBOLLISTI BRAZILIAN RODRIGO (Roma) KËZHINË PRANË XHAMISË						KRYEQYTETI I SHTETIT TONË	
BETIM, PREMTIM SOLEMN			SOLISTJA FARA BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA (sh.pashq.)					FUTBOLLISTI FRANCEZ ANRI NYNBERG					UNIVERSITETI I PRISHTINËS DEM, KA			
							NIKEL, METËR, AZOT IPSVICH					NEVADA, TENESI SHALQI			RISANI NDËRTIM I GJATË E I NGUSHTË ME TULLA RRETH SHTËPISË	
FUTBOLLISTI YNË LËLA (shq.) ZANORE		SPORT UJI (shq.) EMËR MASHKULLI ANGLEZ						SHTRESA, FISHI NJËRI NGA VELLEZËRIT FRASHËRI					SOLISTJA ANGLEZE UAJNHAUS INDUSTRIA KROATE E NAFTAËS			
DËSHMORI YNË ILAZ							SHEGË AKTORI HOLLIVUDIAN ... JUDD (shqip.)			AKTORI YNË KABASHI AKTORJA E VJETËR HOLLIVUDIANE MORENO						
EMRI I KOMANDANTIT LEGJENDAR TË UÇK-së						REGJISORI I SHQUAR XHEJMS SHKRONJA e 13-të, 16-të dhe 9-të							RUANDA, TAJLANDA ISH FUTBOLLISTI GJERMAN UVE			
ERBIUM			AI ME TË CILIN QUHEMI TEFIK OSMANI					VOZË E MADHE DRURI SHKRONJA TË NJËJTA							ZANORE OLIVER DAKUR	
NGJITËS I XHAMAVE						KRYEQYTETI I PERUSË VLORA							BANOR I AONISË ZANORE			
								NJË LLOJ GJARPRI								

GJELLËTORE - QEBAPTORE



PRIZRENI



“PRIZRENI”

Tel.: +377 (0)44 195 583

Pronar: Murat Fejziu, Rr. Gazmend Zajmi, nr. 81
Te Xhambazt, 10000 Prishtinë

Hapësirë për reklamim në revistë!

1/1
100€

1/2
50€

1/4
25€

Në vlerat e çmimeve nuk është përfshirë TVSH-ja

Studio për prodhimin e kuzhinave

keZZA



5 Vjet Garancion

kkeza@hotmail.com

mob. +377 (0)44 141 909

tel & fax. +381 (0)38 243 863

Prodhimet tona mund të blihen me kredi përmes **Raiffeisen Bank**

Made in Kosova

PAQJA

REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË



NJË VIT PAVARËSI

Gëzim QERIMI
Adem Jashari -
sinonim i shtetit të pavarur

Fadil MALOKU
Globalizmi çështja e
sovrantitetit të shtetit dhe Kosova

Mirsad KUTELI
Kosova: e tashmja dhe e ardhmja

Arben MUHAMETI
Shtetet që e kanë njohur
Republikën e Kosovës

Osman D. GASHI
Qytetarët:

Kemi pritur më shumë...

Floriqe ADEMI
Mitrovica mbetet
simbol i ndarjes

Osmon BOJAXHIU
Edhe goranët i janë
gëzuar pavarësisë së Kosovës

Hekuran AVDYLI
Studentët: Shteti i pavarur
nuk i ka sjellë ndryshimet e pritura

Genta HOXHA
Kultura në një vit të pavarësisë



Në njëvjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës

Adem Jashari - sinonim i shtetit të pavarur



Gëzim QERIMI

1 7 shkurt 2008 – 17 shkurt 2009

Trojeve etnike shqiptare të ndodhura në një rajon gjeostrategjik të rëndësishëm dhe me fqinjë që kanë lak-

muar gjithmonë trojet e saj, historikisht i është dashur që mbijetesën ta paguajë jo vetëm me mund e sakrificat të panumërta, por edhe me shumë gjak të bijve e bijave të saj. Burrat e mëdhenj të historisë së lashtë e të re të kombit shqiptar, nuk i kanë munguar asnjëherë popullit shqiptar, jeta dhe vepra e të cilëve është vënë pa kursim në shërbim të vlerave të mirëfillta njerëzore, të lirisë së tij, të zhvillimit e përparimit. Ata burra të mençur, dijetarë të mëdhenj, trima e komandantë, sot më 17 Shkurt 2009, rrezatojnë frymëzim dhe krenari për çdo shqiptar kudo që ndodhet.

II

Kosova shpalli pavarësinë duke i dhënë fund periudhës së tranzicionit dhe duke mbyllur kështu kapitullin e përpjekjeve shekullore, e sakrificave brez pas brezi dhe pritjes së gjatë së këtij populli.

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës kurorëzoi përpjekjet e vazhdueshme të popullit të saj për konfirmimin e identitetit të tyre kombëtar. Kjo ditë, e cilësuar si momenti më solemn i kombit shqiptar, paraqet sinonimin e të gjithë


kontributit dhe sakrificave shekullore të bëra për arritjen e një ideali të tillë.

Përpjekjet u kurorëzuan, ndonëse jo edhe në atë masë sa do të dëshironim, mirëpo mbi të gjitha pavarësia erdhi. Tani mbajmë mbi vete epitetin “brezi i parë i Pavarësisë”, prandaj të shkojmë përpara drejt shtigjeve të reja të përparimit dhe avancimit të gjithmbarshëm shoqëror, me të gjitha specifikat e domosdoshme të një shoqërie të mirëfilltë mbi baza të kultivimit të vlerave të larta

dhe pavarësi. Ajo, gjithashtu, paraqet shtresën e cila është flamurtare në aspektin e kontributit të dhënë për arrijtet e idealeve fisnike të këtij populli, dhe, po ashtu, shtresën e cila nënkupton bazën, përkatësisht, pikënisjen për çdo ndryshim pozitiv e përparimtar në shoqërinë tonë dhe të çdo vendi tjetër.

III

Sot, më 17 shkurt 2009, përpos që shënojmë një vjetorin e shtetit më të ri të globit, ne si studentë sot shënojmë edhe ngjarjet historike të viteve 1968,1981,1997, ngjarje të cilat padyshim që i përshpejtuan proceset të cilat e dërguan vendin drejt Pavarësisimit. Jemi të vetëdijshëm për jehonën e këtyre protestave. Dhe pikërisht këto ngjarje tregojnë më së miri për rolin e studentëve gjatë historisë, por ky rol duhet të tregohet edhe në shtet-ndërtimin e Kosovës. Studentët, si pjesa më e rëndësishme e shoqërisë së një vendi, janë karakterizuar përherë për kontributin e tyre si bartës të proceseve për ndryshime pozitive e integruese, me fjalë tjera kanë ndryshuar rrjedhën e fatit të çdo shoqërie. Duke u nisur nga ky fakt, vlen të



njerëzore, morale dhe kombëtare.

Shteti i porsalindur mban epitetin “I RI” edhe në aspektin e përbindjes së lartë të të rinjve, e cila karakterizon popullin e Kosovës. Pra, rinia si pjesa më vitale e shoqërisë së një shteti, paraqet edhe njërin nga resurset kryesore dhe më të vlefshme të Republikës së Kosovës, resurs i cili gjatë shtetgimit tonë historik ka qenë sinonim i qëndrësës së përgjithshme të vendit për liri

theksohet gjithashtu kontributi i studentëve kosovarë për luftën çlirimtare të popullit tonë. Studentët u bënë një nga shtyllat kryesore dhe shtresa e cila më së shumti iu përgjigj thirrjes së atdheut për mobilizim në radhët e UÇK-së, të udhëhequr nga komandanti legjendar Adem Jashari, i cili u bë sinonim i Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, me moton “Bac u kry” .

IV

I gjithë rrugëtimi ynë, që nga ato ditë e deri më sot, është bërë së bashku me miqtë tanë ndërkombëtarë, me në krye SHBA-të dhe me BE-në.

Dhe sot, më 17 shkurt 2009, së bashku me gjithë dashamirët e popullit shqiptar, shënojmë ditën më të rëndësishme të popullit të Kosovës.

Duke ju përkushtuar të ardhmes, ne, si gjenerata e pavarësisë, në periudhën e ardhshme vlerësojmë që rëndësi duhet t'u kushtohet përmirësimeve ekonomike, përkatësisht investimeve të huaja në Kosovë, përmirësimit të standardeve të jetesës së qytetarëve të Kosovës, hapjes së vendeve të lira të punës për kuadrot e rinj që dalin nga ky Universitet si dhe nga vatra të tjera të dijes, por edhe të qytetarëve të tjerë. Po ashtu, çështja e Mitrovicës dhe e sigurisë së qytetarëve, problemet sociale e shumë probleme të tjera që e preokupojnë këtë shoqëri duhet të rregullohen. Neve si studentë na mbetet që të punojmë shumë në këtë aspekt dhe të jemi mbështetës të fuqishëm të institucioneve tona qeveritare, sepse pikësynimi i të gjithë sakrificave tona ishte që të kishim institucionet tona të lira dhe sovraane. Rinia e Kosovës tanimë është e hapur që të bashkëpunojë me të gjithë ata që duan të ndihmojnë dhe të përmirësojnë performancën e Republikës së Kosovës. Vizioni ynë për të ardhmen është që studentët e Universitetit të Prishtinës të ketë kushte sa më të mira për studim dhe të jetë konkurrent në tregun e punës. Shpresoj që kontributi i studentëve tani do të mund të ndryshojë për të mirë dhe për progresin e vazhdueshëm të shtetit të Kosovës, si në aspektin arsimor, intelektual e integruar, në strukturat ndërkombëtare.

V

Sinonim i kësaj dite historike, për mbarë popullin shqiptar kudo që gjendet, është Adem Jashari. Dita e Pavarësisë së vendit tonë, më 17 shkurt 2008, që na sjell ndërmend krismat e armëve e të fishekzjarrëve, urimet e lotët e gëzimit të shqiptarëve dhe mesazhin kuptimplotë "Bacë u kry", është dita më e shënuar e Popullit të Kosovës. Sinonim i kësaj date historike, pa dyshim, është edhe shoku i tij i armëve, kryeministri i sotëm i Kosovës, Hashim Thaçi. Kështu ka qenë e kështu do të mbesë: brezat përcjellin përjetësinë. Ndërsa Sinonim i Pavarësisë së Kosovës mbetet Adem Jashari. ■

Pak globalizëm e pak lokalizëm

Globalizmi, çështja e sovranitetit të shtetit dhe Kosova

Në Kosovë, meqë është ende aktuale çështja e pretendimit të bërjes (jo e ri definimit) së shtetit, përgjithësisht në vija të trasha, do të mund të identifikoheshin dy specifika cilësore që rrallëkund apo askund nuk mund t'i hasësh: specifikën e ndërtimit të infrastrukturës elementare demokratike dhe atë të realizimit të synimit për të ndërtuar këtë infrastrukturë elementare me mekanizmin e institucionit të sipërpërmendur.

Prof. dr. Fadil MALOKU, Sociolog

Interes kombëtar i një vendi nuk është mbyllja dhe izolimi, por përkundrazi hapja dhe demokratizimi i brendshëm i raporteve shoqërore. Për kosovarët, të cilët për dallim prej të gjithë të tjerëve, natyra e trazimeve të brendshme, kur është në pyetje ndërtimi i kapaciteteve të reja të institucionit shtet-komb, ka gjithandej specifika të cilat nuk mund t'i hasësh në asnjë model zhvillimor të procesit të ndërtimit të institucionit shtet - komb në botë.

Në Kosovë, meqë është ende aktuale çështja e pretendimit të bërjes (jo e ri definimit) së shtetit, përgjithësisht në vija të trasha, do të mund të identifikoheshin dy specifika cilësore që rrallëkund apo askund nuk mund t'i hasësh: specifikën e ndërtimit të infrastrukturës elementare demokratike dhe atë të realizimit të synimit për të ndërtuar këtë infrastrukturë elementare me mekanizmin e institucionit të sipërpërmendur (i cili për të tjerët ka filluar të pësojë ndryshime dhe modifikime të theksuara në formë dhe përmbajtje nga vetë shkaku i proceseve të reja të globalizimit).

Nëse i adresohemi synimit të kamotshëm të kosovarëve, për ta ndërtuar këtë mekanizëm identifikues edhe për vetë identitetin e ri kombëtar, fitohet përshypja se ky proces është identifikuar jo si nevojë e komoditetit, por e ekzistencës së qytetarëve të saj, gjatë tërë shekullit të kaluar në kushtet dhe rrethanat e reja të një procesi tashmë të afirmuar si globalizëm. Atëherë, padyshim, lypset të kuptohen trendet e reja zhvillimore

përreth. Kjo mënyrë e qasjes duhet involvuar edhe për shkak të vonësës së theksuar historike që kemi pësuar jo për fajin tonë.

Është mirë, pra, që më në fund ka filluar të zgjidhet ky lëmsh rreth Kosovës dhe për Kosovën. Por a është kështu, do të pyeste ciniku?

Duhet theksuar parimisht që vlerat "klasike" (siç i kanë identifikuar shumica e sociologëve të sotëm), siç janë ato që kanë të bëjnë me: interesin kombëtar, integritetin territorial, e pastaj me sovranitetin kombëtar e sidomos tash së fundi me sistemin e sigurisë kolektive, në botën perëndimore nuk e gëzojnë më edhe gjithaq atë shkëlqimin apo rëndësinë që e kishin përpara, p.sh. në shek XIX-të, kur edhe u afirmuan si vlera substanciale për rregullimin e raporteve mes qytetarëve dhe shoqërive.

Në aulat intelektuale, politike e sidomos ato kulturore, në botë, sot, janë duke u zhvilluar debate të sofistikuara rreth këtyre formave dhe përmbajtjeve të reja vlerore. Dilema kryesore tani për tani mbahet ajo që ka të bëjë me ambiguitetin apo interpretimin dualist që e fuqizojnë diplomatët dhe ekspertët e lëmenjve të ndryshëm, në mënyrë që procesi i (ri)pajisjes, si të themi me licencën e mekanizmit të quajtur shtet, të bëhet në qetësi dhe pa zhurmë të madhe në opinionin e gjerë. Natyrisht, një numër i madh sociologësh të njohur ende konsistojnë në qëndrimet arbitrare, se ende nuk ka arritur momenti i (ri)pajisjes apo zëvendësimit (apo edhe në variantin më të keq: reduktimit të menjëhershëm të rolit të institucionit të shtetit në të ardhmen!) të këtij diskursi



me ndonjë pseudo institucion krejtësisht tjetër. Për shumicën e tyre (si A. Giddens, Fridman, Beck, etj) institucioni i shtetit (jo edhe gjithaq ai i kuptimit modern, por ai klasik) është ende një mekanizëm i qëndrueshëm rregullativ i jetës së njerëzve në mbarë globin.

Në Evropën e modelit të Unionit, pra në qarqet eurokratike, ekziston një projekt (në formë diskursi teknokrat) ende i paafirmuar sa duhet për shumicën e vendeve të tranzicionit, se po qe se qytetarëve të këtyre vendeve u ofrohen më shumë të drejta qytetare (eufemizmi për të drejtat e njeriut) dhe më shumë paqe e qetësi kolektive, atëherë padyshim që çështja e sovranitetit të shteteve do të mund të marginalizohet me mekanizmin e sigurisë kolektive rajonale.

Në anën tjetër, është po ashtu e vërtetë që kapitalizmi i shekullit, i identifikuar si globalizëm, është duke instaluar një tip të ri apo një formacion të ri të shtetëzimit si mekanizëm më të drejtpërdrejtë që duhet të ushtrojë pikësëpari menaxhimin me të mirat dhe begatitë e një vendi. Ky tip, apo thënë më ndryshe ky model, nën ndikimin e Unioneve të ndryshme monetare globale, fenomenit CNN-it, KTN-ëve, Internetit dhe OJQ-ëve, për shumicën e sociologëve të sotëm, deri tani nuk ka dhënë duke dhënë rezultatet e pritura.

Ai është duke bankrotuar skajshmërisht si ide! Të përmendim vetëm rastin e refuzimit të francezëve për Kushtetutën e re Evropiane!

Sovraniteti edhe sot e kësaj dite ka mbetur tërheqës për shumicën dominuese të vendeve të zhvilluara

Në rajonin e Ballkanit perëndimor, ku uria për identitetin shtetëror ende është e gjallë dhe një paranojë e llojit të vet, edhe për faktin se për të janë zhvilluar madje edhe luftëra gjenocidiale (shembulli i Bosnjës dhe i Kosovës), çështja e (ri)pajisjes apo zëvendësimit të rolit të shtetit është e paimagjinueshme, e hershme dhe sështë në përputhje me kohën e zhvillimit dhe të rrumbullakimit të synimeve kolektive të kombeve. Ithtarët e këtij koncepti në perëndim, sot, bëjnë ekspertiza dhe analiza të thukëta, duke fuqizuar mendimin akademik se: çështja e (ri)pajisjes apo reduktimi të sovranitetit shtetëror nuk ka qenë dhe nuk është diçka e re.

Thënë më thjesht, sovraniteti edhe sot e kësaj dite ka mbetur tërheqës për shumicën dominuese të vendeve të zhvilluara dhe atyreve që janë në zhvillim, e të mos flasim për ato që janë në procesin

e tranzicionit dhe të procesit të shtetformimit, siç është rasti i Kosovës, ku interesimi mobilizues i qytetarëve të saj, lidhur me dëshirën dhe pasionin e tyre shekullor për të pasur një shtet të vetin, e ka burimin e vet shpjegues dhe shumë identik me popujt e tjerë përreth.

Pra, ideja e të poseduarit të sovranitetit të plotë të shtetit të ri të Kosovës, edhe pse shikuar me dioptrinë e një eksperti të marrëdhënieve ndërkombëtare nuk e ka peshën e mëtejme të një njohje formale ndërkombëtare në akusherin e OKB-s, ku edhe (de)legjitimohen sovranitetit e shteteve, përmes të cilës pastaj thithja e begative materiale dhe atyre financiare bëhet më e lehtë dhe më durueshme, ajo prapë se prapë e ka madhësinë e vet identifikuese. E kjo madhështi nuk është edhe gjithaq ideale, ashtu siç është projektuar zakonisht në kokat e masave të gjera popullore, por para se gjithash pragmatike, ngaqë institucionet dhe qytetarët e mbarë rruzullit tokësor, transaksionet e tyre të ndryshme akoma i ushtrojnë pikërisht përmes këtij mekanizmi, edhe pse ai, herë pas herë, gjatë qenësimit të vet të gjertanishëm historik, ka ditur të gjenë autoritet dhe arbitraritet të pakontestueshëm dhe një lloj egalitarizmi të diskutueshëm.

Sovranitet apo kontroll shtetëror?

Po ashtu, një ndër provokimet më të rënda që i është bërë ndonjëherë diskursit të sovranitetit, padyshim, që ka të bëjë me të drejtat universale të njeriut në gjithë globin tokësor. Përmes këtij diskursi, sot mekanizmat ndërkombëtare (OKB) kanë të drejtën e intervenimit moralo-politik (Rezolutat e aprovuara), por jo gjithkund dhe gjithherë edhe të drejtën e intervenimit ushtarak, siç ishte rasti i Kosovës. Ndryshimet e fundit marramendëse tekniko-teknologjike, në një mënyrë e kanë thyer, si të themi, atë barrierën e shteteve sovraane. Ngaqë, ndikimi i medieve globale (rasti i gjiganti të quajtur CNN-n dhe Alxhazira-s) kanë bërë që të mos mbetet më asgjë nën mëshirën e pushtetmbajtësve lokal. Sot, pra, si interes kombëtar i një vendi nuk është mbyllja dhe izolimi, por përkundrazi hapja dhe demokratizimi i brendshëm i raporteve shoqërore, pra ndërtimi i një diskursi më të përsosur të qeverisjes dhe menaxhimit me qytetarët e cilitdo vend, ku institucionet legale të dala nga zgjedhjet funksionojnë në mënyrë të admiruar.

Roli i shteti të ardhshëm me siguri që do të anojë më tepër nga roli i menaxhmentit, ashtu siç ka filluar aktualisht në perëndim, por pyetja se si do të mund të afirmohet çështja e sovranitetit të cunuar ("autonomi substanciale") apo atij të reduktuar ("pavarësia e kushtëzuar") në kushtet dhe rrethanat e reja të procesit të globalizimit, siç është rasti me Kosovën, mbetet për t'u parë. Ngaqë, sot për sot, është një çështje që ende nuk ka arritur të ketë ndonjë përgjigje të pranueshme, as nga diskursi politik, e as nga shkencor.

S ë

këndejsmi, çështja e reduktimit të sovranitetit duket që është ende në fazën eksperimentale dhe eldorado e vërtetë, ndërsa ambient më të përshtatshëm se Ballkani për këtë veprim Prokrustian, duket që akoma nuk ekziston.

Pra, roli i shtetit në kushtet dhe rrethanat e reja është një domosdoshmëri e llojit të vet, ngaqë vendet e tranzicionit ende nuk e kanë perfeksionuar sa duhet zejen e menaxhimit me vetë veten. Institucioni i shtetit, gjithashtu, është duke përjetuar një krizë do thosha tredimensionale, sidomos kur janë në pyetje sferat e kompetencave të tij si institucion i fortë në menaxhimin e të mirave materiale të qytetarëve të vet.

Argumenti i parë i kësaj krize, është duke u manifestuar në sferën e ekonomisë dhe të politikës, ku ai, një pas një, është duke pësuar humbje në kuptimin e privimit nga disa ingerenca që i ushtronte më herët. Shumica e sociologëve të sotëm mendojnë se KTN (Kompanitë Trans Nacionale) janë ato që, në një farë mënyrë, kanë tendencë t'i zëvendësojnë në këto sfera disa nga kompetencat e shtetit klasik. Kësaj tendence thuhet që as SHBA-t, nuk po mund t'i ikin, ku me së miri kjo u vërejt me rastin e pushtimit të Irakut. Argumenti i dytë për krizën e dukshme të institucionit të shtetit, tani dhe në të ardhmen, thuhet që është padyshim ekzistimi i një vullneti dhe një dëshirë globale politike, për ta ndërnuar procesin e zhvillimit të kapitalizmit. Duke mos hyrë në ndonjë analizë më të thukët, vlen të përmendim,

bie fjala, disponimin e elitave pushtetmbajtëse të botës perëndimore, sidomos asaj amerikane, angleze, spanjolle, italiane, etj. P.sh. Në një takim të "Komisionit Trelateral", D. Rockefeller, Kryetari i këtij asociacioni, ka theksuar se: "Pushteti mbi nacional i bankierëve dhe i elitës intelektuale ndërkombëtare, duhet të qëndrojë mbi të drejtën e kombeve për vetëvendosje" (!?). G. Soros, njëri ndër zëdhënësit më të fuqishëm të globalizmit politik, procesin e kontrollit të tregut global e sheh vetëm në ndërtimin e institucioneve mbi nacionale.

Argumenti i tretë, i krizës së ashtuquajtur shtetërore, ka të bëjë me humbjen e cilësisë së rolit të tij në formimin e ashtuquajturit ethos kombëtar, që sipas Giddens është pasojë e rritjes së "vetëdijes kozmopolite". Me sa mund të hetohet, shumica e sociologëve janë të pajtimit se roli i shtetit në rrethanat e reja të globalizmit, domosdoshmërisht, do të reduktohet, përkatësisht do të zbehet sovraniteti i tij, mirëpo ai asnjëherë nuk do të mund të zëvendësohet tërësisht me ndonjë mekanizëm tjetër. Dilema jonë është se Kosovën që e pret sfida e definimit të statusit politik, është apo nuk është në rrugëtimin e procesit të lartpërmen- d u r a ? Përgjigjen le ta japin poli- tikanët aktualë, gjatë këtij mandati të qeverisjes historike. ■



Tashmë, kur gjendemi në këto momente historike, kur na përkrah e tërë bota demokratike, duhet të jemi të lumtur dhe syçelë, ta ruajmë dhe forcojmë këtë lidhje, në mënyrë që ta avancojmë statusin e shqiptarëve kudo që ndodhen

Mirsad KUTELI

Kosova ka kapërcyer nëpër sfida të mëdha që kanë qenë shumë tragjike dhe kanë lënë pasoja të jashtëzakonshme, veçanërisht për popullatën shqiptare. Vetëm gjatë shekullit të fundit, Kosova ka kaluar nëpër tri luftëra. Dy luftëra botërore dhe ajo e fundit, Lufta e Kosovës, që njëkohësisht edhe i dha fund luftërave në ish-Jugosllavi, që u zhvilluan gjatë dekadës së fundit të mileniumit që e lamë pas. Pas luftës së dytë botërore, në sytë e disa njerëzve, edhe të shqiptarëve në Kosovë, u duk se gëzonin të drejta më të mëdha dhe kishin një gjendje më të mirë ekonomike e sociale, por mbizotëronte sistemi totalitar dhe Kosova, megjithatë, ishte e denigruar për shkak të statusit të saj. Ajo kishte statusin e krahinës në kuadër të RSFJ-së, për dallim prej republikave të tjera që e përbënin këtë federatë.

Për vite të tëra Serbia kishte ushtruar gjenocid, krim kundër njerëzimit, një terror shtetëror ndaj popullatës së Kosovës, të cilën e kishte kolonizuar shumë kohë më parë.

E tashmja

Përderisa e kaluara e vendit tonë tashmë është e ditur, ngase të gjithë ne, në një mënyrë apo në një tjetër, e kemi përjetuar, e tashmja duket mjaft konfuze. Në Kosovë, si shteti më i ri në botë, përpos institucioneve të saj, veprojnë edhe faktorë të tjerë ndërkombëtarë, që kanë role mjaft të rëndësishme në këtë periudhë transitore, deri në aderimin e saj në të gjithë organizmat relevantë e të domosdoshëm ndërkombëtarë, siç janë BE, NATO, OKB, FMN, BB, etj. Në këtë fazë, kur UNMIK-u është akoma prezent, por në përmblyllje të misionit të vet, ai po i bart një pjesë të kompeten-

Kosova: e tashmja

cave tek institucionet vendore, ndërsa një pjesë po i bart tek EULEX-i. Për këtë të fundit, është folur dhe është përfolur shumë. Po ashtu, edhe Zyra Civile Ndërkombëtare ka funksione të caktuara, të cilat janë të përcaktuara edhe në Pakon e Ahtisaarit.

Çka është në të vërtetë EULEX-i?

Termi EULEX është një fjalë kompozite. EU – 'European Union' (Bashkimi Evropian) dhe fjala me origjinë nga latinishtja LEX, që në shqip d.m.th ligj. Pra termi EULEX mund të zërthehet si Ligji i Bashkimit Evropian.

Pas shumë debateve në nivele të ndryshme më të larta, EULEX-i tashmë është vendosur në Kosovë. Mirëpo, shqetësimi i popullit të Kosovës është se sa do të jetë funksional dhe sa do të zgjasë ky mision, kur kihet parasysh fakti se ka shumë për të bërë në këtë fushë.

Men- do j se duhet të kemi një dozë optimizmi në këtë drejtim. Duke pasur p a r a - sysh se shtetet



kyçe të BE-kanë mjaft bënë të mision, do të jenë më të përkushtuara për t'i avancuar proceset. Duhet ta kuptojmë sinjerisht se Kosova ka të ardhme evropiane, andaj, Evropa nuk e dëshiron një Kosovë të pasigurt në gjirin e saj. Për këtë Evropa do të përqendrohet shumë që Kosova të jetë një vend me stabilitet ekonomik, social, etj.

Tani, kur bota po kalon nëpër një krizë globale ekonomike, kjo gjë padyshim se reflektohet edhe në Kosovë, që është një vend shumë i varfër dhe me një ekonomi të pazhvilluar. Gjendja ekono-



mike në Kosovë, mbase, nuk është vetëm si pasojë e të huajve që pas luftës nuk investuan në fabrika e prodhim, por vetëm në ndihma humanitare. Mirëpo, një faj të madh mban edhe Agjencioni Kosovar për Mirëbesim (AKM), që në mënyrë jo të drejtë ka bërë privatizimin e shumë pronave shoqërore dhe që, më pas, nuk është përkujdesur në lidhje me implementimin e kushteve të parapara për një ndërmarrje të caktuar. Kompanitë private, jo vetëm që kanë punësuar një numër shumë të vogël punëtorësh, por atë e kanë bërë mbi baza të ngushta familjare. Nuk duhet lënë pa përmendur edhe fakti se ekonomia e Kosovës ka qenë e shkatërruar gjatë luftës dhe para luftës.

Tani kur institucionet e reja të Republikës së Kosovës janë duke u konsoliduar, problem kyç akoma mbetet papunësia, që shënon nivelin më të lartë në rajon. Kjo çështje i vështirëson dhe proceset integruese, për shkak se mund të prodhojë dukuri negative, kur kihet parasysh se vendi ynë ka një përqindje të lartë që i përket grup-moshave të reja. Andaj, mosangazhimi i këtij potenciali të madh të pashfrytëzuar në punë dhe veprimtari pozitive që do t'i shërbenin vendit, mund të kthehet në kundëreffekt, që do të ketë konsekuenca të këqija.

E ardhmja

ja dhe e ardhmja



Pas një periudhe relative paqeje, vendet e Ballkanit Perëndimor e kthyen shikimin nga perëndimi. Mirëpo, kjo është edhe në interes të Evropës perëndimore, në mënyrë që të mos ketë jostabilitet në këtë rajon, që do të reflektohej, më pas, edhe më gjerë. Në këtë drejtim, vendet e këtij rajoni janë në rrugën e tyre drejt Bashkimit Evropian. Kroacia dhe Maqedonia janë vende kandidatë, ndërsa Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia, si dhe Kosova janë kandidatë potenciale.

Me mbarimin e luftës së ftohtë, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor pësuan transformime të mëdha. Të gjitha republikat e ish-Jugosllavisë u bënë shtete të pavarura. Po ashtu, edhe Kosova, që dikur kishte statusin e krahinës, u pavarësua.

Si konkluzion i kësaj mund të thuhet se Serbia shkaktoi humbje të mëdha të jetëve njerëzore në këto hapësira, por për pasojë pati dhe humbjen e tërë këtyre luftërave të shkaktuara nga hegjemonia serbo-sllave, duke filluar nga Sllovenia dhe duke përfunduar në Kosovë.

Pritet që Forcat e Sigurisë së Kosovës, në një të ardhme të afërt, të prahen me automatizëm në NATO. Kjo për faktin se veçanërisht SHBA-të janë të interesuara, që në start, që kjo forcë të ngrihet dhe të konsolidohet konform standardeve të NATO-s.

Nga ana tjetër, Kosovën, që tashmë e kanë njohur si shtet sovran dhe të pa-

varur 53 shtete të botës, pritet ta njohin edhe shtete të tjera, për arsye se në një formë apo në një tjetër, edhe ato shtete që nuk e kanë njohur formalisht Republikën e Kosovës, kanë shërbyer ose kanë asistuar në Kosovë me pjesëmarrjen e tyre si në KFOR, ashtu edhe në UNMIK.

Prandaj, mbetet vetëm në dorën tonë që të angazhohemi më tepër për mirëqenien tonë dhe për ruajtjen e relacioneve të mira me ndërkombëtarët. Ne kemi nevojë akoma, për faktin se për anëtarësimin e Kosovës në OKB, së pari duhen ditur konditat e definuara. Kosova duhet të sigurojë njohje nga 2/3 e shteteve anëtare të OKB-së. Më pas, këto shtete, nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së ia paraqesin KS të OKB-së kërkesën e Kosovës për anëtarësim në OKB.

Kujtoj se ne si popull i lashtë, gjatë tërë historisë, nuk e kemi pasur vendin meritore, por jemi sakrifikuar gjithmonë në dobi të tjerëve. Mendoj se kjo ka ndodhur për shkak se politikanët shqiptarë, gjatë shekujve, nuk ditën të rreshtoheshin përkrah forcave progresive. Kur dihet se ne, si popull i vogël, nuk do të mund që ta krijojmë

atë shtetin meritore shqiptar vetëm me forcat tona. Andaj, mosrreshtimi me kohë i shqiptarëve përkrah fuqive të mëdha perëndimore, si SHBA-të dhe Evropa Perëndimore, jo vetëm se na sollën hendikep, por edhe copëtimin e tokave shqiptare, kolonizimin e trojeve tona dhe dëbimin nga atdheu.

Tashmë, kur gjendemi në këto momente historike, kur na përkrah e tërë bota demokratike, duhet të jemi të lumtur dhe syçelë, ta ruajmë dhe forcojmë këtë lidhje, në mënyrë që ta avancojmë statusin e shqiptarëve kudo që ndodhen.

E ardhmja do të jetë shumë e mirë për shqiptarët, nëse fillojmë të mendojmë për konsolidimin e shtetit, e jo të mendojmë vetëm me logjikë individualiste. Individualiteti dhe pasurimi i politikanëve në mënyrë të pandershme, duke shikuar vetëm interesat e tyre, e ka dëmtuar imazhin e shqiptarëve. Mos harroni, se shqiptarët janë kujtuar gjithnjë për besnikëri dhe tolerancë, madje që nga kohërat e hershme. Një shembull tolerance e dëshmoi edhe shkrimtari ynë, Fan Noli, kur shkoi në Amerikë për ta përfaqësuar Shqipërinë si kryeministër.

Andaj t'i tregojmë botës, edhe kësaj radhe, se ne gjithnjë duhet të përmendemi si shembull i mirë i demokracisë, tolerancës dhe besnikërisë. ■



Shtetet që e kanë njohu

Arben MUHAMETI

Republika e Kosovës, në prag të përvjetorit të parë të Pavarësisë, ka arritur që brenda një kohe relativisht të shkurtër, sa i përket praktikës ndërkombëtare, të fitojë njohje zyrtare nga rreth 54 shtete. Shtetet që e kanë njohur vendin tonë janë shtetet më të fuqishme të globit, që përbëjnë rreth 70.9 për qind të GDP-së botërore. Nga 54 shtete, 22 janë anëtare të Bashkimit Evropian (81.4%) dhe NATO-s, 35 shtete anëtare të OSBE-së (62.5%), 33 shtete anëtare të Këshillit të Evropës (70.20%), 53 shtete anëtare të OKB-së (nga gjithsej 192) ose shprehur në përqindje 27.6, nga 3 shtete anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit, 5 shtete anëtare të përkohshme të Këshillit të Sigurimit, nga 8 shtete të Konferencës Islamike, është njohur nga një shtet i Ligës Arabe. Ndërkohë që priten njohje të reja dhe të shumta, shtetet që kundërshtojnë vendosmërisht pavarësinë e Kosovës mbesin: Rusia, Serbia, Sllovakia, Argjentina, Spanja, Rumania, Azerbajxhani, Qipro, Bjellorusia, Gjeorgjia, Kazakistani, Moldavia, Sri Lanka, Vietnami, Angola dhe Bolivia. Këto, në fakt, janë shtete që udhëhiqen në të shumtën e rasteve nga regjime jo demokratike, të tjerat kanë probleme territoriale me tendence shkëputjeje, disa të tjera kanë pretendime territoriale ndaj shteteve të treta. Pra, arsyeja e kundërshtimit nuk është e bazuar dhe parimore.

Ndërkohë, në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë është iniciuar, nga ana e Serbisë, procedura në lidhje me validitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Duhet theksuar se pavarësisht epilogut në këtë gjykatë, vendimet e saj nuk kanë fuqi detyruese, por vetëm karakter konsultativ dhe teorik.

Më poshtë, po japim në mënyrë kronologjike listën e shteteve që, tanimë, e kanë pranuar Kosovën, duke përfshirë edhe disa shënime të shkurtra rreth këtyre shteteve.




1. Afganistani-Shteti i parë që ka njohur Kosovën. Njohjen e ka bërë me datën 18 shkurt. Është shtet anëtar i OKB-së. Nuk ka përfaqësi diplomatike në Kosovë. Është shtet anëtar i Organizatës së vendeve islamike. Shtrihet në Azinë Qendrore. Vendimin për njohje e ka bërë të ditur nga kryeqyteti Kabul.



2. Kosta Rika-Shtet anëtar i Përkohshëm i Këshillit të Sigurimit. Njohjen e ka bërë me datë 17 shkurt 2008, sipas kohës lokale, me anë të një deklarate zyrtare. Nuk ka përfaqësi diplomatike në Prishtinë. Është shtet që shtrihet në Amerikën Qendrore. Vendimin për njohje e ka bërë të ditur nga Kryeqyteti San Jose. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1945.



3. Britania e Madhe-Shtet anëtar i BE-së, Këshillit të Sigurimit të OKB-së, i NATO-s. Ka përfaqësi diplomatike në Prishtinë, ngritur në nivel ambassade. Mbretëria e Bashkuar kushtetuese njohjen e ka bërë nëpërmjet një Deklarate Zyrtare nga Londra me datën 18. 02. 2008



4. Shtetet e Bashkuara të Amerikës-Shteti më i fuqishëm në Botë, njohjen e ka bërë me anë të një Deklarate Zyrtare nga Uashingtoni me datë 18 shkurt. Ka përfaqësi diplomatike në Prishtinë, në nivel ambassade.



5. Franca-Njohjen e ka bërë po më 18. 02. 2008, një ditë pas shpalljes së Pavarësisë. Është shtet anëtar i BE-së, Këshillit të Sigurimit të OKB-së, NATO-s. Ka përfaqësi diplomatike në Prishtinë, në nivel ambassade.



6. Shqipëria-Shteti amë njohjen e ka formalizuar më datë 18. 02. 2008, një ditë pas shpalljes së Pavarësisë. Marrëdhëniet diplomatike janë reciproke në nivel ambasadash.




7. Turqia-Shteti i madh aziatiko-evropian, njohjen e ka bërë në të njëjtën kohë me shtetet e mëdha mike të Kosovës, 18. 02. 2008. Marrëdhëniet diplomatike me Turqinë janë të ngritura në nivel ambasadash. Turqia është anëtare e aleancës ushtarake veriatlantike NATO dhe anëtare e rëndësishme e Konferencës së Vendeve Islamike.



8. Australia-Kontinenti-shtet, njohjen e ka bërë me datë 19. 02. 2008, nga kryeqyteti Canberra, me anë të një Deklarate Zyrtare. Është shtet anëtar i OKB-së, që nga viti 1955.



9. Senegali- Po ashtu, më datën 19. 02. 2008, me anë të një deklarate zyrtare nga kryeqyteti Dakar, ka bërë publik vendimin për njohje. Është anëtare e Organizatës së Vendeve Islamike dhe shtrihet në pjesën perëndimore të Afrikës. Është anëtar në OKB që nga viti 1960.



10. Gjermania-Shteti i fuqishëm i Bashkimit Evropian, ka bërë aktin e njohjes me anë të një shkrese zyrtare, dorëzuar institucioneve tona kompetente, më datë 19. 02. 2008. Ambasada e Republikës Federale Gjermane funksionon në Prishtinë. Gjermania është shtet anëtar i Bashkimit Evropian, NATO-s dhe është një ndër 7 shtetet më të industrializuara të Botës.

r Republikën e Kosovës



11. Letonia - Më 20 shkurt 2008, ka bërë njohjen me anën e një deklaratë zyrtare. Është anëtare e Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Nga kryeqyteti Riga ka bërë publik vendimin për njohje. Shtrihet në pjesën veriore të Evropës pranë Detit Baltik.



12. Estonia - Më datë 21 shkurt, po ashtu, ka bërë njohjen me anën e një deklaratë zyrtare. Bashkë me Letoninë janë anëtare të BE-së. Nuk kanë përfaqësi diplomatike. Deklaratën për njohje e ka bërë publike nga kryeqyteti Talin. Ndër të tjera është anëtare e OKB-së, që nga viti 1991.



13. Italia - Ka bërë njohjen me anën e një shkresë zyrtare më datë 21. 02. 2008, me anën e përfaqësisë diplomatike në Prishtinë. Është shtet anëtar i BE-së. Tani ka marrëdhënie diplomatike me Kosovën në nivel ambasadorësh. Ndër të tjera, është anëtare e NATO-s dhe një ndër 7 vendet më të industrializuara të Globit.



14. Danimarka - Më datë 21 shkurt ka njohur shtetin tonë. Në Kosovë vepron ambasadori i Danimarkës i ndërlidhur me Ambasadën në Vjenë. Danimarka është anëtare e Bashkimit Evropian dhe NATO-s.



15. Luksemburgu - Po ashtu, më datë 21 shkurt, ka bërë njohjen e shtetit të ri. Shteti i vogël i Luksemburgut është anëtar i Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Shtrihet në pjesën Perëndimore të Evropës. Është anëtare e OKB-së që nga viti 1945.



16. Peru - Republika e Perusë e ka realizuar njohjen më 22 shkurt. Vendimin për njohje e ka bërë të ditur nga kryeqyteti Lima. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1945.



17. Belgjika - Ky shtet i BE-së, njohjen e ka bërë me anën e një shkresë zyrtare, më datë 25 shkurt. Në Prishtinë funksionon Zyra Ndërlidhëse Belge. Është shtet anëtar i NATO-s. Brukseli zyrtar, me anë të një deklaratë, ka bërë publik vendimin e tij për njohje. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1945.



18. Polonia - Ky shtet i Evropës qendrore e ka njohur Kosovën më datën 26 shkurt. Është shteti i parë sllav që ka njohur Kosovën. Është shtet anëtar i Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Vendimin për njohje e ka bërë publik nga kryeqyteti Varshavë. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1945.



19. Zvicra - Shteti evropian tradicionalisht neutral, ka njohur shtetin e Kosovës pikërisht më 27 shkurt, nga kryeqyteti Bernë. Në kryeqytetin tonë funksionon Ambada e Zvicrës.



20. Austria - Po ashtu, e ka njohur shtetin e Kosovës më 27 shkurt. Marrëdhëniet mes dy shteteve tona janë të ngritura në nivel ambasade. Austria është anëtare e BE-së. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1955.



21. Irlanda - Data e njohjes së shtetit të Kosovës është 29 shkurt. Shteti disident është anëtar i Bashkimit Evropian.



22. Suedia - Më 4 mars, me anën e Zyrës Ndërlidhëse në Prishtinë bëri të njohur vendimin e saj për njohje. Funksionon Zyra Ndërlidhëse nën varësinë e Ambasadës Suedeze në Shkup. Është shtet anëtar i BE-së. Është Mbretëri konstitucionale që shtrihet në Evropën Veriore. Anëtare e OKB-së që nga viti 1945.



23. Holanda - Po ashtu, ka bërë të njohur vendimin për njohje më 4 mars 2008. Ka përfaqësi diplomatike në nivel ambasade në Prishtinë. Është anëtarë i NATO-s dhe Bashkimit Evropian.



24. Islanda - Ka bërë të ditur vendimin e saj për njohje më 5 mars. Është shtet anëtar i NATO-s. Ndodhet në Atlantikun verior. Vendimin për njohje e ka kumtuar nga kryeqyteti Reikjavik. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1946.



25. Sllovenia - Një nga ish-republikat e Jugosllavisë, e ka bërë njohjen me datë 5 mars 2008, me anën e një konference për shtyp të Ministrisë të Punëve të Jashtme. Tani ka hapur Ambasadën në Prishtinë. Është shtet anëtar i Bashkimit Evropian dhe NATO-s.



26. Finlanda - Data e njohjes së shtetit të Kosovës është 7 mars. Në Prishtinë funksionon Zyra Ndërlidhëse. Është shtet anëtar i Bashkimit Evropian. Vendimin për njohje e ka bërë të ditur nga kryeqyteti Helsinki. Ky shtet nordik është anëtar i OKB-së që nga viti 1955.




27. Japonia - Shteti i Lindjes së Largët e ka bërë njohjen me datë 18 mars. Në Prishtinë funksionon Zyra Ndërlidhëse e Japonisë. Është shtet

anëtar i G-8. Vendimi për njohje është bërë publik nga kryeqyteti Tokio. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1956.



28. Kanada - Njohjen e ka bërë më 18 mars. Është anëtare e NATO-s dhe G-8. Është shtet që shtrihet në Amerikën Veriore. Vendimin për njohje e ka bërë të ditur nga kryeqyteti Otava. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1945.



29. Monako - Ka realizuar njohjen më 19 mars. Principata e Monako-s ka vetëm 31 mijë banorë dhe një sipërfaqe prej 1.95 km². Është shtet anëtar i OKB-së.



30. Hungaria - Po ashtu ka bërë të njohur vendimin për njohje më 19 mars. Në Prishtinë vepron Ambasada e Hungarisë. Është shtet anëtar i NATO-s dhe BE-së.



31. Kroacia - Një nga ish-republikat e Jugosllavisë. Ka bërë njohjen zyrtare më datë 19 mars. Në Prishtinë funksionon Ambasada e Republikës së Kroacisë.



32. Bullgaria - Ka bërë njohjen, me anën e një deklarate nga Sofja më datë 20 mars. Në Prishtinë funksionon Ambasada e Republikës së Bullgarisë. Është shtet anëtar i NATO-s dhe BE-së. Është shtet në Juglindje të Evropës. Anëtar i OKB-së që nga viti 1955.



33. Lihtenshtajni - Ka bërë të ditur njohjen më 25 mars. Në Kosovë, në aspektin diplomatik, përfaqësohet nga Ambasada e Zvicrës. Për nga rregullimi shtetëror është principatë. Ka vetëm 32 mijë banorë dhe një sipërfaqe prej 160 km². Pavarësinë e ka shpallur qysh në vitin 1806. Është shtet anëtar i OKB-së.



34. Koreja Jugore - Ka bërë të njohur vendimin më 28 mars. Seuli zyrtar e ka bërë të ditur njohjen me një deklaratë zyrtare nga Ministria e Jashtme. Ky shtet e ka shpallur pavarësinë e vet në vitin 1945. Që nga viti 1991, është shtet anëtar i OKB-së.



35. Norvegjia - Më datë 28 mars, ka bërë të ditur njohjen me anën e një shkrese dorëzuar nga zyrtarët e zyrës së saj ndërlidhëse. Tani në Prishtinë funksionon Ambasada Norvegjeze. Është shtet anëtar i NATO-s. Pikërisht nga kryeqyteti Oslo u bë i ditur vendimi për njohje. Norvegjia e ka shpallur pavarësinë e saj në vitin 1905. Është shtet anëtar i NATO-s.



36. Ishujt Marshall - Kanë bërë të ditur vendimin për njohje më datë 17 prill. Kjo Republikë e vogël ka territor prej 181 km², ka 56 mijë banorë dhe pavarësinë e ka shpallur në vitin 1986. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1991.



37. Nauru - Ky shtet ka bërë njohjen më datë 23 prill. Është një Republikë e vogël në Oqeanin Paqësor. Ka vetëm 12 mijë banorë. Pavarësinë e ka fituar në vitin 1968. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1999.



38. Burkina Faso - Data e njohjes 24 prill. Është një vend kontinental në Afrikën Perëndimore. Pavarësinë nga Franca e fitoi në vitin 1960. Është shtet anëtar i Konferencës së Vendeve Islamike dhe anëtare e përkohshme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.



39. Lituania - Data e njohjes 6 maj 2008. Është një nga 3 vendet baltike e cila pavarësinë e ka shpallur në vitin 1990. Njohjen për pa-

varësinë e Kosovës e ka bërë të ditur nga kryeqyteti Vilnius. Është shtet anëtar i Bashkimit Evropian dhe NATO-s.



40. San Marino - Data e njohjes 11 maj 2008. Është një ndër republikat më të vjetra të rruzullit. Është shtet me sipërfaqe 60 km² dhe vetëm 27 mijë banorë. Shtrihet në pjesën jugore të Evropës. Është plotësisht i rrethuar nga Italia. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1992.



41. Çekia - Data e njohjes 21 maj. Në Prishtinë tani funksionon Ambasada e Republikës çeke. Është shtet në Evropën Qendrore. Është shtet anëtar i Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Vendimin për njohje e Kosovës e ka bërë nga kryeqyteti, Praga.



42. Liberia - Data e njohjes 30 maj. Është shtet që gjendet në pjesën perëndimore të Afrikës. Kryeqyteti i saj është Monrovia. Pavarësinë e saj e ka shpallur në vitin 1847. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1945.



43. Sierra Leone - Data e njohjes 13 qershor. Kjo Republikë gjendet në Pjesën Perëndimore të Afrikës. Vendimin për njohje e ka bërë të ditur nga kryeqyteti i saj Freetown. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1961. Është anëtare e Konferencës së Vendeve Islamike.



44. Kolumbia - Bogota Zyrtare vendimin për njohje e ka bërë të ditur me datë 7 gusht. Është shtet që shtrihet në Amerikën e Jugut. Pavarësinë e saj e ka shpallur në vitin 1810. Është anëtare e OKB-së që nga viti 1945.



45. Belize - data e njohjes 7 gusht. Është shtet anëtar i Komonveltit. Shtrihet në Amer-

ikën e Mesme. Vendimi për njohje është bërë i ditur nga Kryeqyteti Belmopan. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1981.



46. Malta - Data e njohjes 21 gusht. Shtet i Bashkimit Evropian. Kjo Republikë ka vetëm 316 kilometër katrorë, por është anëtare e Bashkimit Evropian. Vendimin për njohje e ka bërë të ditur nga kryeqyteti i saj Valletta. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1964.



47. Samoa - Është shtet ishullor në Oqeanin e Qetë. Vendimin për njohje e ka bërë të ditur me datë 15 shtator nga kryeqyteti i saj Apia. Është anëtare e OKB-së që nga viti 1976.



48. Portugalia - Shtet i BE dhe NATO-S. Ky shtet ndodhet në pjesën jugperëndimore të Evropës me dalje nga Oqeani Atlantik. Vendimin për njohje e ka bërë të ditur më datë 7 tetor nga kryeqyteti Lisbona. Në OKB që nga viti 1955.



49. Mali i Zi - Shteti fqinj pas shumë hezitimeve, më datë 9 tetor 2008, ka bërë të ditur zyrtarisht se e njeh dhe e pranon shtetin e ri të Kosovës. Është vend bregdetar në Ballkanin Perëndimor, i pavarësuar nga Serbia në vitin 2006.



50. Maqedonia - Shteti tjetër fqinj, në mënyrë të sinkronizuar me Malin e Zi, po ashtu, në të njëjtën datë, ka bërë të njohur vendimin për njohje. Është pavarësuar nga Jugosllavia në vitin 1991. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1993.



51. Emiratet e Bashkuara Arabe - Shtet anëtar i Ligës Arabe. E ka njohur Kosovën më datë 14 tetor. Është shtet federal në Ishullin Arabik. Vendimin për njohje e ka bërë të ditur nga kryeqyteti Abu Dabi. Është shtet anëtar i OKB që nga viti 1971. Është anëtare e Konferencës së Vendeve Islamike.



52. Malajzia - Shteti i rëndësishëm islamik ka njohur Kosovën zyrtarisht më 30 tetor. Është shtet federativ në Azinë Juglindore. Vendimin për njohjen e Kosovës e ka bërë të ditur nga kryeqyteti Kuala Lumpur. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1957. Dhe, natyrisht, është shtet anëtar i Konferencës së Vendeve Islamike.



53. Mikronezia - Ky shtet ka bërë të ditur vendimin për njohje më 5 dhjetor. Shtet ne Oqeanin Paqësor. Vendimin për njohje e ka bërë të ditur me anën e një deklaratë zyrtare nga kryeqyteti Palikir. Është anëtare e OKB-së që nga viti 1991.



54. Panamaja - Shteti i Panamasë e ka njohur shtetin tonë më datë 16 janar. Ky shtet i Amerikës së Mesme, vendimin për njohje, e ka bërë të ditur nga kryeqyteti Panama City. Është shtet anëtar i OKB-së që nga viti 1945. ■

Thank You 감사합니다 Tak Takk

Danke شكرا لك Tak Takk

Grazie Faleminderit Grazzi

Merci Teşekkürler Благодаря

Tack Köszönöm Dziękuję

Obrigado Tänaan Hvala

ありがとうございました

Opinione të qytetarëve për njëvjetorin e Pavarësisë së Kosovës

Qytetarët: Kemi p

Osman D. GASHI

Një vit pavarësi për qytetarët e Kosovës ishte një vit gërshetimi i gëzimit për realizimin e ëndrrave shekullore dhe i shpresës për një të ardhme më të mirë. Për të mësuar më për së afërmi se si e kanë përjetuar një vit pavarësi, biseduam me disa qytetarë të moshave e profesioneve të ndryshme.

Dukagjin Avdyli, 26 vjeçar, jurist



Dita e pavarësisë së Kosovës, 17 shkurti i vitit 2008, për mua ka qenë dita më e rëndësishme dhe më e lumtur e jetës. Kam pasur ndjenja të përziera gëzimi dhe pikëllimi. Isha i gëzuar me të drejtë për atë ditë të madhe, që e kemi pritur aq shumë. Kurse pikëllohesha kur më kujtoheshin gjithë ato viktimat dhe ata njerëz, të cilët sakrifikuuan çdo gjë për atë ditë, që ne të gjallët po e prisnim dhe po e shijonim. Jo vetëm unë por pothuajse të gjithë shqiptarët ishim shumë optimistë dhe mendonim se gjërat do të merrnin kah nga e mira dhe assesi nga e keqja dhe ajo që është e dëmshme.

Ndërkaq tani, pas një viti të pavarësisë së Kosovës, jam paksa i zhgënjyer dhe besoj që edhe te tjerët mendojnë kështu, duke i pasur parasysh disa gjëra që kanë mbetur të pandryshuara, e ndoshta kanë avancuar për të keq si: integrimi i veriut të Mitrovicës le që nuk ndodhi, por ndarja sa erdhi dhe u thellua edhe më shumë, numri i pakët i njohjeve të Kosovës nga shtetet tjera, kontestimi i çështjes së Pavarësisë së

Kosovës dhe dërgimi i saj në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës etj.

Në anën tjetër të gjithë kemi pritur më shumë, sa i përket zhvillimit ekonomik të vendit, luftimit të korrupsionit, furnizimit 24 orë me rrymë, punësimit që është një problem akut, zbutjes së varfërisë së lartë, kujdesit mbi shëndetin publik ...

Mirëpo, edhe përkundër këtyre problemeve me të cilat po ballafaqohemi dhe, si të them, edhe të një lloji zhgënjimi që kam, prapëseprapë jam optimist që gjërat do të ndryshojnë për të mirë, duke pasur parasysh faktin se tani kemi shtetin tonë dhe duhet të kontribuojmë të gjithë që ta lartësojmë vendin tonë dhe t'u tregojmë miqve dhe armiqve tanë se ne duam, mundemi dhe ia dalim mbanë.

Sabrie Kamberi, 31 vjeçare, zëdhënëse e Policisë së Kosovës



Pas një viti, që nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës, mendoj se është punuar me të vërtetë shumë në të gjitha sferat e jetës, apo thënë më mirë ka pasur lëvizje në kontekstin pozitiv në të gjitha fushat. Ndërsa sa i përket çështjes së sigurisë, pasi i takoj kësaj fushe, lirisht mund të them se është bërë mjaft, qoftë edhe para Shpalljes së Pavarësisë dhe pas saj. Në momentet kur është shpallur Pavarësia e Kosovës, para një viti, jam ndierë si çdo qytetar tjetër i Republikës së Kosovës. Ka qenë në ndjenjë të cilën e kemi pritur me shekuj dhe është fat i yni që ne kemi qenë pjesë e realizimit të një ëndrre shekullore. Është dashur të punohet jashtëzakonisht shumë për ta arsyetuar

atë që e kemi kërkuar, ndërsa tani duhet të punohet edhe më shumë që ta arsyetojmë atë që tanimë e kemi.

Ne, si polici, kemi përgatitur të gjitha planet operative për të menaxhuar situatën e sigurisë në Ditën e Pavarësisë dhe besojmë shumë se qytetarët e Republikës së Kosovës do të festojnë edhe kësaj radhe me dinjitet sikurse festuan vitin e kaluar.

Urime dhe Zoti e bekoftë Kosovën.

Bujar Ramadani, 29 vjeçar, taksist



Pas një viti të Pavarësisë së Kosovës janë kryer shumë gjëra që është pritur të kryhen, por ka edhe shumë për t'u punuar për të qenë të kënaqur ashtu si duhet, ne si qytetarë. Unë në momentet kur është shpallur Pavarësia e Kosovës kam qenë duke punuar. Edhe sivjet do të jem në punë, kështu që nuk do të kem mundësi as ta festoj këtë ditë. Momentet kur është shpallur Pavarësia janë të papërshtkrueshme. Ka qenë një ndjenjë shumë e mirë, sa që s'di si ta përshkruaj.

Nazmi Krasniqi, 60 vjeçar, i papunë



Priritur më shumë...

Në njëvjetorin e Pavarësisë së Kosovës që u bë këto ditë, kemi pritur që do të bëhej më shumë. Jam pjesërisht i kënaqur me arritjet e deritashme. Nuk është arritur ajo që kemi menduar, por të shpresojmë që në të ardhmen të përmirësohet kjo gjë. 17 shkurti para një viti, kur është bërë Shpallja e Pavarësisë, ka qenë ditë që nuk do ta harroj kurrë. Jam ndierë shumë i emocionuar, pasi është realizuar ëndrra shekullore e arritjes së lirisë tonë.

Besnik Elshani, 19 vjeçar, student

Kaloi një vit nga Shpallja e Pavarësisë



dhe mund të them që Kosova ka përparuar pak. Kanë filluar rinovimet dhe shtruarja e rrugëve. Do kisha folur më tepër për fakultetin, pasi që jam student. Aty mungon hapësira, nuk kemi vend të mjaftueshëm. Kur shkojmë në ligjërata duhet të presim nga një orë për të hyrë nëpër salla për të zënë vend, e në qoftë se shkon më vonë nuk mund të gesh vend dhe mbetesh pa i dëgjuar ligjëratat. Pastaj, kemi probleme edhe për çështjen e provimeve, etj. E sa i përket asaj që unë kam pritur në përgjithësi, pas Pavarësisë së Kosovës, pak është arritur, shumë pak.

Flurim Çitaku, 20 vjeçar, student



Unë mburrem me politikanët tanë të cilët kanë shpallur Pavarësinë e Kosovës. Ata janë një shembull i mirë për popullin shqiptar, kudo qofshin ata në botë.

Ndërkaq sa i përket punëve të tjera, flitet nëpër gazeta e televizione se çfarë bëjnë ata. Ka shumë parregullsi dhe unë, si qytetar i Kosovës, nuk jam aspak i kënaqur me këtë gjë. Ka shumë mangësi që pushtetarët tanë duhet t'i përmbushin, si: të ulët niveli i papunësisë, të hapen vende të reja punë, të investohet aty ku duhet në mënyrë që Kosova të përparojë e jo të investohet në gjëra që nuk kanë dobi.

Nafi Mustafa, 19 vjeçar, student



Jam i kënaqur që është shpallur Pavarësia e Kosovës sepse është shpërblyer munda i të gjithë atyre që kanë derdhur gjakun për lirinë që gëzojmë ne sot, por, në anën tjetër, nuk jam i kënaqur me politikanët tanë sepse nuk janë duke bërë kurrfarë pune tani pas Shpalljes së Pavarësisë. Shumë premtojnë por pak realizojnë. Niveli i korrupsionit është shumë i lartë dhe nuk interesohen se si të investojnë më shumë në mënyrë që vendi ynë të forcohet ekonomikisht, se si ta zbresin përqindjen e papunësisë në Kosovë që është shumë e lartë dhe njëkohësisht një pikë e dobët këtu në Kosovë. Pastaj, edhe stabiliteti politik në Kosovë nuk është si duhet. Kemi problemin e pjesës veriore të Kosovës, me të cilin politikanët tanë merren pak ose aspak.

Afrim Bytyqi, 28 vjeçar, sociolog



Pavarësia e Kosovës është një gjë që është pritur për kohë të gjatë me vite dhe jam i lumtur që kam pasur fatin ta përjetoj këtë gjë. Por tani, pas një viti, nuk është bërë asgjë për atë çka është premtuar dhe çka është dashur të realizohet. Gjithmonë është bërë pyetja: Çfarë pas Pavarësisë? Unë shoh që vetëm është vështirësuar më shumë gjendja pas pavarësisë, sidomos ajo ekonomike, që mos të them se është një katastrofë. Është rritur papunësia, problemet janë shtuar, kurse koha po ecën. Politikanët tanë nuk interesohen shumë për popullin, vrapojnë pas interesave të tyre personale dhe janë dhënë pas luksit. Unë shoh se në Kosovë dominon një krizë apo kaos social dhe zgjidhjen për këtë e shoh te unifikimi i politikanëve tanë, atyre që na udhëheqin, që të punojnë me përkushtimin më të madh për popullin e ta nxjerrin nga ky kaos.

Tani në njëvjetorin e Pavarësisë së Kosovës kemi probleme të shumta, me të cilat ballafaqohemi, si për shembull, problemet e fundit me Forcën e Sigurisë së Kosovës, problemet sociale e ekonomike të cilat nuk janë duke u përmirësuar por janë duke u vështirësuar ende më tepër, etj. Kemi ëndërruar dhe kemi pritur më shumë, por pak, shumë pak, është bërë. ■



Në njëvjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës

Mitrovica mbetet simbol

Përfaqësues të pushtetit lokal në këtë komunë numërojnë sukseset, ndërkaq qytetarët shprehin shqetësimet e tyre

Florije ADEMI

Në njëvjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Mitrovica mbetet simbol i ndarjes. Përfaqësues të pushtetit lokal në këtë komunë numërojnë sukseset, ndërkaq qytetarët shprehin shqetësimet e tyre.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës, të ndarë në dysh, Bajram Rexhepi, duke pohuar se shpallja e pavarësisë është një ngjarje e madhe historike që shqiptarët e kanë pritur me shokuj, potencon se në Mitrovicë, pas këtij akti, është dashur mobilizim i strukturave komunale për menaxhimin e situatës, që vlerësohet i një niveli shumë të mirë me strukturat e sigurisë, sidomos me KFOR-in. Ai përmend formimin e komiteteve të veçanta, gjë që nuk ka ndodhur në komunat e tjera, si Komiteti i Sigurisë dhe Qendra për koordinim dhe alarmim, ku kanë qenë të përfaqësuar strukturat politike dhe ato të sigurisë, komuna, KFOR-i, Policia e UNMIK-ut, Policia e Kosovës dhe ish-pjesëtarët e TMK-së.

Duke folur për pjesën tjetër të punës që është bërë, ai përmend realizimin e një numri projektesh, sidomos në infrastrukturë. "Gjatë këtij viti janë realizuar rreth 100 projekte, në vlerë prej rreth 10 milion euro, prej të cilave rreth 4 milion janë investuar në veri" - thekson Rexhepi duke nënvizuar se për herë të parë

është thyer tabuja se në veri nuk mund të investohet. Në këtë kontekst, ai përmend ndërtimin e 8 shtëpive atje, asfaltimin e rrugës, ndriçimin publik, ujësjellësin dhe kanalizimin në "Lagjen e Doktorëve", e cila deri më tani ka qenë në gjermadha. Kryetari përmend edhe nismën e disa projekteve të tjera, kryesisht në veri të vendit, ndërkohë që thotë se si prioritet, edhe më tej, mbetet vendosja e rendit dhe ligjit në veri, ndonëse kjo sipas tij nuk është përgjegjësi e komunës.

Besim Hoti: Janë të dukshme rezultatet në luftën kundër kontrabandës

Izmir Zeqiri, zyrtar në zyrën për komunitete në Qabër, i vetmi fshat shqiptar në komunën e Zubin Potokut, shprehet i kënaqur me pavarësimin e vendit, edhe pse për banorët e veriut (pra edhe ata të fshatit Qabër), ka shqetësime nga veprimet e grupacioneve rebele serbe, të cilat sipas tij shkaktojnë shqetësime si për shqiptarët, ashtu edhe për një pjesë të serbëve që i mbajnë nën diktatin e tyre.

Sa i përket dokumentacionit, ai thotë se zyra lokale në Qabër funksionon shumë mirë. Pjesa më e madhe e dokumentacionit është rregulluar me Republikën e Kosovës, mirëpo ka probleme të mëdha akoma sa i përket dokumenteve kadas-trale dhe librave amzë.

Ndonëse në këtë fshat të banuar me shqiptarë punon nënstationi policor, mbetet problem fakti që serbët e inkuadruar në PK, të cilët janë të stacionuar në fshatin Zupq nëpër të cilin kalojnë qabrasit, nuk i përgjigjen zinxhirit institucional. Po ashtu, Zeqiri tregon se pesë herë janë bërë përpjekje për vënien e tabelave të Republikës së Kosovës që tregojnë vendbanimet, por kjo nuk është arritur në atë pjesë të Kosovës. "Për herë të fundit ato i kemi vendosur para vitit të ri dhe të nesërmen janë hequr nga serbët, gjë që tregon se te ta ende nuk është arritur një vullnet i mirë për të bashkëjetuar" - thotë Zeqiri.

Në qoftë se EULEX-i kryen punën e vet si duhet, ai shpreson se shumë shpejt edhe kjo çështje do të rregullohet dhe do të bëhet mirë për të gjithë, ndryshe mund të jetë rrezik potencial i konflikteve ndëretnike.

Zëdhënësi rajonal i Policisë së Kosovës, Besim Hoti, thotë se policia gjatë këtij viti ka qenë e angazhuar në normalizimin e gjendjes pas trazirave të marsit, gjegjësisht pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, që ndodhën në objektet e organeve të judikaturës dhe dy pikat doganore në veri të Kosovës.

"Pas djegies së pikave doganore u ngrit niveli i kontrabandës në këtë rajon dhe është dashur që ne të fokusohemi më tepër në luftën kundër kontrabandës, dhe në këtë drejtim rezultatet janë të dukshme" - thekson Hoti. Si një hap të madh pozitiv, ai përmend edhe vendosjen e EULEX-it në ato hapësira, ku nuk ka pasur polici dhe doganier kosovar.

Momçillo Arlov: Kurrë nuk do të ketë pajtime ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit rreth statusit të Kosovës

Momçillo Arlov, qytetar serb i veriut, duke përmendur faktin se edhe një vit pas pavarësisë, Mitrovica mbetet simbol i ndarjes së shoqërisë kosovare, mendon se ndryshimet që kanë ardhur gjatë kësaj periudhe janë një pasqyrë e ngritjes së nivelit kualitativ të përditshmërisë së



i ndarjes

qytetarëve që jetojnë në pjesën veriore, të cilët janë të lidhur me çështjen e sigurisë dhe transparencën e funksionimit të institucioneve, në mes të dialogut dhe forcës ndërmjet komuniteteve, si dhe parakushtet e pajtimit dhe integritimit që janë të papara. “Duke marrë parasysh situatën momentale nuk është reale që do të arrihet një kualitet i ndryshimeve në nivelin lokal në Mitrovicë” - thekson Arlov, duke shtuar se rreth statusit të Kosovës nuk do të ketë kurrë pajtime ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, përkundër angazhimit të faktorit ndërkombëtar. “Një vit pas pavarësisë, edhe pse pas shumë deklaratave e prononcimeve të cilat kanë qenë temë e zhvillimit të jetës së minoriteteve dhe integrimin e tyre në gjithë territorin e Kosovës, çdoherë kjo është e lidhur me pyetjen e statusit të Kosovës. Kjo anë, edhe më tutje, paraqet një pengesë politike”.

Ndonëse për komunitetin serb është vështirë të gjendet një politikan që mund të pretojë diçka teknike për të dy anët, duke u dhënë mundësinë e orientimit në ekonomi dhe integrimin e shoqërisë, sipas Arlov, qytetarët serbë e kanë lidhur shpresën me misionin evropian, EULEX-in, se ata do të stabilizojnë situatën dhe do të mundohen t'u shmangen disa gjërave të ndjeshme, si dhe aksioneve që do të tensiononin situatën momentale që karakterizohet si konflikt i ngrirë.



Adem Mripa: Ne ende nuk e kemi ndierë erën e pavarësisë

Në anë tjetër, Adem Mripa, një nga banorët shqiptarë të veriut të qytetit, thotë se ne ende nuk e kanë ndierë erën e pavarësisë. “Ne me asgjë nuk e kemi shiju atë kënaqësi, vetëm kur dalim në anën tjetër të lumit Ibër gjatë bisedave me njerëz atje flasim për pavarësi”. Sipas Mripës, pas pavarësimin të Kosovës, në veri egërsirat e kanë çuar edhe më shumë kokën, se nuk ka kush t'i ndalë. “Aktivitetet e grupeve ekstremiste çdo ditë e më shumë shtohen. Kohën e fundit janë duke vnu pankarta në të cilat në gjuhën e tyre shkruajnë “vdekje shqiptarëve-nuk i dojmë uniformat e arnautëve, dojmë

policinë e Serbisë” etj., tregon Mripa.

Përveç këtyre aktiviteteve, ekstremistët serbë, në mes të sulmeve të tjera mbi shqiptarët, kanë sulmuar 10 herë brenda një muaji shtëpinë e Mripës, ku duhet veçuar nata e 2 dhe 3 shkurtit, kur është shtënë me armë zjarri në një nga dhomat e shtëpisë së tij, ku ka qenë duke fjetur djali i tij, por fatmirësisht përveç dëmeve materiale nuk ka pasur të lënduar.

Me gjithë situatën momentale, aspak të favorshme për shqiptarët e veriut të qytetit, ku pavarësia është reflektuar vetëm në akte kriminale, Mripa shpreson se në të ardhmen edhe ata do ta shijojnë kënaqësinë e pavarësimin të shtetit të tyre. ■



Edhe goranët i gëzohen pavarësisë së Kosovës

Restelicasit ishin të vetmit që e festuan Ditën e Pavarësisë në mënyrë të organizuar. Po ashtu, ata janë të vetmit që e kanë kuptuar realitetin e krijuar. Ata thonë se do të festojnë edhe me rastin e njëvjetorit të pavarësisë

Osmon BOJAXHIU

Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, përveç shqiptarëve i janë gëzuar edhe një pjesë e komunitetit goran që jeton në komunën e Sharrit. Ky gëzim është shprehur hapur veçmas në fshatin Restelicë, i cili është fshati më i madh i kësaj komune. Në Restelicë, Dita e Pavarësisë është pritur me shumë gëzim dhe janë organizuar manifestime të ndryshme, duke i kënaqur të gjithë të pranishmit me këngë e valle.

Ata përgatitën për Ditën e Pavarësisë edhe një kazan me hallvë në oborrin e shkollës së këtij fshati, ku të gjithë të pranishmit që po festonin, pas këngëve e valleve, u ëmbëltuan me hallvë, duke u lutur që pas Pavarësisë jeta të jetë më e ëmbël. Kjo hallvë kishte edhe një simbolikë tjetër. Ajo simbolizonte vdekjen e Serbisë! Restelicasit ishin të vetmit që e festuan Ditën e Pavarësisë në mënyrë të organizuar. Po ashtu, ata janë të vetmit që e kanë kuptuar realitetin e krijuar. Ata thonë se do të festojnë edhe me rastin e njëvjetorit të pavarësisë.

Por çfarë mendojnë goranët e fshatrave të tjera? Banorët e disa fshatrave që vizituam, u shmangeshin bisedave për pavarësinë, sapo merrnin vesh qëllimin e vizitës sonë.

Vizituam edhe fshatit Mlik, në të cilin funksionon edhe shkolla e mesme ilegale, por edhe në këtë fshat, përkatësisht në këtë shkollë, asnjëri nga nxën-

ësit dhe arsimtarët nuk deshën të japin komentet e tyre se si iu dukej atyre një vit pavarësie. Në një zyre të improvizuar brenda një shtëpie të vjetruar takuam disa arsimtarë, të cilët punojnë në këtë shkollë ilegale. Ata fajësonin Ministrinë e Arsimit duke thënë se nuk po gjenin ndonjë kompromis, sepse sipas tyre, nëse nxënësit e minoriteteve mësonin shqip, ata nuk do të kishin mundësi që t'i kryenin studimet në Serbi. Kështu, sipas tyre, Serbia dhe UNMIK-u kanë rënë dakord që këta nxënës të mësojnë në këtë mënyrë në gjuhën serbe, arsimtarët të paguhen nga Serbia dhe t'u lëshojnë nxënësve diploma me vulë të Serbisë brenda shtetit të Kosovës. Mësuesit shpresojnë se do të rregullohet kjo çështje dhe nxënësit e tyre do të kenë mundësinë që t'i kryejnë studimet në gjuhën serbe në Universitetin e Prishtinës...

Pyetjes sonë se a kanë vërejtur ndonjë ndryshim gjatë një viti pavarësie, ata shprehen se rezultate të kënaqshme nuk kanë shijuar edhe vetë shqiptarët që kanë luftuar vetë për këtë pavarësi! Ata mendojnë se duhet të kalojë një kohë e gjatë që të shihen rezultatet e Pavarësisë.

“Gjatë një viti pavarësi, nuk kemi pasur probleme, kemi kaluar mirë edhe pse me pak vështirësi, por në përgjithësi mirë. Kemi rezultate të mira, nuk kemi pasur raste të ndonjë dukurie negative” - shprehen arsimtarët duke shpresuar se, vitin e ardhshëm, Pavarësinë do ta shijojnë të gjithë akoma më mirë!

Bajrami: Duhet të shuhen strukturat paralele

Ruzhdi Bajrami, pronar i një qebaptoroje në Sharr, thotë se e ka mirëpritur pavarësinë dhe se ka kaluar shumë mirë gjatë këtij viti në shtetin e Kosovës. “Nuk kam pasur asnjë problem me askënd dhe deri më tani jam i kënaqur me të gjitha institucionet” - shprehet Ruzhdi, duke theksuar se strukturat paralele të cilat i kanë instaluar një pjesë e bashkëkombësve të tij, duhet të shuhen menjëherë. “Duhet t'i ndërpresim ato. Ne jetojmë në shtetin e Kosovës dhe duhet të mësojmë shqip!” - shprehet Ruzhdi.

Por këtë mendim nuk e ndan bashkëvendësi i tij Aziz Zhile, i cili mendon se shumica e goranëve ende e duan Serbinë, ndoshta jo si shtet, por si mundësi për të migruar më lehtë me dokumentacionet e saj nëpër Evropë.

“Ata e duan Serbinë andaj edhe po mësojnë serbisht, duke u arsyetuar se nuk ka kuadro të mësimdhënësve shqiptarë për të mësuar shqip” - thekson Azizi, duke shtuar se ata janë të joshur nga paratë e majme që ua jep Serbia.

“Unë mendoj se duhet të mësojmë shqip. Shteti duket se është duke ecur përpara dhe besoj se do të na pranojnë të gjitha shtetet, sepse edhe po të kryejmë shkollë në gjuhën shqipe nuk pranohe mi askund si shqiptarë, ndërsa si minoritet apo si boshnjakë kemi përparësi gjithkund dhe me dokumente të Serbisë e jo të Kosovës. Dhe ky është interesi i shumicës së goranëve” - thotë Azizi, duke shprehur bindjen se vitin tjetër shtetin e Kosovës do ta njohin të gjitha shtetet fqinje. ■



Opinione të studentëve të Universitetit të Prishtinës për njëvjetorin e pavarësisë

Studentët: Shteti i pavarur nuk ka sjellë ndryshimet e pritura

Hekuran AVDYLI

Si e kanë pritur studentët momentin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Sa janë të kënaqur ata me të arriturat gjatë një viti pavarësie. Cilat janë kërkesat e tyre..., do të mësoni në prononcimet të cilat ua kemi marrë enkas për revistën "Paqja".

Resmie Nitaj, Fakulteti i Kimisë



Para një viti, unë e kam pritur Ditën e Pavarësisë në shtëpinë time dhe ky është njëri ndër kujtimet më të mira që kam.

Mendoj se vendi ynë ka pasur disa ndryshime pas pavarësisë, por do të doja që t'i jepet më shumë prioritet sferës së arsimit.

Do të doja të investohej më shumë nëpër fakultete, si për shembull në fakultetin e kimisë ku ka laboratorë të cilët nuk janë të pajisur mirë.

Sa i përket qeverisjes, pas pavarësisë jam e kënaqur me punën e tyre, por presim ditë më të mira dhe dëshira ime është që të punohet në të gjitha drejtimet njësoj e të mos bëhen dallime.

Jehona Tmava, Fakulteti Juridik



Para një viti, në Ditën e Pavarësisë, kam pritur që do të ketë ndryshime për të mirë, por, pas pavarësisë, nuk jam e kënaqur aspak me gjendjen në Kosovë. Nuk ka ndryshuar pothuajse asgjë.

Mendoj se do të duhej të punohet shumë më shumë për ne studentët.

Nuk jam e kënaqur aspak me punën e qeverisë. Nëse duam që vendi ynë të ecë përpara, së pari, do të duhej të luftonim korrupsionin si dukurinë më negative dhe më të përhapur në Kosovë.

Për ne studentët ka pasur shumë premtime të cilat nuk janë realizuar.

Shpresoj që do të bëhet diçka për përmirësimin e kushteve të banimit në qendrën e studentëve dhe shpresoj që do të realizohen premtimet për lirim të pagesës së konviktit, pasi që shumë studentë kanë kushte të vështira ekonomike.

Malësore Bacaliu, Fakulteti Juridik



Ka shumë vite që e kemi pritur pavarësinë dhe jam shumë e lumtur që e prita.

Ndryshimet mendoj se do të vijnë gradualisht, sepse gjërat nuk mund të ndryshojnë brenda një dite. Mendoj se brenda këtij viti nuk ka pasur ndryshime të mëdha.

Sa i përket studentëve, besoj se asnjë student nuk është i kënaqur me punën që është bërë për ta. Duhet të punohet më shumë për studentët që edhe ata të kenë sadopak kushte më të mira. Sa i përket qeverisë, jam deri e kënaqur deri diku me punën e tyre, pasi nuk kanë punuar sa është dashur.

Manushaqe Musliu, Fakulteti Ekonomik



Pavarësinë e kam pritur në Viti, në qytetin tim të lindjes. Kam qenë shumë e gëzuar sepse, më në fund, atë ditë u mbyll një kapitull i hidhur e popullit tonë, e cila ka qenë e hapur me shekuj. Kam pritur të ketë ndryshime të mëdha në fushën ekonomike, sociale dhe në nivelin arsimor. Por, në këto drejtime, nuk është punuar sa duhet.

Si studente nuk jam aspak e kënaqur. Mendoj se duhet të punohet më shumë që të rritet kualiteti i studimeve. Sa i përket qeverisë, mendoj se puna e tyre është vërejtur më shumë në infrastrukturë, ku ndryshimet janë evidente. Është dashur të punohet më shumë për të rinjtë, në mënyrë që të ulet numri i papunësisë, pasi Kosova ka shumë potenciale të pa-shfrytëzuara.

Albulena Nitaj, Fakulteti Ekonomik



Dita e Pavarësisë për mua mbetet ndër ditët më të veçanta në kujtesën time. Ka qenë një ndjenjë e papërshkrueshme.

Pas pavarësisë, nuk jam aspak e kënaqur me gjendjen në Kosovë, sepse kam shpresuar që të ketë më pak korrupsion dhe të ketë më shumë vende pune, shpresa të cilat, për fat të keq, nuk më janë realizuar. Për ne studentët, mendoj se është punuar deri diku. Ndërsa me punën e qeverisë, pas pavarësisë, nuk jam aspak e kënaqur sepse nuk kanë realizuar asgjë nga premtimet e dhëna me rastin e zgjedhjes. Mendoj se është qeveria më e dështuar.

Mendoj se duhet të respektohen më shumë të drejtat e studentëve dhe të punohet për një të ardhme më të mirë, në mënyrë që të mos studiojmë për të mbetur rrugëve.

Abedin Shatri, Fakulteti Teknik



Pavarësinë e kam pritur në vendlindje ka qenë një kënaqësi e papërjetuar më parë. Por, me zhvillimet në Kosovë pas pavarësisë, jam shumë pak i kënaqur. Me Qeverinë e Kosovës nuk mund të them që jam shumë i pakënaqur, sepse mendoj se shtyrja e proceseve të cilat duhet të arrihen ndodh për shkak të faktorit kohë, e jo sepse do qeveria.

Si student, mendoj se për ne nuk po bëhet edhe aq shumë. Niveli i kuadrove nëpër fakultete është shumë i dobët dhe mendoj se adaptimi i procesit të Bolonjës po ngecën për shkak se ai nuk po zbatohet nga të gjithë.

Mua si student dhe si qytetar i Kosovës më brengos më së shumti problemi i energjisë elektrike. Mendoj se ky duhet të jetë problemi kryesor i cili duhet të zgjidhet.

Valon Pajaziti, Fakulteti Teknik



Pavarësinë e kam pritur në Prishtinë dhe kam pritur që pas pavarësisë të kemi një shtet më ligjor, ndërsa ndryshime të mëdha nuk kam pritur.

Mendoj se Qeveria e Kosovës ka punuar mjaft, sepse një vit i Kosovës në pavarësi na gjen në ndryshime për të mirë. Mendoj se duhet të bëhet më shumë për familjet e dëshmorëve si dhe për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët janë ndër më të merituarit e pavarësisë që ne gëzojmë.

Për ne studentët nuk ka ndryshuar asgjë pas pavarësisë. Duhet të punohet më shumë për ndryshimin e kushteve në të cilat banojmë në Qendrën e Studentëve, si dhe duhet të ngrihet cilësia e studimeve nëpër fakultete.

Besnik Racaj, Fakulteti Juridik



Pavarësinë e kam pritur në Klinë, në vendlindjen time dhe kanë qenë emocione të veçanta, pasi e kemi pritur shumë atë ditë. Çdo shtet pas pavarësim-

it has në vështirësi. A Ajo çfarë duhet të bëhet është të investohet më shumë në ekonomi dhe në punësimin e të rinjve.

Me qeverisjen jam i kënaqur vetëm me disa ministri, ndërsa disa nuk kanë punuar fare.

Për ne studentët mendoj se nuk po bëhet mjaft. Ka pasur shumë fjalë që do të na ndihmonin në forma të ndryshme, por nuk ka asgjë konkrete. Ne, si studentë, duhet të kemi më shumë përkrahje. Po ashtu duhet të ndërtohen më shumë biblioteka, pasi na mungojnë kushtet e mira të mësimin.



Hazbi Bytyci, Fakulteti i Filologjisë

Pavarësinë e kam pritur në familjen time. Emocionalisht ka qenë një ditë e veçantë dhe kam menduar se do të ketë ndryshime për të mirë.

Me punën e qeverisë jam i kënaqur. Mendoj që më shumë është vërejtur puna e Ministrisë së Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Ndërsa ministritë e tjera, për arsye të cilat nuk i di, mendoj se nuk kanë punuar sa duhet.

Për studentët mendoj se nuk po punohet sa duhet. Duhet të punohet më shumë.

Për të ecur përpara duhet më shumë punë nga të gjithë ne. Duke pasur parasysh që synimi ynë është integrimi në Evropë, duhet të punohet me më shumë seriozitet në këtë drejtim. ■



KOSOVA INDEPENDENT

Ekspertë të kulturës vlerësojnë të arriturat e kulturës në Kosovën e pavarur

Kultura në një vit të pavarësisë

Ndonëse shumë prej institucioneve të kulturës në vend, në vitin e fundit janë aktivizuar pak më shumë, ekspertë të kulturës vlerësojnë se kanë mbetur edhe shumë zbrazëtira për t'u mbushur në vitet që vijnë

Genta HOXHA

Shpallja e pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, krahas gëzimit për realizimin e ëndrrës shekullore të shqiptarëve, ka sjellë edhe shpresën se shumë gjëra do të ndryshojnë për të mirë. Kësaj dite të madhe i janë gëzuar njerëzit e kulturës të cilët me të drejtë kanë pritur se shumëçka do ta marrë të mbarën. Ndërrimi i ministrave që udhëheqin këtë resor të rëndësishëm duket se ka reflektuar edhe në mbarëvajtjen e punës. Ndonëse, ministri i ri ka bërë të aktivizohen pak më shumë institucionet kulturore në vend, megjithatë, ekspertë të kulturës vlerësojnë se kanë mbetur edhe shumë zbrazëtira për t'u mbushur në vitet që vijnë.


Në raportin vjetor të punës së qeverisë për vitin 2008, bëhet e ditur se janë miratuar një mori ligjesh dhe aktesh nënligjore për kulturën. (Është miratuar Ligji për Ansamblin e Këngëve dhe Valleve "Shota". Në procedurë të ridraftimit janë: Projektligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë dhe Projektligji për Sponsorizimet. Janë nënshkruar 7 aktet nënligjore nga Ligji për Trashëgimi Kulturore). Po ashtu, sipas këtij raporti, janë themeluar Këshillat Artistikë dhe Profesionalë për institucionet e nivelit qendror si: Teatri Kombëtar i Kosovës, Filarmonia dhe Opera e Kosovës, Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Shota". Është themeluar Këshilli i Librit, është hartuar dhe nënshkruar Rregullorja e Punës për Këshillin Kombëtar të Bibliotekave dhe është hartuar Projekt-rregullorja për Licencim të Botuesve në Kosovë.

Të gjitha këto ligje e projektligje i kanë dhënë një lloj impulsi sferës së kulturës, por, sipas njohësve të kulturës, ka ende shumë mangësi në politikat menaxhuese të kulturës në vend, të cilat sipas tyre, do të duhej të rregulloheshin shpejt.

Mungesa e strategjisë së menaxhimit kulturor

Një problem tejet shqetësues, për dramaturgun Haqif Mulliqi, është mungesa e ideve dhe vizioneve të lidershit politik për menaxhimin e duhur të kulturës së një vendi. "Mendoj se kultura tek ne është skajshmërisht e politizuar dhe se njerëzit e kulturës, krijuesit tanë akoma i ndajnë në të përshtatshëm dhe të papërshtatshëm politikisht, në ata që duhen dhe që nuk duhen mbështetur, dhe kështu me radhë" - shprehet ai.

Mendim të ngjashëm ka shprehur edhe shkrimtari Agim Vinca. Ai thotë se në Kosovë mungojnë politikat e mirëfillta kulturore dhe interesimi e investimi i duhur për vlerat kulturore. "Në Kosovë mungon kritika profesionale letrare dhe artistike dhe askush nuk kujtohet, që të bëjë diçka në këtë plan për ta ndryshuar gjendjen" - shprehet Vinca. Sipas tij, edhe ndarja e ndonjë çmimi, që mund të mbajë edhe epitetin kumbues "nacional", nuk mjafton për ta larë borxhin institucional ndaj artit dhe kulturës si vlera sublimë të një shoqërie.



“Në Kosovë ende nuk është konsoliduar veprimtaria botuese, kështu që libri, që është vlera kryesore e kulturës së një shoqërie, nuk ka arritur të bëhet faktor me ndikim në shoqëri. Kur themi, libri, kemi parasysh krijuesit e tij, qoftë të librit letrar, qoftë të atij shkencor, të cilët detyrohen të bredhin derë më derë për ta finalizuar punën e tyre dhe për ta plasuar “mallin” e tyre në treg” - thekson Vinca.

Mirëpo, siç thotë ai, as krijuesit nuk janë pafaj në këtë punë, pasi siç është shprehur ai: ‘nuk janë sa duhet aktivë dhe të organizuar për ta ndryshuar gjendjen jo të mirë në kulturën tonë.’

Sukseset shfaqen, s’ka stimulim

Me gjithë problemet, në të cilat ka hasur institucioni që ai drejton, Ahmet Brahimaj, drejtor i Trupës së Baletit të Teatrit Kombëtar, thotë se prej shpalljes së pavarësisë e deri tani kanë pasur një vit tejet të suksesshëm. Sipas tij, një e mirë në këtë vit është buxheti i ndarë veçmas për secilin institucion kulturor. Në këtë mënyrë, Brahimaj thotë që duke ditur mjetet të cilat disponojnë, që në fillim të vitit, kanë një siguri më të madhe për planet që kanë. “Jo që do t’i mbulojnë të gjitha shpenzimet që i kemi

ne si Trupë e Baletit, por gjithsesi 90-100 për qind do t’i realizojmë planet që i keni për këtë vit” - shprehet ai.

Megjithatë, një problem tejet alarmues, Brahimaj thotë të jenë të ardhurat personale të çdo artisti në vend. Kontratat dhe rrogat që kanë artistët në Kosovë, ai thekson se janë tejet nënçmuese. “Nuk po bëj politikë, nuk po bëj dallime mes qeverive, por 10 vjet janë shumë. Institucionet ende nuk kanë arritur të përmirësojnë këtë gjendje” - shprehet Brahimaj duke theksuar se kjo gjendje ndikon negativisht në profesionin e artistit. Siç thotë ai, nuk po bëhet asgjë për t’i stimuluar artistët e rinj, të cilët përkushtohen aq shumë në art dhe tregojnë rezultate të lakmueshme. “Nuk stimulohet rinia të merret me balet, kështu vjen deri te zhgënjimi... të vetmin ngushëllim e kemi skenën”. Ndërkaq në raportin e qeverisë për arritjet e vitit 2008 thuhet: “Ministria ka qenë e angazhuar për mbështetjen e veprimtarisë themelore të institucioneve si dhe për aktivitete në sferën e kreacionit, inkurajimit dhe ngritjes së kapaciteteve njerëzore”.

Mungon legjislacioni i qartë

Problemi i financimit bazë të punonjësve të kulturës është vlerësuar

i rëndë edhe nga drejtori i Filarmonisë së Kosovës, Baki Jashari. Sipas tij, mundon një strategji afatgjatë e investimeve dhe menaxhimit të kulturës në vend. Me gjithë sukseset e shumta që ka treguar institucioni kulturor që ai drejton, Jashari e vlerëson si kronik, problemin e financimit bazë të punonjësve të kulturës. Sipas tij, prej 23 prezantimeve të Filarmonisë së Kosovës, gjashtë prej tyre kanë qenë të tipit protokollar, solemn, memorial e të tjerët artistikë.

“Kjo qëndrueshmëri e punës së Filarmonisë së Kosovës është rrjedhojë e ndërrimit të Qeverisë, përkatësisht të udhëheqjes së Ministrisë së Kulturës, që d.m.th. një qasje shumë më serioze ndaj institucioneve kulturore në vend” - shprehet ai.

Jashari ka thënë se pas një periudhe relativisht të gjatë, institucioneve kulturore, si dhe Filarmonisë së Kosovës, i është ndarë buxheti paraprak. Kjo, sipas tij vlen shumë pasi që në fillim të vitit dihet saktë se sa mjete financiare disponon çdo ditë, çdo institucion kulturor. “Kjo politikë menaxhuese ka rezultuar në një punë më stabile dhe afatgjatë në planifikimin e aktiviteteve kulturore koncertale”. ■

